



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni i Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 15.04.2016, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Vazhdimi i diskutimit të opinionit final të Komisionit të Venecias për reflektimin e rekomandimeve të tij në tekstin e rishikuar të projekt amendamenteve kushtetuese të përgatitura nga Ekspertët e Nivelit të Lartë

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Eduard Halimi, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Silva Caka, Ulsi Manja, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Jorida Tabaku, Fatmir Mediu.

Mungojnë:

Arben Ristani, Spartak Braho

Të ftuar:

Zj. Romana Vlahutin - Ambasadore e Delegacioni të BE-së në Tiranë

Z.Rainer Deville – Shef i Misionit Euralius, Ekspert i Nivelit të Lartë pranë Komisionit të Posaçëm

Z.Jon Smibert – Këshilltar Ligjor Rezident, OPDAT, Ambasada e ShBA-së, Ekspert i Nivelit të Lartë pranë Komisionit të Posaçëm

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Mirëdita!

Jemi sot në këtë mbledhje të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për të rifilluar atje ku e kemi lënë. Më 23 mars kemi bërë mbledhjen e këtij komisioni që kishte si objekt reflektimin në projektin kushtetues të opinionit final të Komisionit të Venecias. Në fakt, sot kemi edhe një surprizë, kjo ishte një gjë e paparashikuar, ku ambasadorja e BE-së, zonja Vlahutin është e pranishme në mbledhjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar. Besoj se shpreh edhe konsideratën tuaj se ky është një vlerësim për komisionin, jo vetëm për faktin, se zonja Vlahutin është përfaqësuese e Bashkimit European në Shqipëri, por edhe se është një ndër zërat kryesorë mbështetës të kësaj reforme të rëndësishme për vendin. Natyrisht, gjatë kësaj periudhe kemi pasur gjëra me interes. Një sondazh i mbështetur nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara ritheksonte domosdoshmërinë e reformës dhe faktin që qytetarët shqiptarë në shumicë dërmuese si asnjëherë tjetër dhe për asnjë gjë tjetër e konsiderojnë prioritet për politikën dhe për të gjitha institucionet e shtetit miratimin e kësaj reforme dhe pritshmëria e tyre ndaj reformës është tejet e lartë, çka risjell edhe një herë në vëmendje përgjegjësinë e këtij komisioni në raport me interesin e qytetarëve të vendit për pritshmërinë e lartë që ata kanë lidhur me reformën në drejtësi.

Pa dyshim, besoj se të gjithë biem dakord që është një lajm shumë i rëndësishëm edhe fakti, vëmendja, që tregon Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Shtëpia e Bardhë ndaj reformës në drejtësi, duke e konsideruar atë një domosdoshmëri për proceset e mëtejshme integruese të Shqipërisë. Gjithashtu, vizita e komisionerit Hahn, i cili pati mundësinë që të takojë të gjithë aktorët politikë në vend, përfshi edhe një pjesë të kolegëve që janë këtu në këtë tavolinë, ishte, gjithashtu, një mesazh shumë i dobishëm në mbështetje të reformës. Pra, nga njëra anë kemi interesin e jashtëzakonshëm, pritshmërinë e lartë të qytetarëve shqiptarë dhe nga ana tjetër kemi gjithashtu interesin dhe pritshmërinë e lartë që kanë partnerët ndërkombëtarë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimi European për reformën në drejtësi.

Të gjitha këto, e thënë shkurt fare, përkthehen në përgjegjësi politike për parlamentin dhe pa dyshim përgjegjësia kryesore i takon kësaj tavoline. Unë jam i bindur

që përtej kësaj pauze dhe arsyeve për të cilat u krijua sot me rifillimin e këtij procesi ne do të demonstrojmë përgjegjshmërinë e nevojshme për ta finalizuar këtë proces.

Në seancat e marsit kemi bërë diskutime për një sërë nga çështjet e trajtuara nga përfaqësuesit e Partisë Demokratike. Do të vazhdojmë pikërisht me pikat e mbetura pezull nga çështjet që opozita ka çmuar se do të duhet të trajtohen dhe të diskutohen në këtë komision, kështu që pa vonesë më lejoni që t'ia kalojë fjalën nënkryetarit, kolegut Halimi.

Eduard Halimi – U bë një farë kohe nga data 23 mars që nuk jemi mbledhur, kjo për shkaqet që dihen dhe janë publike, për shkak se u refuzua ekzekutimi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese lidhur me dorëzimin para drejtësisë të deputetëve, të cilët pretendohet se kanë marrë fonde publike. Ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese ditën e djeshme, sigurisht i hap rrugë edhe ecurisë së këtij procesi, pasi është kreu logjike dhe racionale që ne nuk mund të diskutojmë për të reformuar sistemin e drejtësisë nga njëra anë dhe nga ana tjetër të refuzojmë ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

(Diskutime pa mikrofon.)

Sigurisht, në qoftë se do të ishte bërë më përpara ne do të ishim, e kemi kërkuar që në datën 24 mars dhe u vonua deri ditën e djeshme, kur u bë e mundur. Falënderojmë edhe partnerët ndërkombëtarë për insistimin dhe për angazhimin e tyre në përmbushjen e këtij detyrimi kushtetues, siç është ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nga kushdo Kryeministër, nga kushdo deputet dhe nga çdo qeveri. Ne i kemi diskutuar në mbledhjen e fundit të komisionit një pjesë të çështjeve, kemi përfunduar dhe jemi dakordësuar për komponentin që kishte të bënte me ngritjen e Byrosë Kombëtare të Hetimit, të prokurorisë speciale si çështje, të cilat kanë të bëjnë drejtpërdrejtë me luftën ndaj korrupsionit në sistemin gjyqësor dhe në luftën ndaj korrupsionit në zyrtarët e nivelit të lartë si një proces shumë i rëndësishëm i reformimit të hetimit penal.

Sigurisht, janë një sërë çështjesh teknike që janë ngritur nga Komisioni i Venecias që ne i trajtuam dhe ekspertët në ditët në vijim besoj se do të bëjnë edhe përshkrimin e tyre. Kemi pasur problem çështjet që kanë të bëjnë me emërimin, promovimin dhe disiplinimin e gjyqtarëve. Pra, i gjithë mekanizmi i emërimit, promovimit dhe i shkarkimit të gjyqtarëve, që nuk ka të bëjë me çështjet e korrupsionit,

sepse ato trajtohen nga ana e hetimit penal, pra reformimit të hetimit penal, ky mekanizëm sipas nesh nuk garanton as procesin e llogaridhënies, as parimin *check and balance* ndërmjet pushteteve, pra pushtetit gjyqësor dhe atij legjislativ dhe ka probleme të forta të korporatizmit. Për këtë çështje në diskutimin që ne kemi bërë që herën e kaluar u kemi kërkuar ekspertëve që të rishikojnë procesin e mekanizmit të llogaridhënies, të luftës ndaj korporatizmit në procesin e emërimit dhe disiplinimit të gjyqtarëve dhe të na i sjellin të ripërpunuar për ta parë. Kjo ka të bëjë me të ardhmen e sistemit të drejtësisë, nuk është një masë e përkohshme, ka të bëjë me ngritjen e institucioneve të përhershme, të cilat do të shërbejnë për vite e vite në Shqipëri, ndaj edhe ato duhet të jenë të konsoliduara dhe të kenë parasysh parimet shumë të rëndësishme që kanë të bëjnë me llogaridhënien, me parimin *check and balance* dhe me luftën ndaj korporatizmit.

Kthehemi sot në 5 çështje, ndërsa çështjet e tjera nuk po i përmend, sepse janë çështje për të cilat ne jemi dakordësuar dhe ekspertët do të na japin zgjidhjet e tyre për t'i riparë në ditët në vijim apo javën e ardhshme kur do të bëhet mbledhja e ardhshme.

Çështjet që kanë ngelur për t'u trajtuar në tryezën politike janë: çështja e procesit të vetingut të gjyqtarëve; çështja e procesit të emërimit dhe funksionet e Inspektoriatit të Lartë të Drejtësisë; çështja që ka të bëjë me ndërprerjen e mandateve të organeve kushtetuese ekzistuese.

Çështja e katërt është procesi i emërimit të anëtarëve jo gjyqtarë të KLGJ-së dhe çështja e pestë ajo e emërimit të anëtarëve gjyqtarë jo prokurorë të KLP-së. Pra, këto janë çështjet që na kanë ngelur nga radhët e kaluara për të diskutuar.

Çështja e parë, që ka të bëjë me procesin e vetingut. Do trajtojmë ILD-në kur ta trajtojmë, por ta kemi pastaj në pjesën e saj. Prandaj edhe renditjen e kam bërë që t'i diskutojmë në fund ato.

Çështja e procesit të vetingut. Vetingu, procesi i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve është ndër proceset më të rëndësishme në këtë paketë, të cilin në parim edhe pa dalë akoma amendamentet kushtetuese, që në takimet paraprake që ne kemi pasur me ekspertët e EURALIUS-it në fillim të shtatorit të vitit të kaluar, sapo ata e kanë artikulluar si ide, pra pa u shkruar akoma, unë dhe zoti Bylykbashi, ju kemi thënë që jemi tërësisht dakord në parim për çështjen e vetingut të gjyqtarëve dhe të prokurorëve. Është shumë e rëndësishme dhe besoj që qytetarët mezi presin, që nëpërmjet një procesi të shpejtë dhe

efikas të bëhet e mundur evidentimi dhe largimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve të korruptuar, të cilët nuk justifikojnë as pasurinë e tyre, as qëndrimin në detyrë për shkak të mungesës së performancës së tyre. Është një proces, të cilin e kemi mbështetur pa u artikuluar akoma, e kemi mbështetur pasi u shkrua dhe në të gjitha vërejtjet dhe dokumentet që ka prodhuar grupi i ekspertëve të Partisë Demokratike në muajt shtator, dhjetor, janar, shkurt e me radhë, ne e kemi mbështetur dhe nuk kemi kundërshtuar asnjë element, sepse është vërtet, këtë e them me bindje të Partisë Demokratike, që duhet të marrë përgjigje një orë e më parë.

Problemet dhe shqetësimet që ngrihen në këtë proces nga ana e opozitës kanë pasur të bëjnë me emërimin e anëtarëve të komisionit, pra kush do ta bëjë vetingun, kush do t'i emërojë anëtarët, të cilët do të bëjnë procesin e vetingut. Një shqetësim që ne kemi ngritur edhe në muajin shkurt, që është legjitim, është racional për çdo opozitë, që nuk mund t'ia besojë kryerjen e procesit vetëm një force politike, pra siç është me 84 vota apo me 3/5, siç ishte parashikuar në atë kohë.

Komisioni i Venecias ka dhënë të drejtë edhe në opinionin paraprak, përsëri është insistuar që të ishte sërish kështu, pra nuk është tërhequr maxhoranca nga ky qëndrim dhe përsëri jemi në opinionin final ku përsëri Komisioni i Venecias konstaton se emërimi vetëm nga njëra palë sigurisht që nuk mund të jetë zgjidhje e besueshme dhe e pranueshme për të gjitha palët. Gjithashtu, sugjeron ndërtimin e disa formulave, të cilat kanë të bëjnë me dy momente. Siç dihet nga unë dhe nga zoti Xhafaj po e po, por edhe nga anëtarët e tjerë, sepse si unë dhe zoti Xhafaj jua kemi thënë kolegëve tanë, nga ana e partnerëve ndërkombëtarë janë sugjeruar dy formula, që janë sjellë në tavolinë gjatë kohës që nuk kishte dalë ende opinionin final dhe i është thënë Partisë Demokratike që të zgjedhë njërin nga këto dy formula dhe ajo të ishte e pranueshme. Partia Demokratike ka zgjedhur njërin prej tyre, ndërsa Partia Socialiste ka zgjedhur një tjetër, të paktën siç na është thënë.

Unë me ekspertët kemi qenë në nivel pika kontakti, por kjo është diskutuar në nivelin e drejtuesve të partive politike dhe besoj se është një çështje që do të marrë zgjidhje normale, logjike. Do të marrë zgjidhje, sepse siç e diskutuam me zotin Xhafaj në këto minuta, do t'i lëmë për diskutim në fund çështjen e emërimit të këtyre, sepse që do të marrë një zgjidhje do ta marrë patjetër, që nuk do t'i ketë njëra palë kjo as që

diskutohet, që mos t'i ketë as njëra dhe as tjetra ose të dyja bashkë përsëri kjo as që nuk diskutohet, pra që nuk duhet të jemi dhe të kemi përfaqësuesit tanë politikë, por duhet të jenë komisione që të kenë besimin si të njërit edhe të tjetrit, pra të mos jemi skeptik. Kjo është çështje racionale dhe nuk po ndalem më shumë.

Çështjet të tjera që kanë të bëjnë me vetingun janë ato në lidhje me respektimin e standardeve të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Ky shqetësim është ngritur nga organizatat e gjyqtarëve, shoqatat e gjyqtarëve dhe të prokurorëve dhe i është dërguar Komisionit të Venecias nga ana e tyre. Komisioni i Venecias ka bërë vërejtje, sugjerime, ka bërë thirrje për respektimin e nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, pra të drejtës së ankimit dhe kjo në fakt ishte absurde, por besoj se tani nuk ia vlen që ne t'i rikthehemi këtij diskutimi, pra heqja e të drejtës së ankimit apo çështje të tjera që kishin të bënin me respektimin e Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Përbërja e komisionit të pavarur të kualifikimit dhe kolegjit të posaçëm, si dhe statusi i tyre duhet të garantojnë pavarësinë dhe paanshmërinë e mirëfilltë, e cila duhet të vijë nëpërmjet krijimit të një institucioni të besueshëm nga të dyja palët, si dhe periudha e gjatë që ishte, por edhe nga ndryshimet që iu bënë draftit final me vendimin final ajo është përcaktuar me një afat 3 deri në 5 vjet dhe Komisioni i Venecias e ka kryer këtë proces.

Çështje të tjera, të cilat janë të rëndësishme, por jo kryesore dhe sigurisht ku nuk mund të cedohet, kanë të bëjnë me përfshirjen në procesin e përzgjedhjes të anëtarëve të Avokatit të Popullit. Avokati i Popullit teorikisht duhej të mendohej si një institucion i pavarur, si një institucion, i cili duhet të kishte besimin e të gjitha palëve politike. Praktikisht ne të gjithë e dimë që Avokati i Popullit ka qenë një ngërç institucional disavjeçar ndërmjet opozitës së djeshme dhe maxhorancës së djeshme. Për shkak të këtij ngërçi maxhoranca e kaluar ia ka lënë opozitës së kaluar për ta zgjedhur dhe në selinë e Partisë Socialiste është zgjedhur me konkurs Avokati i Popullit, për të cilin maxhoranca e djeshme ka dhënë votat, domethënë ia ka besuar dhe nuk kemi asnjë lloj shqetësimi. Në këtë proces të ri që kemi përpara besoj se palët kanë nevojë për më shumë besim te njëra-tjetra. Për të mos iu kthyer më këtij debati të vjetër, ne mendojmë se këtë proces duhet ta bëjë edhe një institucion tjetër, jo Avokati i Popullit. Teorikisht nuk duket e bukur. Komisioni i Venecias sigurisht ka të drejtë, sepse Komisioni i Venecias kur i bën

vendimet, nuk i bën vetëm për Shqipërinë apo për raste konkrete, i bën për të gjitha vendet anëtare të Këshillit të Europës. Por në këtë rast, ne mendojmë se duhet të jetë dikush tjetër që ta bëjë pjesën e zgjedhjes, gjë që besoj se zgjidhet dhe besoj se do të insistohet në këtë çështje.

Për sa i përket çështjes së emërimit të komisioneve dhe akreditimit të vëzhguesve ndërkombëtarë, është parashikuar që të bëhet nga Kryeministri. Këtu besoj se palët duhet të bien dakord se nuk mund ta bëjë, nuk mund t'i besohet Kryeministrit, jo vetëm për shkak të klimës politike në të cilën ndodhemi sot, por edhe për shkak të një besimi që palët duhet të kenë te njëra-tjetra. Pra, duhet t'i besohet një institucioni tjetër në përfundim të kësaj çështjeje.

Unë kam këtu edhe një sërë çështjesh që ekspertët i kanë nxjerrë nga leximi që i bëjnë Komisionit të Venecias, çështje që kanë të bëjnë me respektimin e të drejtave të gjyqtarëve, liritë personale e me radhë. Besoj se këto do të jenë çështje të diskutimit të më pasëm, por edhe të diskutimit që do të bëjnë ekspertët e OPDAT-it, EURALIUS-it së bashku me ekspertët tanë për t'i zgjidhur dhe për t'i implementuar një më një, pasi besoj se askush nuk do të thotë se nuk do të implementohet një më një dhe germë për germë çdo pikë e asaj që ka thënë Komisioni i Venecias, për të respektuar pikë për pikë Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Në përfundim të kësaj pike, në emër të Partisë Demokratike unë do të thosha: komponenti i vetingut është komponent ndër më të rëndësishmit e paketës së ndryshimeve kushtetuese; është një komponent, i cili do të sjellë një impakt të shpejtë, të menjëhershëm dhe eficient për largimin një orë e më parë të gjyqtarëve dhe prokurorëve, të cilët nuk i justifikojnë as pasuritë e tyre dhe nuk e justifikojnë as qëndrimin për shkak të mungesës së performancës. Ne jemi dakord që ky proces të fillojë një orë e më parë, me të gjithë komponentët që përfshihen në të. Procesi i vetingut është përgjigjja më e mirë që duhet të vijë ndaj shqetësimit të qytetarëve lidhur me korrupsionin lartë në sistemin e drejtësisë: gjyqësor dhe në prokurori. Ky proces duhet të fillojë të ecë një orë më parë!

Të gjitha çështjet që unë rendita besoj se janë çështje të zgjidhshme, nuk janë çështje që mund të ngelen palët. Ekspertët brenda disa ditëve, pra në ditët në vijim, sepse disa kohë do t'u duhet ekspertëve për t'i implementuar të gjitha elementet që vijnë nga

Komisioni i Venecias, të na i sjellin dhe ky komponent, pra komponenti i vetingut për gjyqtarët dhe prokurorët, të bëhet sa më shpejt. Të gjithë funksionarët e sistemit të drejtësisë, me mandat apo pa mandat, të cilat gjenden në shkelje të ligjeve të vendit duhet të përballen me sanksionet e duhura kushtetuese që u vihen nëpërmjet këtyre amendamenteve.

Ky është qëndrimi ynë lidhur me pikën e parë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Besoj se më shumë jo për ndarjet që mund të kemi në këtë çështje, por për rëndësinë që ka kjo çështje, edhe zoti Halimi i dha më shumë kohë për shkak se nëse do t'i hynim thelbit të problemit, nuk besoj se ka shumë gjëra për t'u diskutuar në rafshin politik.

Unë e kam trajtuar për herë të parë personalisht këtë çështje në prill të vitit 2015. Të jem i sigurtë, kurrë nuk e mendoja se do të ishte në një format të tillë për shkak të mungesës, njohjeve dhe njohurive në këtë fushë.

Pa dyshim, gjithçka buronte nga nevoja, nga domosdoshmëria për të pasur një proces që do t'ju thoshte: “ndal” disa individëve që janë brenda sistemit në radhët e gjyqtarëve, të prokurorëve, në mënyrë të veçantë, që nuk meritojnë të jenë gjyqtarë dhe prokurorë të Republikës së Shqipërisë. Por, nga ajo kohë deri sot ka kaluar një periudhë e gjatë dhe kemi një dokument, që besoj edhe më skeptikët do t'i bënte optimistë, për një dokument të standardeve më të mira ndërkombëtare.

Në vlerësimin tim, këtu ekspertët kanë bërë një punë të shkëlqyer, sepse kanë mundur të mbledhin eksperiencat më të mira pozitive, të analizojnë dështimet dhe sukseset në procese të ngjashme, të përfitojnë nga gabimet dhe njëkohësisht të konsolidojnë eksperiencat pozitive dhe modelet pozitive. Natyrisht, nuk është një gjë e lehtë, nuk është ndonjë gjë e zakonshme, por është tërësisht e justifikueshme, siç e pranojmë ne bashkërisht, siç e pranojnë partnerët, siç e pranon edhe Komisioni i Venecias, në kushtet që ka vendi ynë për të mbështetur një reformë radikale në sistem.

Drafti, në mënyrën se si është sot, mendoj se është një draft që i plotëson pritshmëritë. Natyrisht, ka disa gjëra, edhe për shkak të faktit që është një proces me shumë të panjohura, me modele jo të gatshme dhe që ka nevojë herë pas here të

reflektohet. Jo pa arsye edhe vetë Komisioni i Venecias, qoftë në raportin e ndërmjetëm, edhe tani në versionin final, është ndalur posaçërisht në këtë pjesë të projektit kushtetues.

Nga ana tjetër, duhet të mbajmë në konsideratë edhe faktin që vetë Brukseli ka pasur një impenjim të posaçëm për këtë çështje. Të paktën në dy-tre takime që kam pasur, edhe si kryetar i komisionit me ta, kam parë një preokupim të jashtëzakonshëm për të bërë një proces në standardet më të mira ndërkombëtare, por njëkohësisht, duke mbajtur në konsideratë edhe specifikat që ka vendi, duke mbajtur në konsideratë edhe përgjegjësinë që ata vetë do të kenë në këtë proces. Që të jemi të drejtë me njëri - tjetrin, që të jemi të hapur, në finale, pavarësisht se çfarë është thënë, Brukseli ka marrë këtu një përgjegjësi të jashtëzakonshme, pra i ka dhënë vetes një përgjegjësi jo të zakonshme, jo të ngjashme me raste të mëparshme. Kjo është arsyeja që i jep më shumë garanci këtij procesi, i jep besueshmëri dhe unë mendoj edhe garanci për suksesin tij, por, edhe për paanshmërinë e procesit.

Gjithsesi, i quaj legjitime të gjitha shqetësimet që ka ngritur Komisioni i Venecias, por edhe çdo shqetësim dhe propozim tjetër që mund ta përmirësonte. Tashmë qoftë ekipi i EURALIUS-it, qoftë i OPDAT-it kanë një përvojë të madhe në hartimin e kësaj pakete dhe munden t'u përgjigjen shumë mirë shqetësimeve ose sugjerimeve që ka bërë Komisioni i Venecias, por edhe ato që mund të ngrihen këtu, për ta përmirësuar më tej këtë pjesë.

Për të mos u zgjatur, po u përgjigjem disa shqetësimeve që ngriti kolegu Halimi. Nuk po ndalem te çështja e emërimit, për shkak se do ta diskutojmë kur të shqyrtojmë të gjithë procesin e emërimit të institucioneve.

Jam dakord me të gjitha sugjerimet që lidhen me Gjykatën e të Drejtave të Njeriut, nuk ka diskutim, se nuk kemi pse e përmendim fare. Është një çështje që unë mendoj se do ta trajtojnë vetë ekspertët.

Rishikimi i afatit është i drejtë, por në dijeninë time këtë shkurtim të afatit Brukseli e ka zgjidhur me shtimin e njerëzve që do të punojnë, që lidhet natyrisht edhe me shtimin e numrit të komisionerëve. Numri më i madh do të japë një produkt më të shpejtë në kohë. Kështu që është një çështje që nuk kemi pse biem dakord, siç u tha.

Për sa i përket çështjes së Avokatit të Popullit, mendoj se këtu Komisioni i Venecias ka qenë i qartë, madje është ndër të paktat raste që ka adresuar një kritikë në

sensin se në raportin e ndërmjetëm nuk ishte arritur ta kuptonte ose t'i jepte një përgjigje shumë më të qartë. Pra, është, pra një sens autokritik i tij.

Unë mendoj se nuk ka arsye pse të mbahemi peng i kësaj çështjeje, sepse Avokati i Popullit nuk ka ndonjë rol, në fakt, me sa e kuptoj unë këtë proces. Si e kuptoj unë? Avokati i Popullit do të jetë, si të thuash, pritësi i kërkesave, do të bëjë një listim dhe asgjë më shumë. Nuk do t'i rendisë ato sipas meritës, thjesht, do të bëjë një listim dhe do të bëjë pritjen e dokumenteve.

Për sa i përket çështjes së akreditimit, është një gjë që e ka zgjidhur Venecia. Kjo do të jetë patjetër pjesë e memorandumit, që do të nënshkruhet ndërmjet qeverisë dhe Brukselit, Komisionit Europian. Akreditimi është akreditim formal, nuk është akreditim substancial, nuk ka të bëjë me procesin e përzgjedhjes. Procesi i përzgjedhjes është një obligim, që do ta marrë përsipër vetë Komisioni Europian nëpërmjet drejtorisë përkatëse.

Kështu që akreditimi është një gjë formale dhe është normale që të ndodhë ky proces nga Kryeministri. Po deshët, kalojani ministrit të Jashtëm, nuk ka ndonjë gjë të keqe, por mendoj se diku do të akreditohen ata, sepse këtë nuk mund ta bëjë, besoj unë, parlamenti.

Kjo është pak a shumë çështja, gjithsesi le të shikohet gjatë ritrajtimit që do t'i bëhet edhe nga ekspertët. Nëse ka ndonjë zgjidhje tjetër alternative, ne nuk jemi shumë të shqetësuar për këtë gjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Ne jemi të gëzuar që ta dëgjojmë përgjigjen, se më në fund do të ketë një proces vetingu në këtë vend dhe disa që nuk e meritojnë të jenë në sistem, nuk do të jenë më. Këtë po e them, që ta dëgjosh.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Po, pra.

Oerd Bylykbashi – Siç e tha edhe zoti Halimi, ne e kemi dhënë dakordësinë e plotë për procesin e vetingut, si një element thelbësor, absolutisht i domosdoshëm për të kryer një reformë, e cila do të ketë kuptimin si një reformë në drejtësi.

Unë besoj se ne sot kemi nevojë për reformën në drejtësi për të reformuar sistemin, që është një gjë, dhe për të pastruar gjyqtarët e korruptuar ose të paaftë, që është

një gjë tjetër. Për gjyqtarët e korruptuar dhe të paafte ne nuk mund të shkatërrojmë sistemin dhe ta bëjmë copa- copa. Pra, do të korrigjojmë njërin dhe do të pastrojmë pjesën tjetër. Vetingu i duhet, pikërisht, pjesës së pastrimit. Në fakt, të gjithë ne e dimë se perceptioni për sistemin e drejtësisë është i rënduar dhe, kryesisht, vjen për shkak të korrupsionit të individëve në këtë sistem. Këtë na e thotë edhe Komisioni i Venecias. Këtë e dimë, por Komisioni i Venecias thotë edhe diçka: “Kujdes, mos e rëndoni më tej perceptimin”. Kjo do të thotë që ne duhet të jemi shumë të matur, të kujdesshëm, të zgjuar, me mendje të hapur dhe të ndriçuar, pasi vetingu, në njëfarë mase, është domosdoshmëri, është një e keqe e domosdoshme, sepse është një karantinë që ne duhet ta bëjmë patjetër, por duhet ta bëjmë në një mënyrë të tillë, që mos të krijojmë probleme të tjera për perceptimin negativ mbi procesin e reformës. Thashë, që për mua është një lloj karantine, por që duhet ndërtuar në mënyrë të tillë që sa më shpejt ne të dalim nga nevoja për ta vazhduar, ashtu siç është parashikuar deri sot edhe Komisioni i Venecias thotë: “Nuk është e pranueshme, një karantinë e zgjatur që më pas jo vetëm krijon dublikim, institucioneve me kompetenca të njëjta, të atyre që do të jenë permanente dhe atyre që do të jenë të përkohshme, (permanente janë impotente dhe të përkohshmet janë superpotente në një proces), por krijon një lloj pezullie, që më edhe në perceptimin publik mund të ndërtojë negativitet, edhe në jetë mund të hapë mundësi për të ushtruar presion, duke tundur fletë, por duke mos i vënë në zbatim ato fletë” Pra, kush ka një skelet në dollap, le të ikë, jo të mbahet peng!

Kështu që besoj se do të na duhet ta ndërtojmë me kujdes jo vetëm për sa u përket institucioneve të vetingut, por edhe kohën, edhe mënyrën si do të funksionojë. Por vetingu duhet të jetë i thellë, i plotë, pa diskutim dhe një për një të ikën të gjithë. Sigurisht, duke bërë kujdes që vetingu, nga ana tjetër, të kemi mundësinë ta favorizojmë, në mënyrë të tillë, që të plotësojmë boshllëqet që krijohen.

Kështu që unë gjykoj se ekspertët të gjejnë zgjedhjen më të mirë të mundshme që vetingu sa më shpejt të fillojë të transferojë kompetencat reale tek ato institucione, që pasi është kryer procesi do ta ushtrojnë edhe në të ardhmen, edhe pas 5, 10, 20 vjetësh këto detyrë. Kështu që, duke bërë një balancë të kujdesshme për të transferuar sa më shpejt kompetencat tek institucionet e sistemit të drejtësisë shqiptare, të atyre që ne pas vetingut do t'i besojmë, nuk kemi arsye të mos i besojmë, të mos u mbajmë një proces të

te jzgjatur, me kompetenca të dublikuara midis institucionesh. Besoj se ekspertët kësaj do t'i japin një zgjidhje të kujdesshme dhe të mençur.

Do të them dy fjalë edhe për Avokatin e Popullit. Kam qenë në tryezën e famshme të krokodilit kur në atë kohë maxhoranca i propozoi opozitës që ta zgjidhte vetë, pra të propozonte kandidatë dhe maxhoranca do t'i jepte opozitës mbështetjen, me kusht që të mos ishte persekutor i komunizmit. U mirëprit. Por ajo që çuditi të gjithë ishte që në vend që të bëhej një proces parlamentar decent, sipas rregullave të rregullores, u bë një proces hiperpolitik në selinë e Partisë Socialiste. Çdo gjë që mund të thuhet pozitivisht për individët që mund të kenë dalë nga ai proces, është korrumpuar në perceptcion që në fillim, dhe për rrjedhojë vetëm për këtë duhet të mendojmë. Pra, çështja nuk është se çfarë ka thënë diku një raport shumë i rëndësishëm, që nuk e di hallin tonë, por që i la të gjithë pa frymë kur u zhvillua. Pra, të mos i marrim gjërat thjesht, por t'i ndërtojmë me kujdes ingredientët e këtij procesi, se përndryshe, nëse do të krijojmë mosbesim te një proces kaq i rëndësishëm, i domosdoshëm në komponentin antikorraktiv, do të na krijohen probleme.

Faleminderit!

Eduard Halimi - Nëse nuk ka gjë tjetër, unë dua të them dy-tre gjëra të vogla në përfundim të kësaj çështjeje.

I kushtova më shumë vëmendje dhe u zgjata më tepër te kjo pikë, sepse procesi i vetingut është shumë i rëndësishëm. Po aq e rëndësishme është që për zgjidhjen e këtij problemi të rëndë, të bazohemi në modelet më të mira. Modelet e propozuara paraprakisht nga Partia Socialiste kanë qenë të besuara, kanë qenë me defekte, siç ka qenë edhe çështja e Byrosë Kombëtare të Hetimit. Pra, modelet për ngritjen e Byrosë dhe prokurorisë ishin defektoze, sepse ishin pranë Kryeministrit dhe ne nuk mund të dakordësohemi me këtë. Nuk mund të them se është ideja e iksit apo e ipsilonit, por është e Kryeministrit, ndaj ne duhet të vinim në një model, i cili të përfshinte dhe të përbënte një nga standardet themelore të luftës kundër korrupsionit, që nuk duhet të jetë afër kujtdo kryeministri qoftë.

Procesi i vetingut në modelin dhe në draftin që vjen sot (duke hequr komponentët “Rama” vs “Totozani”, apo emërimin nga Rama të të gjithëve, gjë e cila shpresoj të gjejë zgjidhje), ashtu siç vjen nga Komisioni i Venecias është brenda

standardeve. Në momentin kur ky proces u propozua ka qenë difektozë, sepse në atë kohë synohej testimi me gojë i gjyqtarëve dhe i prokurorëve. Pra, propozimi fillestar ka qenë për testimin e njohurive me gojë të gjyqtarëve dhe prokurorëve, madje edhe testimi psikologjik.

Në diskutimet paraprake, para se të bëheshin amendamentet, unë kam pyetur dy ekspertët: “Vërtet doni që këtë gjë ta shkruani në amendamente? Pra, që të bëni testimin me gojë të gjyqtarëve dhe prokurorëve?” Ata më thanë: “Kjo është e paimagjinueshme. Nuk do të ndodhë”. Pse? Jo se ishte ndonjë shpikje dhe as mendimi i ndonjë prej anëtarëve këtu, por ishte një model serb. Pra, modeli i testimit të gjyqtarëve me gojë ishte model serb, i bërë para dy vjetësh, por në momentin kur u miratuan amendamentet kushtetuese, të cilat u duartrokitën nga të gjithë, ky proces më pas prodhoi defekte të rënda. Ekspertët më kanë thënë që, para hartimit të amendamenteve, ky proces prodhoi defekte të rënda, sepse gjyqtarët dhe prokurorët u morën në mesnatë në testim me gojë dhe u shkarkuan për 15 minuta pasi nuk dinin një pyetje. Ai proces vetingu ishte difektoz dhe kishte një problem të madh. Kjo gjë nuk u shkrua nga ekspertët, por ishte menduar në atë kohë dhe u trajtua si i tillë edhe në Serbi.

Në Serbi kishte probleme edhe në shkarkimin gjyqtarëve, pasi ata shkuan në Gjykatën Kushtetuese, por kishte edhe shumë probleme të tjera që janë kthyer dhe janë rikthyer, prandaj ai proces ishte defektoz.

Zoti Xhafaj, tema është kjo: kur proceset bëhen sipas modeleve europiane pozitive, atëherë sjellin pritshmëri; kur bëhen sipas ideve komplekse, kundërshtohen. Unë e kam thënë shumë herë edhe para Kryeministrit, edhe para komisionerit Hahn, që, në qoftë se procesi i vetingut do të ishte bërë në mirëbesim të palëve, siç u ra dakord në gusht, pra të ishim ulur dhe ta kishim shkruar bashkë, atëherë ky proces do të kishte përfunduar që para tre muajve. Tani ka ardhur momenti që t’i lëmë grindjet me njëri-tjetrin, se dy juristë janë tre mendje, e ka mirë ky dhe s’e ka mirë ky tjetri. Në këtë moment kemi “Venecian”, ku ekspertët duhet ta lexojnë dhe ta implementojnë një më një ashtu siç është sot. Duhet të implementojnë edhe një shqetësim tjetër, që me të drejtë e ngriti zoti Bylykbashi, problemin e mbivendosjes së organeve për këto tre vjet, që nga njëra anë do të jetë komisioni i vetingut, ILDKP-ja dhe këtë nuk e ndajmë ne, por e

zgjidhin ekspertët. Lidhur me Avokatin e Popullit apo “Rama” vs “Totozani” nuk duhet të ngulim këmbë kot, se nuk kanë vend në këtë proces.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë po them që Avokatin e Popullit të mos e ngarkojmë kot në këtë proces, se nuk ka vlerë. E dini pse? Ne kemi thënë se do të biem dakord që ky komision do të ngrihet me besimin e të gjitha palëve. Derisa do të ketë besimin e të gjitha palëve, do të ketë besimin tonë edhe besimin tuaj...

Fatmir Xhafaj - Palët kanë rënë dakord që besimin e tyre do ta ndërtojnë mbi opinionin e Komisionit të Venecias.

Eduard Halimi - E lëmë tani këtë pjesë, se nuk do të zihemi për “Mustaqet e Çelos”.

Për sa i përket Avokatit të Popullit, është e kotë që ta mbajmë këtë.

Së dyti...

Fatmir Xhafaj - Ju lutem, mos kaloni nga një degë në degën tjetër! Fokusohuni te kjo gjë!

Eduard Halimi - A doni që t’u kthehem edhe unë tani degëve dhe kërcejve? Mos na fol për degë dhe kërcej, se për këtë çështje po flas!

Lidhur me pjesën e emërimit të vëzhguesve kombëtarë nga Kryeministri ju thatë që është ceremonial. Meqenëse është ceremonial dhe Kryeministri nuk ka asnjë rol, atëherë pse t’ia lëmë Kryeministrit? Pra, le të mendojmë për një organ tjetër që ka besimin tonë. A doni t’ia lëmë Presidentit?

Fatmir Xhafaj - Patjetër! Po pse në këtë vend vetëm tek ai kanë besim të gjithë?

Eduard Halimi - Po mirë, a doni që t’ia lemë kryetarit të bashkisë? Pra, mund të jetë një komision

Fatmir Xhafaj - Më fal, kush i akrediton këto?

Eduard Halimi - A kemi një komision paritar ne këtu? E bëjmë ne atë pjesë dhe nuk kemi pse t’ia lëmë Kryeministrit!

(Diskutime pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Nuk është trup diplomatik, por është memorandum ndërkombëtar.

Eduard Halimi - Ne memorandumun kombëtar nuk ia lëmë dot Kryeministrit. Ne po diskutojmë që të ndërtojmë një proces konsensual midis palëve, por, në qoftë se figura konsensuale i këtij procesi është Kryeministri, është e kotë që flasim. Pra, këtë proces ose duhet ta ketë një institucion, i cili është jashtë palëve politike, edhe *de jure*, ose do ta kemi ne si komision paritar, por nuk besoj që do të ngelemi te kjo pikë.

Fatmir Xhafaj - Nuk ka status komisioni, mos na çudisni në të drejtën kombëtare! Nuk do të bëjmë shpikje, se ky komision nuk ka status për të certifikuar vëzhguesit!

Eduard Halimi - Jo për t'i certifikuar.

Fatmir Xhafaj - Po çfarë po na thua?

Eduard Halimi - Po pse Edi Rama do ta bëjë certifikimin e ekspertëve? Çfarë po na thua kështu? Çfarë muhabeti është ky tani, pse ka status Edi Rama për të certifikuar?

Fatmir Xhafaj - Ai do të bëjë pranimin. Marrëveshjet nuk shkruhen në komisione të posaçme.

Eduard Halimi - Nuk do të bëjë certifikimin, por akreditimin.

Fatmir Xhafaj - Po akreditimin kush e bën?

Eduard Halimi - Të kujt? Të ekspertëve që do të merren me testimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve? Po pse këtë shqetësim kemi ne tani?

Fatmir Xhafaj - A e kaluam çështjen e vetingut? Thamë sipas Komisionit të Venecias.

Eduard Halimi - Për procesin e vetingun ekspertët ripërpunojnë draftin sipas rekomandimet te Komisionit të Venecias për të gjitha pikat që flasim, qoftë për vëzhguesit ndërkombëtarë, qoftë për pjesën e të drejtave të gjyqtarëve, të prokurorëve, të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut e me radhë të na i sjellin, ne ta miratojmë dhe të ecim sa më shpejt me procesin e vetingut.

Fatmir Xhafaj - Në rregull!

Faleminderit!

E lamë që do ta bëjmë sipas opinionit zyrtar të Komisionit të Venecias.

(Diskutime pa mikrofon)

Fatmir Mediu - Ne këtu nuk do të bëjmë ndonjë shpikje, sepse mënyra e organizimit dhe e funksionimit të shtetit shqiptar dihet.

Së pari, Presidenti i Republikës është kryetari i shtetit, i cili bën akreditimin e trupave diplomatikë.

Së dyti, Presidenti i Republikës është kryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe është autoriteti më i lartë në marrëdhëniet me drejtësinë. Nëse këtë autoritet ne ia delegojmë Avokatit të Popullit, Kryeministrit apo të tjerëve me radhë, nuk do të bëjmë gjë tjetër veçse do të shtrembërojmë thelbin e vetë Kushtetutës dhe autoriteteve kushtetuese në këtë vend. Kështu që le t'u referohemi autoriteteve kushtetuese, mënyrës së organizimit dhe funksionimit të shtetit për të arritur në atë përfundim që duhet.

Nëse ju sot mendoni se çështjen e shikoni për të përdorur një figurë të caktuar në një pozicion të caktuar dhe ejani që ta bëjmë kështu, kjo nuk i shërben këtij qëllimi që duam ne. Pra, shqetësimi është që të gjejmë pa dyshim autoritete të balancuara për të arritur tek ajo çka duhet, por duke respektuar Kushtetutën e këtij vendi.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Ka tjetër për...

Eduard Halimi - Kam edhe diçka tjetër, se ne tani mbaruam me procesin e vetingut dhe ngelëm te vëzhguesit ndërkombëtarë!

Shqetësimi ynë nuk ka lidhje fare me vëzhguesit ndërkombëtarë. Procesi është se i gjithë korpusi i të gjithë strukturës të ketë konsensusin e të gjitha palëve. Nuk është çështja që ne të mos njohim se kush do të jetë komisioner apo të themi që duhet të vijë ky apo ai tjetri, pra nuk është ky problemi. Problemi është që, meqenëse ju insistoni tek Avokati i Popullit, atëherë le të bëjë ai emërimin e komisionerëve. Ejani ta diskutojmë dhe ta zgjidhim çështjen e emërimit të komisionerëve se...

Fatmir Xhafaj - Do t'i mbyllim të gjitha bashkë.

Eduard Halimi - E diskutojmë tani këtë çështje.

Fatmir Xhafaj - Dakord, e diskutojmë!

Eduard Halimi – Problemi ynë është se kur do ta bëjmë procesin e vetingut. Po kush do ta bëjë këtë proces? Shqetësimin ynë nuk se kush do ta bëjë, rëndësi ka që komisioni të ketë besimin e palëve. Ne kemi dy formula të propozuara nga

ndërkombëtarët. Komisioni i Venecias thotë: “Jo 3-5-at, jo 2/3-at”. Pra, 3/5-at është kapje dhe 2/3-at është çimentim. Kështu që duhet të gjendet një prej këtyre formulave.

Formula e përzgjedhur prej nesh, nga ato të dyja që kanë sjellë partnerët tanë të fushës së ekspertëve, siç janë gjyqtarët, juristët, avokatët, profesorët, është që të hartohet një listë sipas propozimit që bën Komisioni i Venecias, ku do të ketë përfaqësues të cilët do të kenë besimin e maxhorancës, përfaqësues që do të kenë besimin e opozitës, të mos jenë përfaqësues nga politika dhe të mos jenë të emëruar në politikë, por të jenë të balancuar midis palëve dhe të kenë besimin e të dyja palëve.

Ekspertë i kemi këtu dhe njëra nga formulat që ata kanë propozuar është pranuar prej nesh. Ndaj, mendoj që të ecim me këtë dhe ta zgjidhim, se po u zgjidh kjo gjë, nuk kemi çfarë të diskutojmë më për Avokatin e Popullit dhe çfarë rëndësie ka pjesa tjetër.

Fatmir Xhafaj - Quartë!

Faleminderit!

Meqenëse i hymë këtij diskutimi, unë përsëri do t’i qëndroj besnik asaj që të gjithë jemi dakordësuar dhe që gjithçka do ta mbështesin te opinioni final i Komisionit të Venecias. Përtej shpikjeve që mund të bëjmë dhe që mund të jenë të suksesshme, besoj se Komisioni i Venecias ka dhënë një zgjidhje, të cilën do të duhet ta elaborojnë ekspertët për mënyrën se si e shikojnë ata dhe se cila do të jetë zgjidhja që ata do të japin në funksion të propozimit të Komisionit të Venecias.

Komisioni i Venecias në pikën 61 të tij ka thënë: “Faza e dytë është zgjedhja e kandidatëve me 3/5-at e votave në parlament. Opozita si në rastin e KLGJ-së dhe KLP-së insiston që anëtarët e komisionit të vlerësimit të zgjidhen me 2/3-at e votave”.

Komisioni i Venecias përsërit: “Të gjitha zgjidhjet do të ishin të ligjshme. Megjithatë, për të shmangur ngërçin politik, i cili është i mundur në rast të një pragu tepër të lartë, ligjbërësi mund të konsiderojë modele të tjera alternative të zgjedhje së anëtare të KPK-së dhe VSK-së.” Pra, Komisioni i Venecias përsërit që i takon sistemit shqiptar që të zgjedhë anëtarët e KPK-së dhe të gjyqtarëve të VSK-së.

Gjithashtu ka një *footnote*, te 17-a, në të cilën shprehet: “Komisioni i Venecias nuk ka diskutuar modele të tjera të mundshme, që përfshijnë pjesëmarrjen e komunitetit ndërkombëtar në procesin e zgjedhjeve të anëtarëve të KPK-së dhe VSK-së, pasi ato nuk përbëjnë pjesë të tekstit origjinal të projektamendamenteve të rishikuara”. Megjithatë, do

t'u lihej autoriteteve shqiptare për të shqyrtuar ide të tilla, si për shembull: përfshirja e operacionit ndërkombëtare të monitorimit në vlerësimin e kualifikimit të kandidatëve në pozicionet brenda KPK-së dhe VSK-së". Si e përkthej unë këtë?! Do të doja që kjo të jetë një çështje e shtruar për zgjidhje nga ekspertët ndërkombëtarë. Pra, unë e kuptoj kështu: në ligjin përkatës ne do të vendosim disa kritere, 1, 2, 3, 10 apo 20 kritere. Mbi bazën e këtyre kritereve do të ketë kandidatë që do të shfaqin interesin e tyre. Avokati i Popullit thjesht do të bëjë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë po them ashtu siç është sot në draft.

Pra, Avokati i Popullit do të bëjë mbledhjen e këtyre kandidaturave dhe një raport se kush i plotëson dhe kush nuk i plotëson kushtet ligjime, por nuk do të bëjë vlerësimin në meritë të kandidatëve. Këtë që thotë Komisioni i Venecias unë e kuptoj kështu: meqenëse ju ziheni shpesh për këtë gjë lëruani ndërkombëtareve me memorandum. Pra, Kuvendi i Shqipërisë të bëjë memorandumin me Brukselin apo me këdo tjetër, por në dijeninë time besoj se do të bëhet me Komisionin Europian, dhe lëruani atyre kompetencën që të vlerësojnë listën, kandidatët dhe të bëjnë përzgjedhjen, në të dyja rastet si për shkallën e kualifikimit, qoftë edhe të gjyqtarëve. Nga ky telash shpëtojmë edhe ne dhe nuk i hyjmë çështjes që e ka zgjedhur PS-ja, e ka zgjedhur PD-ja, e ka zgjedhur LSI-ja apo e ka zgjedhur PR-ja. Pra, këtë proces ua lëmë në tërësinë e tyre, që nga momenti i përzgjedhjes dhe pastaj në vazhdimësi pjesës ndërkombëtarëve me një rol aktiv dhe ne baraslargohemi nga ky proces, i cili është shumë delikat, shumë i diskutueshëm dhe njëkohësisht i atakueshëm në sensin e interesave që prek. Pra, le ta shikojmë edhe këtë si një zgjidhje.

Eduard Halimi - Pra, ta përjashtojmë parlamentin?

Fatmir Xhafaj - Ata do të bëjnë kualifikimin, po pastaj le ta vendosë parlamenti. Ka dy mënyra: një mënyrë t'u lihet atyre automatikisht që të bëjnë përzgjedhjen, ku të thonë: "Kanë ardhur 20 kandidatura dhe me këto 20 kandidatura, na duhen 10 veta, që të jetë memorandum dhe ne ta pranojmë. Një zgjidhje mund të jetë kjo. Më pas mund të jetë e nevojshme, mund ta lëmë me memorandum se, në qoftë se ka një rast përjashtimor, ne mund të bëjmë një apo dy përjashtime për të siguruar konsensusin midis nesh dhe atyre. Kjo mund të jetë një zgjidhje, një nga mundësitë, si e kuptoj unë

Komisionin e Venecias, që është shumë i qartë. Do të doja që ekspertët ta marrin në konsideratë këtë fakt dhe ta shtjellojnë si një alternativë të mundshme. Se çfarë forme do të jetë kjo, është çështje që mbetet për t'u trajtuar në praktikë, por mendoj se mund të jetë një zgjidhje që na largon ne dhe i jep më shumë besueshmëri dhe qëndrueshmëri procesit në vijim.

Romana Vlahutin - *(Flet ambasadorja në anglisht).*

Më lejoni të bëhem pjesë e Komisionit, sepse fatkeqësisht më duhet të largohem. Kjo pjesë ka qenë një shqetësim i madh për ne dhe ka pasur shumë diskutime edhe me Komisionin e Venecias se si ta bëjmë këtë transparente dhe jo politike. Mendoj se është më mirë që ekspertët t'u shpjegojnë juve të gjitha detajet për çdo çështje, sepse ju e dini që ka një mision monitorimi shumë të fuqishëm që do përfshijë gjyqtarë të lartë evropianë në këto komisione. Është menduar me detaje dhe mendoj që është më mirë që të lëmë këtu atë që kanë këshilluar ekspertët evropianë dhe amerikanë. Duhet të ketë një marrëveshje formale përparë komunitetit ndërkombëtar dhe shtetit shqiptar. Mendoj që zgjidhjet që janë menduar janë të mira, të pranueshme dhe të qarta. Kjo është ajo që duhet, sepse kjo është një pjesë shumë e prekshme e të gjithë reformës. Faleminderit për punën e bërë, kjo është një reformë shumë e rëndësishme për Shqipërinë dhe të gjithë ne e mendojmë këtë dhe vizita e komisionerëve e konfirmoi këtë. Shpresojmë që të kemi një miratim përpara verës dhe që në fund të këtij viti Shqipëria të ngjisë një shkallë tjetër në integrimin evropian. Faleminderit !

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja ambasadore!

Jeni të mirëpritur!

Zoti Halimi, urdhëroni!

Eduard Halimi – Do të vazhdoja edhe unë me deklarata politike, por tani nuk ka më vlerë.

Kemi një propozim të ri nga ju.

Fatmir Xhafaj – Ai që thashë unë, nuk është propozimi im.

Eduard Halimi – Po, kemi një propozim të ardhur nga ju.

Fatmir Xhafaj – Jo, është këtu.

Eduard Halimi – Fatmir, më kundërshto më pas.

Fatmir Xhafaj – Është te faqja 14.

Eduard Halimi – E lexova.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Eduard Halimi – Kemi një propozim të ri, i cili sugjeron të hapet një konkurrim për aplikantët e këtyre vendeve, të aplikojnë të gjithë sipas kriterëve. Ne duhet t'i vendosim kriteret që tani në Kushtetutë, që të mos i bëjmë më mbrapa. Në qoftë se themi se anëtarët e KPK-së duhet të jenë...

Fatmir Xhafaj – Do të kalojë ligji bashkë me Kushtetutën.

Eduard Halimi - Dakord, do të kalojë ligji bashkë me Kushtetutën. Shumë mirë!

Fatmir Xhafaj – Mund të kalojë dy ditë më pas, por ç'rëndësi ka nëse do ta kemi miratuar si paketë.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Eduard Halimi - Ne i miratojmë si komision dhe parlamenti i bën me kalendarin e vetë.

Fatmir Xhafaj – E qartë.

Eduard Halimi – Kështu është edhe për këtë, edhe për Byronë, edhe për STAK-un pas pak kohe.

(Diskutime pa mikrofon).

Edhe më shumë mund të kemi. Pra, ideja është që të shpallen vendet vakante, të vendosen kriteret dhe të bëhen aplikimet. Ju thoni mund të jetë avokati, por nuk do të jetë avokati. Gjithsesi, e lëmë në fund diskutimin e avokatit, sepse mund të jetë, por aplikimet mund t'i mbledhë edhe Oerdi, për shembull, nuk është shqetësim. Më pas ju thoni se procesin e përzgjedhjes së këtyre 10 vetave, që do të jenë, ta bëjnë monitoruesit kombëtarë. Ti thua se palët politike mund të kenë të drejtë për të përjashtuar.

Fatmir Xhafaj – Ta vendosim.

Eduard Halimi - Më pas kalojnë me konsensus me votat e të gjithëve. Nuk po themi me 2/3, apo me 3/5. Kështu shpëtojmë nga avokati dhe nga të gjitha me atë pjesë. Ky është propozimi i ri që kemi dhe do ta mendojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Për të qenë i sinqertë, cili është shqetësimi që kemi ne? Shqetësimi që kemi ne, e kemi pasur që në fillim dhe është konfirmuar edhe nga Venecia, është që këtë proces të

mos e kishte nën hyqëm Kryeministri. Është shqetësim totalisht legjitim, që do ta kishte edhe ju në qoftë se do të ishit në opozitë. Formula që propozoni ju e heq shqetësimin që ka pasur opozita për kapjen politike të Komisionit të Verifikimit të Kualifikimeve. Kështu që, ky mund të jetë vetingu si proces, si paketë ndryshimesh kushtetuese bashkë me ligjin, në mënyrë vertikale, bashkë me akte të tjera, për të cilat duhet të gjendet konsensus politik për emërimin e gjithë trupës, në këtë mënyrë, apo në ndonjë mënyrë tjetër, ne duhet ta mendojmë. Shqetësimi që kishim ne ishte të miratohej para verës, por kemi kohë edhe në pranverë për pjesën e vetingut.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, për mirëkuptimin!

Besoj se konsensusi midis meje dhe zotit Halimi është për t'u vlerësuar. Të dyja palët mbështetemi te Venecia dhe rezultati është pozitiv.

Mund të vazhdojmë me pikën tjetër.

(Mungesë inçizimi).

(Diskutime pa mikrofon).

Eduard Halimi – Kemi ILD-në.

Të nderuar kolegë, në gjithë paketën e ndryshimeve kemi këto dy komponentë: antikorrupsionin, për të cilin ne gjejmë dakordësi dhe kam besim se do të ecim shumë shpejt, që ka të bëjë me një proces të shpejtë dhe efikas.

Ngritja e institucioneve të përhershme, siç janë: ILD-ja, KLGJ-ja, TD-ja, TDI-ja, KPK-ja e të tjera, kërkojnë një vëmendje shumë të madhe. Në qoftë se procesi i vetingut është për 3vjet, apo 5 vjet, këto institucione do të jenë për dhjetëra vjet, kështu që duhet të kemi vëmendje më të madhe dhe t'i mendojmë, në mënyrë që të sigurojmë përgjegjshmëri për llogaridhënien e këtyre institucioneve. Nuk ka rëndësi, sot jeni ju, nesër do të jemi ne, apo do të jenë të tjerët pas nesh, rëndësi ka që këto institucione të jenë të përgjegjshme.

Ne e trajtuam herën e kaluar procesin e emërimit me KED-në, me pjesën që kishte të bënte me arkitekturën e sistemit. Unë nuk dua t'i kthehem atij diskutimi, sepse e kemi bërë dhe do ta bëjmë sërish, ndoshta, sipas zgjedhjeve që do të na vijjnë nga ekspertët për të gjetur raportin *check and balance* dhe luftën ndaj korporatizmit.

Tani jemi tek ILD-ja. Si do ta zgjidhim një problem të madh, ne që kemi pasur fatin e madh të ishim ministra Drejtësie? Si do ta zgjidhim, që pasardhësit tanë, ata që do

të bëhen ministra Drejtësie, të mos e kenë këtë problem? Jo personal, por çështjen që ka të bëjë me llogaridhënien e sistemit. Nuk ka lidhje me gjyqtarët e korrumpuar, se ata e kanë vendin në burg, sepse korrupsioni është vepër penale, por me shkelje disiplinore. Të gjithë ne kemi dështuar, nuk po e them “spektakolare”, sepse do ta ekzagjeroja, por kemi dështuar në procesin e inspektimit dhe masave disiplinore ndaj gjyqtarëve, që kanë të bëjnë me paaftësinë e tyre, zvarritjen e vendimeve, moszbardhjen e me radhë. Pse kemi dështuar, sipas analizës që bëj unë? Sepse Këshilli i Lartë i Drejtësisë, sistemi gjyqësor dhe Gjykata e Lartë kanë një frymë korporate të jashtëzakonshme dhe besoj se ne biem dakord, që gjyqësori dhe prokuroria funksionojnë bashkë si korporatë. Gjetja e këtij mekanizmi është jetik jo se do të ketë efekte nesër, sepse do të ndërtohet, do të bëhet inspektimi dhe efekti i kësaj norme do të jetë ndoshta pas dy vjetësh, ndërkohë që efekti i vetingut do të jetë pas 1, 2, apo 3 muajsh. Por është shumë e rëndësishme që të mos dështojë.

Ne kemi dështuar, sepse gjyqtarët mbrojnë njëri-tjetrin. Kemi futur një mekanizëm të ri që është propozuar. Nga ekspertët tanë të Partisë Demokratike jemi informuar që ky model është vetëm në Bullgari. Mund të ketë edhe ndonjë model tjetër, por ekspertët tanë na thonë se është vetëm në Bullgari. Domethënë, inspektorë të lartë të drejtësisë në këtë formë, si institucion me këtë mekanizëm, na kanë thënë ekzistojnë vetëm në Bullgari. Nuk është kiamet, mund të ekzistojnë.

Ku e kemi ne problemin te pjesa e inspektorit? Inspektori i Lartë i Drejtësisë, siç është thënë këtu, (nuk po i hyj zgjedhjes, e diskutojmë në fund) sipas paketës, kryen edhe inspektimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe shkon në KLGJ si prokuror, pra siç mbron sot ministri. Ndërkohë, po ky inspektor bën edhe inspektimin e kësaj trupe. Pra, inspekton edhe anëtarët e KLGJ-së, edhe gjyqtarët. Këtu ka një konflikt interesi, sepse inspekton edhe gjyqtarët, për të cilët ai vjen si prokuror para trupit gjykues dhe i shkon trupit gjykues duke i thënë: unë po të sjell gjyqtar Gentin për ta gjykuar, por unë mund të gjykoj edhe ty, sepse e kam kompetencë. Ky mekanizëm çalon për mua, ka konflikt interesi.

Po kështu, ky kryeinspektor inspekton edhe anëtarët e tribunalit disiplinor, që janë anëtarë të gjykatës. Unë jam inspektor dhe shkoj të inspektoj dosjen tënde, që është,

po them, Pandi, anëtar i tribunalit. Pra, unë e inspektoj Pandin, por Pandi ka të drejtë të më shkarkojë mua. Mua më krijon problem ky mekanizëm, është konflikt interesi.

Cila është zgjidhja që duhet të bëjë kryeinspektori? Kryeinspektori duhet të ketë frikë nga Pandi, sepse e shkarkon nga tribunali. Pandi mund t'i thotë se nuk e ka bërë mirë punën dhe e shkarkon. Çfarë do të thotë? Do ta kontrolloj unë atë? Nuk e kontrolloj, sepse kam frikë. Pra, kam konflikt interesi me të dhe ky mekanizëm është problematik në procesin e korporatizmit, sepse ata do të mbrojnë njëri-tjetrin. Tribunali do të mbrojë gjithë pjesën e gjyqtarëve, Këshilli i Lartë Gjyqësor, kemi 6 gjyqtarë, që sërish do të mbrojnë njëri-tjetrin karshi inspektorit.

Problemi tjetër ka të bëjë me llogaridhënien. Pra, dy gjëra kemi ne në gjithë pjesën e korpusit që ka të bëjë me emërimin, promovimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve: funksionimin si korporatë dhe llogaridhënien.

Inspektorin e emërojmë ne si ligjvënës, por e shkarkojnë gjyqtarët, pra tribunali disiplinor. Unë gjykoj se plaga e madhe që ka sistemi gjyqësor, përveç korporatizmit, është llogaridhënia. Ata nuk japin llogari përpara qytetarëve, siç japim ne, ata duhet të japin llogari ndaj pushtetit legjislativ. A jemi *check and balance*? Në qoftë se ne emërojmë një njeri, siç emërojmë Prokurorin e Përgjithshëm, apo anëtarët e Gjykatës së Lartë, që edhe atëherë duhet ta kishim zgjidhur, prandaj jemi në këtë pikë, ata duhet të japin llogari, sepse e kanë britanikët modelin si anëtar i Gjykatës së Lartë. Kur na e kanë thënë vetë këta, vërtet edhe ne brenda për brenda kur ishim në pushtet thamë jo, se kjo ishte e papranueshme për realitetin shqiptar, prandaj duhet të ketë një mekanizëm në llogaridhënie. Ne emërojmë inspektorin. Çfarë detyre ka ky inspektor? Ky inspektor, apo ky institucion ka për detyrë që t'i kontrollojë një më një të gjithë gjyqtarët për çështje që kanë të bëjnë me shkeljet administrative, sepse me çështjet e korrupsionit do të merren të tjerët, si: e vonove, nuk e vonove, efikasitet, i zvarrite, nuk i zvarrite. Por ne që emërojmë kemi përgjegjësi para qytetarëve edhe për këtë paketë, ne kemi përgjegjësi dhe ne do ta zgjidhim këtë problem. Nesër, në qoftë se dështon inspektori, dështojmë ne në zgjidhjen që kemi bërë dhe ky inspektor duhet të japë llogari, jo tek tribunali, duhet të japë te parlamenti, se po ta ketë tribunali, atëherë ne e emërojmë dhe ai thotë: "Ik se juve nuk ju jap llogari". Po dështoi ai, nuk e ka fajin askush dhe faji mbetet anonim dhe ne do të vazhdojmë me pingpongun, e ka fajin gjykata, e ka fajin prokuroria.

Problemi është nisur nga analiza, por sistemi ka probleme me korporatizmin dhe me llogaridhënien. Nuk po them asgjë të re, sepse e dimë të gjithë. Zgjidhja, sipas kësaj, neve na duket e pamundur, joefikase, joeficiente dhe me mungesë llogaridhënie. Ky ishte problemi që ne kemi lidhur me inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Nuk po përmend komponentin që e kemi ngritur si shqetësim nga muaji shtator, dhjetor dhe janar, që kishte të bënte me emërimin në mënyrë të njëanshme të inspektorit. Për çështjen e emërimit të inspektorit, Komisioni i Venecias ka dhënë një zgjidhje, i cili thotë: “Të mos zgjidhet me 3/5-at, por të jetë me dispozitë transitore”. Edhe aty mund të gjendet një zgjidhje. Problemin nuk e kam te çështja si do të jetë dhe si do ta zgjidhim, por te mënyra e funksionimit *check & balance*, si dhe çështjen e korporatizimit.

Do të desha që ekspertët, siç e kemi thënë, në tërësinë e gjithë komponentit, që ka të bëjë me këshillin e emërimeve, me tribunalin disiplinor, që analizuam herën e kaluar, me inspektorin e Lartë të Drejtësisë dhe konfliktin e interesit, pra, i gjithë procesi që ka të bëjë me institucionet e përhershme, që do të jenë për dhjetëra vjet, jo këto të përkohshmet, dhe ndoshta do t’i japin efektet vitin e ardhshëm apo pas 1 viti apo 2 vjetësh, këtë komponent duhet ta analizojnë dhe të na sjellin një ristrukturim të këtij mekanizmi, në mënyrë që të jetë eficient në luftën kundër korporatizmit brenda sistemit dhe të rrisë llogaridhënien, sepse nuk japin llogari fare. Ky proces duhet të zgjidhet për ne sot në opozitë, për ju nesër, e kështu me radhë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Ta kuptojmë më qartë. Konstatimet tuaja janë të qarta. Cili është propozimi? Keni ndonjë propozim konkret?

(Diskutime pa mikrofon.)

Eduard Halimi – Mekanizmi që është propozuar, pra, që e emëron parlamenti dhe ai nuk i jep llogari fare parlamentit, por e shkarkojnë ata gjyqtarë, që ai ka për detyrë t’i kontrollojë, është në konflikt interesi, sepse tribunalin disiplinor e ka për detyrë ta inspektojë inspektori.

Unë të inspektoj ty dhe pastaj ti më shkarkon mua. Si do të të inspektoj unë ty? Kështu është thënë. Kjo krijon problem.

Fatmir Xhafaj – Urdhëroni!

Pandeli Majko – Unë e kuptoj shqetësimin dhe ky shqetësim mbështetet edhe mbi një eksperiencë që nuk është vetëm shqiptare. Lidhur me faktin e pyetjes se a do të kemi korporatizëm në marrëdhëniet e një gjyqësori apo të një sistemi drejtësie, që do të fitojë shumë shkallë lirie, e konsideroj mjaft interesant si diskutim, por mendoj se institucioni që po diskutojmë e nxjerrë pak diskutimin jashtë kontekstit.

Dua të jap një shpjegim të përgjithshëm si e kuptoj unë korporatizmin. Korporatizmi në sistemin e drejtësisë nuk duhet lidhur vetëm me faktin se ne njerëzit e politikës nuk do të kontrollojmë dot sistemin e drejtësisë apo nga fakti se nuk do të kemi mekanizmat e duhur, për të marrë informacion të plotë apo se dikush, brenda këtij sistemi, nuk do të na japë ne në mënyrë periodike informacion. Ta ndajmë pak mënyrën e trajtimit të korporatizmit. Për korporatizmin si fenomen, i cili organizon vendimet në kundërshtim me ligjin dhe rregullin brenda një sistemi të caktuar dhe faktin e shqetësimit se sa mund të krijohet një korporatë në sistem, duke pasur parasysh se republika parlamentare apo parlamenti, si institucioni kryesor, nuk do të ketë mekanizmat e marrjes së informacionit, të llogaridhënies e kështu me radhë, unë mendoj se parlamenti duke emëruar inspektorin e Lartë të Drejtësisë, i cili është përgjegjës për verifikim, po e përsëris, përgjegjës për verifikimin e ankesave ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për hetimin e shkeljeve dhe fillimin e procedurës disiplinore të tyre, ndërkaq, është përgjegjës edhe për inspektimin e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë, ka bërë një ndërhyrje, po e quaj kështu, ndërhyrje e mjaftueshme e parlamentit, pra edhe e vendimmarrjes së politikës me atë shumicë të cilësuar, që do ta diskutojmë më pas, për të vendosur një lloj balance të brendshme në sistemin e drejtësisë në funksion të moskrijimit me një moment tjetër të një korporate.

Bazuar mbi faktin se ne e zgjedhim, dhe ai duhet të japë te ne llogari, mendoj se do të vihemi përpara një situatë ku institucioni, që do të jetë përfaqësuesi i verifikimit të ankesave, do të japë llogari te ne. Atëherë, ne kemi futur duart këtu. Ne realisht kemi futur duart. Që të vijë institucioni...

Ju lutem, në qoftë se ne sot diskutojmë se në sistemin e drejtësisë ka korporatizëm, korporatizmin e kemi bërë ne. Ne i kemi zgjedhur anëtarët e Gjykatës së Lartë, ne kemi zgjedhur anëtarët e KLD-së, ne kemi zgjedhur anëtarët e Gjykatës

Kushtetuese. Ne kemi sponsorizuar, po e quaj kështu, për arsye të njohjeve, të interesave, quajeni edhe politike po të doni, emërimin e filan gjykatësi apo të filan prokurori dhe kjo ka krijuar këtë sistem që ekziston sot. Duke e lënë inspektorin e Lartë të Drejtësisë vetëm si emërim, pra, zgjedhje të parlamentit, të mos harrojmë që do të vijë nga një rankimim i caktuar, mendoj se ne do të shkojmë deri te kufiri i garancisë, por jo te kontrolli. Ne duhet të ndajmë se jemi të interesuar për garancitë e pavarësisë së sistemit të drejtësisë dhe jo për kontrollin.

Në qoftë se ne do të mendojmë se ky inspektor ose ky institucion që është verifikuesi i ankesave ndaj gjyqtarëve, përfaqësues i kontrollit për shkeljet në të gjitha zyrat e gjykatës dhe të prokurorisë në Republikën e Shqipërisë do të vijë të na japë kontroll neve, ai kthehet menjëherë në mekanizëm të politikës.

Do të thoni ju si do të kthehet në mekanizëm? Kthehet. Në momentin që e kupton, që raporton tek ty, ti e emëron, ti e shkarkon, fillon dhe kthehet. Është autosugestion.

Megjithatë ne duhet ta pranojmë, se edhe pse njeriu ka miliona vjet që është shkëputur nga majmuni, ndonjëherë bën edhe si majmun. Duhet të kuptojmë që me këtë kulturë juridike edhe në marrëdhënie me politikën, që ekziston, ky inspektor do të jetë nën këtë presion. Në momentin që edhe togat e zeza do ta kuptojnë që marrëdhënia e tyre me inspektorin e Lartë të Drejtësisë do të jetë një marrëdhënie e performuar mbi bazën e standardeve dhe etikës së brendshme të sistemit dhe jo mbi bazën e informacioneve, ky inspektor do të ketë me parlamentin, një marrëdhënie krejtësisht të ndryshme midis sistemit të drejtësisë dhe politikës.

Unë mendoj se kështu siç e kanë zgjedhur të funksionojë inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe ekspertiza ndërkombëtare është mjaft e balancuar.

Fatmir Xhafaj – Urdhëroni!

Eduard Halimi – Pandi, me shumë sinqeritet po të them, sot inspektori do të ketë mbledhjen e ankesave dhe çuarjen para KLGJ-së. Domethënë, verifikimin. Bëra ankesë si qytetar, bëra inspektimin e dosjes dhe shkova te KLD-ja. Këtë rol që do të bëjë nesër inspektori, thotë e bën ministri. Domethënë, ne sot kemi ministrin. E bënte këshilli, por sot e ka ministri. Pra, ministri sot ka të drejtë ekskluzive madje që t'i çojë gjyqtarët në KLD.

Pra, sot e ka ministri dhe nëse ka ndërhyrje më të madhe e ka qeveria. Ndërhyrja që kemi ne sot është më e madhe se ajo që do të bëjmë nesër.

Kemi një figurë që është më e ashpër dhe që ka dështuar, Pandi. Nuk po them që do të krijohet korporata. Kur them korporatizëm, nuk e kam që ata mbrohen nga pushteti politik. Nuk e kam aty. Korporatizëm, për mua, është që ata mbrojnë njëri-tjetrin. Pra, fillohet çështja dhe ata mbulojnë njëri-tjetrin, siç ka ndodhur gjithmonë. Zgjedhin në krye të tyre njerëzit më problematikë në mënyrë që t'i kenë si çadër. Si çadër jo ndaj politikës. Kjo korporatë jo se do të krijohet, ajo është krijuar, ekziston. Kemi faj të gjithë. Dakord.

Pra, ne kemi një mekanizëm sot që është më i fortë, pra, kemi figurën e ministrit, Madje, nuk kemi një, kemi edhe dy inspektorate. Nuk kemi një kamxhik, por dy kamxhikë. Në vend që të ecim dhe ta zgjidhim këtë problem, sepse e kemi problem, ne e zbusim. Ne tani kemi krijuar inspektorin dhe inspektori është më i butë se ministri. Po jua them shumë sinqerisht! Problemi politik është që shiko se po e merr inspektorin iksi apo ipsiloni. Problemin tjetër e kam shumë të sinqertë. Bëhet më keq. Nuk do të ketë eficiencë, Pandi. E kam shumë sinqerisht!

Fatmir Xhafaj - Zoti Strazimiri, urdhëroni!

Gent Strazimiri – Shqetësimi që u ngrit nga të dy kolegët është i drejtë. Për të gjetur zgjidhjen ne duhet t'i vëmë diagnozën sistemit. Problemi që kemi ne sot është se pse sistemi është shumë i kontrolluar dhe nuk duhet ta kontrollojmë ne apo pse është një sistem jashtë kontrollit?

Ky është një sistem jashtë kontrollit. Ky është një sistem që gjithmonë ia bën hyzmetin pushtetit, sepse prej tij mund t'i vijë e keqja. Në këtë marrëdhënie preferenciale që krijon me pushtetin, krijohet edhe hapësira që të bëjë disa punë për vete. Duhet të gjejmë një mekanizëm që sistemi të japë llogari publikisht përpara parlamentit dhe parlamenti është sovrani, vota e popullit.

Ne një hap e kemi bërë në këtë drejtim. Nga momenti që ne votojmë gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, apo gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, secili prej nesh bën një votim nominal. Thirret emri dhe thua po ose jo dhe kjo është bërë me një qëllim transparent, që secili prej nesh nesër ose të krenohet, ose të skuqet përpara popullit me kandidaturën që ka votuar.

Kandidaturat që ne japim për Gjykatën e Lartë apo për Gjykatën Kushtetuese apo për mekanizma të tjera të sistemit nuk janë llogaridhënës, duke e vendosur përsëri përpara parlamentit atë që do të duhet t'i kontrollojë. Secili prej nesh duhet të marrë një qëndrim, të skuqet apo të zverdhet në rast se kandidatura nuk ka dhënë rezultate në punë. Këtu jam dakord me zotin Halimi që duhet të gjejmë një mekanizëm të balancuar.

Unë kam një bindje për këtë. Është e vërtetë kur ju, zoti Xhafaj thoni: A keni ndonjë propozim konkret? Unë nuk kam për momentin, por e di se çfarë nuk duhet të bëjmë. Nuk duhet të fshihemi dhe t'i marrim të mirëqena deformimet që vetë ne i kemi krijuar në 25 vjet. Nëse ne sot i shikojmë me të vërtetë me sy dhe me sinqeritet deformimet që kemi bërë në këta 25 vjet, nuk do të biem më në ato gabime.

Zoti Xhafaj, tha se është hera e parë që bëhet *vetingu*. Jo, nuk është. Është bërë në vitin '98. Kolegët që kanë qenë drejtues të Ministrisë së Drejtësisë në një mënyrë ose tjetrën e dinë që deformimet i ka sjellë politika dhe i ka sjellë, sepse nuk është nisur të bëjë një sistem funksional. Prandaj ne sot ndodhemi në këtë gjendje. Në qoftë se do të vazhdojmë përsëri të bëjmë rrethin vicioz, siç e kemi bërë në këta 25 vjet, asgjë nuk do të bëjmë.

A mund të na japë formula të gatshme Komisioni i Venecias dhe të themi se kështu ka thënë Komisioni i Venecias? Venecia nuk e di se si i kemi sajuar institucionet, se si janë zgjedhur individët. Ata janë zgjedhur në bazë të marrëveshjeve politike. Këtë nuk mund ta dijë Komisioni i Venecias dhe nuk mund t'i kërkojë asaj të japë një zgjidhje për këtë punë.

Venecia, supozon faktin që Avokati i Popullit ka marrë votën e gjithë parlamentit. Ndërkohë, sapo e tha zoti Bylykbashi, është zgjedhur në bazë të një konkursi brenda Partisë Socialiste me pjesëmarrjen e Kryeministrit aktual.

Unë personalisht Avokatin e Popullit... Një sekondë, nuk po kaloj tek ajo, po të ilustroj këtë që të thashë! Më fal, mos e merr për sulm!

E di, tek ajo ura jemi. Atë urë po përpiqesh të fshehësh ti dhe pastaj dalim e bëjmë çudira.

Ky është problemi. Avokatin aktual të Popullit, këtë të pavarurin, që ta sugjeron Komisioni i Venecias, unë e kam pasur në debat politik përballë në televizion; është i

dërguari i Partisë Socialiste. Ka gjithë respektin tim! Tani këtë ne nuk do të rrimë t'ia sqarojmë Komisionit të Venecias, por ne e dimë.

Hajde të krijojmë një mekanizëm transparence dhe kontrolli, jo kulisash kontrolli në mënyrë që secili prej nesh këtu, që sot po bëjmë të mençurin, nesër, pasnesër të kemi edhe inspektorin përballë, pra ne që kemi votuar për të ose kundër tij, ta vuajmë nesër me votën e popullit. Ne përfaqësojmë sovranitetin e popullit. Hajde ta çojmë deri në fund përfaqësimin. Duke u nisur nga këto premisa, ne arrijmë në mekanizmin e duhur dhe jo të shpikim të pavarur, që nuk ekzistojnë.

Zoti Xhafaj, ne kemi biseduar edhe kur diskutohej çështja e imunitetit të deputetëve, unë nuk besoj në një sistem të pavarur nga politika. E vetmja gjë që do të mund të funksiononte është sistemi *cheks and balances*, pra të dyja krahët e politikës të jenë të barazlanguara, jo të bëjmë sikur nuk kemi punë fare. Le të krijojmë një mekanizëm ekuilibri, që të jemi të dyja palët të baraslanguara. Nëse rreziku i pavarësisë së sistemit janë krahët e politikës, gjëja më e mirë që mund të bëhet është të vendoset në mënyrë të balancuar njëri krah kundër tjetrit, pra të merren me njëri-tjetrin dhe ta lënë rehat sistemin, por jo duke vendosur influencën e njërit. Nuk do të ketë as kontroll, as pavarësi dhe, sigurisht, as mungesë korrupsioni. Kjo do të sjellë korporatizëm, sepse do të detyrohen të mblidhen bashkë me njëri-tjetrin dhe të konjukturohen në bazë të interesave të pushtetit apo të politikës, për një moment të caktuar. E njëjta gjë do të jetë përsëri. Është e kot që t'i futemi gjithë kësaj historie, në qoftë se do të vazhdojmë të rrahim ujë në hava.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Bylykbashi.

Oerd Bylykbashi – Po ndiqja debatin në lidhje me çështjen e korporatizmit.

Unë nuk besoj se është ekzaktësisht problemi që ngriti zoti Majko. Problemi sot është që në një seri të këtyre institucioneve, ne po ndërtojmë elemente që mund të na çojnë përsëri, madje ta theksojnë korporatizmin. Këtu duhet të jemi shumë të kujdesshëm: sa më i thjeshtë të jetë sistemi aq më të qartë do ta kemi këndvështrimin tonë në lidhje me atë që po bëjmë për të shmangur në të ardhmen korporatizmin. Nuk duhet që pas 10 apo 15 vjetëve të ulemi përsëri (ndoshta unë atëherë me flokë të zbardhura) për këtë histori.

Pra, ne duhet të evitojmë me çdo kusht detantën e korrupsionit brenda sistemit, por me mënyrën se si po propozohet Inspektori i Lartë i Drejtësisë, kam frikë se po shkojmë diku tjetër; po krijojmë një fill që transmeton interesin dhe presionin e qeverisë. Kështu siç është propozuar, ne mund të shkojmë drejt asaj që unë nuk do ta quaja korporatizëm, por kooperativizëm drejtësi-qeveri. Pra, në këtë mënyrë do të bihet dakord që gjyqtarët dhe qeveritarët të mos dënojnë njëri-tjetrin; njëri nuk i nis problematikat, tjetri nuk dënon dhe kthehemi përsëri këtu ku jemi.

Kështu që duhet ta rishohim pak këtë çështje, por duke iu rikthyer problemit, që jo vetëm unë, por të gjithë ne, e ngritëm në Komisionin e Venecias, që ka të bëjë me kompleksitetin e sistemit. Nga kjo çështje unë nuk heq dorë.

Në mënyrë absolute, ne nuk duhet të jemi peng i një zgjidhjeje, por të kemi mendjen të hapur dhe të shohim nëse është e domosdoshme. Nëse po, të shohim cili është versioni më i mirë, por nëse do të kemi zgjidhje tjetër, pse jo? Le t'i heqim maskat e Venecias dhe t'i themi gjërat siç janë. Nëse kjo është ndërtuar diku, me një qëllim të caktuar dhe ky qëllim po bie dalëngadalë, le të shohim zgjidhje tjetër. Nëse ne mund të thjeshtojmë sistemin dhe të njëjtat kompetenca t'i kryejë një pjesë tjetër e sistemit, që e kryhen me integritet dhe me besueshmëri detyrën që ka inspektorati, pse jo, pra ta shohim gjënë. Shumë gondola në një kanal ngatërrohen me njëra-tjetrën. Pra, ta shohim pak me kujdes.

Unë besoj se ekspertët e kanë të gjithë hapësirën, mundësinë dhe kompetencën për të gjetur ndoshta edhe një zgjidhje tjetër, por nëse kjo do të jetë e vetmja zgjidhje, atëherë kjo nuk do të na çojë tek ajo që unë thashë: jo vetëm që nuk do të luftojmë korporatizmin, por, aq më keq, do të transmetojmë influencën dhe presionin e qeverisë.

ILD-ja, e cila inspektohet nga një ministër drejtësie, nuk është gjë tjetër veçse çelësi që hap derën e blinduar të drejtësisë, ose çdo element tjetër i ngjashëm me të.

Fatmir Xhafaj – Kjo është hequr.

Oerd Bylykbashi – Dakord.

Në qoftë se ILD-ja, në një mënyrë apo një tjetër, do të jetë instrumenti (sepse veprimi i parë tregoi qëllimin), pra në qoftë se një çelës zëvendësohet me një tjetër për të arritur të njëjtin qëllim, nuk është bërë asgjë. Kemi dështuar në qëllimin që kemi.

Po e mbyll këtu, por për ekspertët kam gjithmonë këtë: të shohim a kemi ndonjë hapësirë për ta bërë sistemin edhe më të thjeshtë dhe po aq funksional.

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Majko.

Pandeli Majko – Unë i kuptoj të dy kolegët që më komentuan.

Unë përsëri do të tërheq vëmendjen e tyre për t'i qëndruar variantit, pa u futur në stigmatizime ironike, për të bërë paralele me maskat e Venecias.

Së pari, Inspektorin e Lartë të Drejtësisë nuk duhet ta vendosim në sistemin aktual. Nëse e marrim si një institucion të shkëputur dhe e vendosim në institucionin aktual, unë do të bashkohesha me ju, me mënyrën tuaj të logjikës, por kur diskutojmë Inspektorin e Lartë të Drejtësisë duhet ta mendojmë sistemin si një të tërë.

Vini re në pikën 5, ku thuhet: “Inspektorati i Lartë i Drejtësisë nuk mund të vendosë mosfillimin ose pushimin e një hetimi, kur ai kërkohet nga ministri i Drejtësisë, përveç rasteve kur kërkesa është haptasi e pabazuar”. Pra, po ta vini re Inspektori i Lartë i Drejtësisë brenda sistemit të drejtësisë bën prokurorin, por në marrëdhënie me të tretët, pra në marrëdhëniet e atyre që kërkojnë të insvetohen karshi sistemit të drejtësisë, bënë edhe avokatin, pra kur një ministër drejtësie bën haptazi një kërkesë të paligjshme. Kërkesa haptasi e pabazuar është gjurmë kushtetuese, por në termat e jetës reale do të thotë se qeveria bën presion mbi sistemin dhe është ky inspektor që do t'i dalë përballë dhe do të thotë: “jo”. Tani, ky që do t'i thotë “jo” (në kushtet e konfliktit, sepse nuk duhet të mendojmë vetëm korporatën, por duhet të mendojmë edhe influencën apo krizën e marrëdhënies midis ekzekutivit dhe drejtësisë, sepse po diskutojmë për personin që do të ketë guximin dhe të drejtën kushtetuese për t'i thënë: “jo” ekzekutivit) ekzekutivit, nuk mund të vijë të japë llogari në parlament nesër dhe nuk mund të shkarkohet nga parlamenti apo nga shumica që ka krijuar ekzekutivin. Merreni kështu në formulë, pra siç unë mirëkuptoj rrezikun e një korporate të 5, 6 apo 15 togave të zeza dhe prokurorëve, që mund të na krijojnë një korporatë bashkë me inspektorin, merrni (sepse duke qenë opozitë, besoj e keni këtë ndjeshmëri) edhe shembullin kur ekzekutivi do të fillojë t'i bëjë presion sistemit të drejtësisë. Është ky person, që do t'i thotë ministrit të Drejtësisë: “Kërkesa jote zotëri është e pabazuar”.

Prandaj, ne duhet t'i shohim të dyja anët e balancimit ose të asaj që quhet *checks and balances* në gjuhën e bukur angleze, por që ka kuptim edhe në gjuhën e bukur

shqipe, sidomos kur kemi parasysh precedentët e krizave, që ne kemi pasur në marrëdhëniet midis politikës dhe sistemit të drejtësisë.

Unë nxis ekspertët ndërkombëtarë dhe vendas, që neni për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë të ngelet kështu siç është, sepse është një tullë shumë e rëndësishme e pavarësisë së sistemit të drejtësisë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Halimi.

Eduard Halimi – Problemi që ne kemi te pjesa e inspektorit ka të bëjë me dy çështje.

E para, a duhet të ekzistojë apo jo ky mekanizëm.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo. Unë po ngre pikëpyetjen nëse ky mekanizëm, pa e lidhur me emrin, me zgjedhjen, me faktin e kap njëri, nuk e kap tjetri, sepse kjo është tjetër çështje, pra ka dy elemente: elementi i parë ka të bëjë me faktin nëse duhet të ekzistojë ky mekanizëm. A është eficient ky institucion kështu siç është ndërtuar, pra ky model, me një inspektor, i cili ka kompetenca dhe mundësi, a është armë më e zbutur se kjo që kemi sot? Kemi dy inspektorate për të mundësuar largimin e gjyqtarëve, ministri që është ekzekutivi, mekanizmi i procedimit disiplinor edhe të atyre që kanë problematika për çështje disiplinore. Pra, a duhet të ekzistojë ky institucion? A është efikas? Unë them se nuk është. Ky mekanizëm nuk është efikas për dy arsye.

E para, sepse e bën më keq procesin e disiplinimit dhe e çon në favor të korporatizmit.

E dyta, nuk është efikas, sepse mungon parimi *checks and balances*. Ky mekanizëm, për mua, e bën më keq se sot gjendjen e sistemit gjyqësor.

Unë besoj se konsultimet me ekspertët tanë nuk kanë filluar; kur të fillojnë nesër pas mbarimit, siç është rënë dakord, që konsultimet do të fillojnë pas përfundimit të ditës së sotme, t'i diskutojnë me ekspertët tanë dhe të gjejnë një mekanizëm. Ka mekanizma të tjerë. Ky mekanizëm është vetëm në Bullgari, zoti Majko.

Ka mekanizma të tjerë, që duhet të jenë eficientë për ta luftuar këtë plagë, këtë dështim që ne kemi. Është modeli francez, ai gjerman. Këto modele duhet të eksplorohen, të diskutohen në ditët në vijim edhe me ekspertët tanë, të cilët kanë disa modele për këtë

mekanizëm, për pjesën nëse duhet të ekzistojë si institucion, sepse po heqim dy inspektorate. Fakti që ai refuzon kërkesën e ministrit, nuk është asgjë fare, zoti Majko. Nuk është ky shqetësimi. Këto janë institucione, nuk janë shqetësime të opozitës, sepse nuk janë institucione, që do t'i japin efektet nesër. Këto do të jenë për dhjetëra vjet, siç janë Inspektorati i Ministrisë dhe i KLD-së, që kanë nga 15 vjet që janë ngritur. Ndoshta pas 15 vjetësh do të ulen njerëzit dhe do të diskutojnë përsëri për këtë çështje. Prandaj, duhet të jenë të qëndrueshme.

Çështja tjetër është nëse patjetër duhet të ekzistojë dhe ekspertët tanë, tuaj, të EURALIUS dështojnë të gjejnë një zgjidhje më të mirë, në qoftë se do të ekzistojë, atëherë kalojmë te pjesa tjetër; do të ekzistojë, do të jetë mirë? Si do ta zgjidhim këtë? Kjo pastaj është tjetër çështje: do ta zgjedhim kështu apo ashtu; do ta zgjedhim, siç thotë Komisioni i Venecias, me 3/5-at, me 2/3-at, me dispozitë transitorë apo do të gjejmë një model tjetër, ku të kemi tre inspektorë, një institucion kolegjal, që t'u përshtatet formulave të tjera? Kjo është çështje që do ta diskutojmë mbledhjen tjetër, kur ta çmoni ju të nevojshme, sepse do të kemi mbledhje tjetër, pasi ekspertët të na sjellin produktin, apo jo? Pra, do të kemi mbledhjen tjetër në tërësi me këto. Në qoftë se nuk kemi, të shtojmë gjetjen e një mekanizmi, por unë problemin e kam që ky mekanizëm nuk e bën më mirë, por e bën më keq, jo në favor të kapjes, por në favor të korporatizmit, në këtë rast.

Fatmir Xhafaj – Dakord. I mbyllim diskutimet për këtë çështje.

Në përfundim, kam edhe unë të drejtën të them 2-3 mendime.

Është e vërtetë që sistemi i inspektimit që kemi sot është defektoz, sepse nuk ndan mirë rolin e ekzekutivit nga roli vetërregullues i sistemit. Pra, ne sot kemi një sistem që kërkojmë ta rregullojmë nga jashtë dhe jo një sistem që vetërregullohet, që të jetë në princip të funksionimit të pushtetit. Një nga parimet e rëndësishme demokratike të funksionimit të pushtetit të gjyqësorit është aftësia për t'u vetërregulluar. Pikërisht kjo aftësi i mungon sistemit që kemi sot.

Zgjidhja që propozohet i shërben pikërisht frymës së korporatizmit, dhe mbështes këtu edhe zotin Majko, sepse inspektimi nuk është atribut i brendshëm i organit vendimmarrës, siç është sot ai i KLD-së.

Nga ana tjetër, nuk i shërben kapjes, siç është në rastin e eskkluzivitetit që ka ministri në funksionet inspektuese.

Atëherë, unë jam shumë dakord që nëse ka gjëra të ky sistem që duhen parë në lidhje me konfliktin e interesit, le t'i shohim. Nuk ka arsye pse të mos i shohim. Është një pikë që besoj se ndajmë pikëpamjen që si të jetë më mirë, të paktën, deri në këtë pjesë të analizës. Nëse ka diçka që duhet të lidhet me llogaridhënien, le ta shohim si mund të bëhet, me qëllim që të jetë më llogaridhënës. Edhe mua më shqetëson ideja që është 9 vjet, por si mund ta bëjmë që ta lidhim qëndrimin e tij në detyrë me aftësinë për të qenë më i përgjegjshëm? Ekspertët që e kanë propozuar mund të kenë argumentet e tyre, por mendoj se duhet të shohim dy aspekte të rëndësishme dhe këtu, për hir të së vërtetës, na ndihmon opinioni i Komisionit të Venecias.

Së pari, në faktin që opinioni i Komisionit të Venecias ka orientuar për të parë më mirë rolin e ministrit të Drejtësisë në këtë proces. Bim dakord që ai nuk duhet të inkludohet tek tribunali, e ka thënë Komisioni i Venecias. Gjithashtu, kjo edhe tek inspektimi i vetë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, por, nga ana tjetër, i ka lënë mundësinë të gjendet një zgjidhje që të ketë mundësi të mos jetë ekskluzive çështja e inspektimit. Pra, e përqendruar te një njeri. E ka lënë hapësirën që ministri të ketë një rol më aktiv.

(Zoti Halimi flet pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj - Komisioni i Venecias që përdor ndikimin e ekzekutivit...*(nuk kuptohet)* ...duhet të përqendrohet në duart e një tjetër çështjeje, nëse ministri mban një kompetencë në lidhje me prokurorët. Kjo duhet të qartësohet me prokurorët dhe me gjyqtarët. Unë them si mund të gjejmë zgjidhje që inspektimi të mos jetë dominimi i një njeriu. Si mund ta bëjmë këtë gjë? Kjo pastaj mund të ketë çështje që të ketë interferenca, që ai për një arsye apo për një tjetër, për efekt të korporatizimit apo për efekte të papërgjegjshmërisë të ketë mundësi që të jetë i balancuar në këtë gjë. Kjo është një çështje që mund të shihet. Ashtu siç e ka parashikuar si alternativë edhe Komisioni i Venecias ku e ka thënë variantin në *empechement*. E ka parashikuar, nuk është se nuk e ka bërë. I ka ndërhyrë edhe kësaj çështjeje.

Prandaj ajo që dua të sugjeroj është se si mund ta bëjmë më llogaridhënës. Të japë llogari në sensin që të informojë. Ka nevojë që pushteti gjyqësor vetë të informohet, KLGJ-ja të ketë debate për këtë çështje herë pas here, pa i ndërhyrë atij në funksionin e

tij. KLP-ja të ketë debat lidhur me çështjet e inspektimit dhe problematikat që dalin nga inspektimi. Parlamenti vetë, sepse e ka zgjedhur, ka nevojë, gjithashtu, të informohet. Pra, që të mund ta bëjmë të jetë më llogaridhënës, më të përgjegjshëm, për këtë unë jam dakord. Le të shikohet se cilat janë hapësirat që e lejojnë duke respektuar me shumë të drejtë atë që ka thënë Komisioni i Venecias, ku ekzekutivi të mbahet në një distancë të caktuar nga vendimmarrja për përgjegjësitë disiplinore të gjyqtarëve. Këtë gjë duhet ta ruajmë fort. Pra, ekzekutivi, maxhoranca, parlamenti të jenë të kujdesshëm për t'u mbajtur të distancuar. Pra, nuk duhet të përfshihet politika në procesin e disiplinimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, por të kemi mundësi që të vendosim një ekuilibër ndërmjet përgjegjshmërisë së tij dhe llogaridhënies. Këtu jam dakord. Nëse ka hapësirë, të shihet se çfarë mund të bëhet.

A biem dakord?

Eduard Halimi – Ekspertët të na e sjellin, se këtë shqetësim kam dhe unë. Pra, për çështjen disiplinore duhet të jetë më i ashpër dhe për pjesën *check and balance*, nuk po them vetëm pjesën e inspektorit, se nuk është puna vetëm te inspektori. Inspektorët e marrin, do ta çosh dosjen aty, siç e çon ministri. Çfarë do të bëhet më mbrapa? Si do ta zgjidhim ne problemin e llogaridhënies të atyre të tjerëve që ta shqyrtojnë, KLGJ-së, tribunalit disiplinor, personave që do të merren me vendimmarrjen, se ky është problemi? Korporata aty është, nuk është te inspektori. Si do ta zgjidhim? Dhe këto mekanizma që thashë, nuk i kthehem, sepse i trajtova tek arkitektura, ky mekanizëm krijon problem, ndaj ekspertët bashkë me ekspertët tanë të shohin modele të tjera.

Fatmir Xhafaj – Ka 3 pika të rëndësishme që i ka Komisioni i Venecias. Unë besoj se do të jenë në vëmendjen edhe të dy ekspertëve të nderuar, edhe të ekipit të tyre të cilët kanë bërë një propozim në arkitekturë me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë që është shumë interesant. Zoti Halimi tha se ishte konkludim për ju.

Gent Strazimiri – Konkludim është. Unë e kam vetëm për të mbështetur analizën që ju bëtë, zoti kryetar. Në çfarë kuptimi e them? Mund edhe të habiteni. Ju thatë që po përpiqemi në një farë mënyre që të ketë një kontroll nga jashtë dhe që kjo nuk mund të jetë e ekzekutivit. Unë jam dakord me gjënë. Në qoftë se duhet të ketë një kontroll, qoftë dhe simbolik, apo aq substancial sa ne do të vendosim që duhet ta ketë në statistika, jo në punën e përditshme të tij, siç e kemi sot me një pjesë të institucioneve, unë besoj se

instanca, institucioni me më pak mundësi për të ndërhyrë në mënyrë klienteliste te ky lloj kontrolli është parlamenti, jo qeveria, jo ministri. Dhe besoj se nëse e lëmë te parlamenti, pastaj mekanizmin se si e vendosim me një nënkomision, apo ia vendosim një instance kontrolli të balancuar të parlamentit nën efektin e transparencës, besoj se jemi në rrugën e duhur. Formulatat brenda kësaj kornize gjenden pastaj.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

E mbyllim dhe këtë çështje.

Kalojmë te pika tjetër që ngriti zoti Halimi, ndërprerja e mandateve.

Eduard Halimi – Lidhur me ndërprerjen e mandateve kushtetuese, në fakt ka qenë një diskutim dhe një shqetësim i ngritur prej kohësh që në momentet e para, ndërprerja e mandateve kushtetuese të organeve, apo të institucioneve kushtetuese pa shkak, por vetëm si argument *de jure* miratimi i një amendamenti kushtetues. Ne jemi dhe ngelemi me qëndrimin që mandatet kushtetuese të respektohen të gjitha. Nëse nga proceset e *vetingut* apo dhe për ndonjë shkak tjetër personal që lidhet njerëz zyrtarë, apo me një tjetër për të cilin ka shkelje ligjore, sigurisht do të jenë në cilësitë e tij, ky mandat ndërpritet. Në të gjithë historinë që ne kemi pasur dhe në marrëdhënie politike mes palëve, ne kemi respektuar gjithmonë mandatet kushtetuese. Për 8 vjet në maxhorancë ne nuk ndërpreme as edhe një mandat të vetëm kushtetues të ndonjë zyrtari. Dhe rastet që kishin të bënin me shkarkimet e prokurorëve të përgjithshëm në vite ishin sepse prokurorët e përgjithshëm nuk kishin mandat, prandaj u bënë dhe ndryshimet në 2008-n kur u përcaktua se prokurori duhet të kishte mandat, në mënyrë që të mos prekeshin, të ruheshin mandatet kushtetuese deri ditën e fundit. Dhe që atëherë sigurisht nuk pati më ndërprerje të mandateve të prokurorëve të përgjithshëm. Por ama nuk ndërpreme mandatin e asnjë zyrtari edhe pse ata ishin të njërit krah politik. Ishin ish-ministra të një force politike, të opozitës në atë kohë, të cilët ishin kryetarë, nënkryetarë të KLD-së, anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, anëtarë të Gjykatës së Lartë, anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, kryeinspektori i Deklarimit të Pasurive e me radhë.

Pra, respektojmë një më një parimin i cili duhet të mbizotërojë në një republikë ku palët respektojnë njëra-tjetrën. Për këtë arsye ne mendojmë që asnjë mandat kushtetues nuk duhet të ndërpritet pa shkak. Pra, nuk duhet të ndërpritet mandatet

kushtetuese pa shkak. Mandatet kushtetuese ndërpriten vetëm për një shkak ligjor që lidhet drejtpërdrejt me mbarimin e mandatit të çdo zyrtari, sepse në rast se ne vendosim një standard tjetër, ju kujtohet, dhe ne kemi tentuar ta bëjmë një gjë të tillë. Pra, kemi kërkuar të ndërpriten mandatet kushtetuese të gjyqtarëve me ligjin e lustracionit. Dhe kjo kishte të bënte me cilësitë personale, se ata kishin dhënë vendime kundër njerëzimit në kohën e diktaturës. E kemi kërkuar atëherë, e kemi bërë ligj. Ju si opozitë me të drejtën tuaj e kundërshtuat, e çuat në Gjykatën Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese atëherë me të drejtë iu drejtua Komisionit të Venecias dhe Komisioni i Venecias në atë kohë u shpreh që sigurisht tani kur jemi në pushtet nuk na vjen mirë, por duhet të jemi të qartë, të vjen ose jo mirë, arbitri është ai që është, ka vendosur që mandatet kushtetuese nuk ndërpriten, nuk i ndërpreme. Si ajo çështja atëherë që ka qenë me ligjin e lustracionit. Për këtë arsye ne gjykojmë që mandatet kushtetuese të të gjithë funksionarëve të cilët sot kanë një mandat nuk ndërpriten pa shkak kushtetues.

Fatmir Xhafaj – Unë kam një pyetje. Me sa kuptoj unë, se këtu flitet për dy mandate që ndërpriten, ku një është për KLD-në aktuale, që riformatohet i ri, me një koncept krejt të ri dhe që Komisioni i Venecias e ka mbështetur fort, dhe një tjetër është mandati i prokurorit të Përgjithshëm për të cilin Venecia është shprehur jo në mbështetje të parashikimit të ndërprerjes së tij. Pra, edhe në këtë rast kemi dy qëndrime. Ju e keni fjalën për të dyja qëndrimet, apo e keni dhe ndonjë qëndrim të tretë që nuk e dimë?

Eduard Halimi – Ne nuk kemi qëndrim të tretë, por janë këto dy institucione. Në opinionin final, në qoftë se ka ndonjë faqe, ndonjë detaj për këtë gjë, unë nuk e kam lexuar. Në opinionin final për anëtarët e KLD-së, me sa di unë, Komisioni i Venecias nuk është shprehur, por ky është një qëndrim parimor. Pra, për këta zyrtarë Partia Demokratike, edhe kur ka qenë në pushtet, edhe sot që është në opozitë, i qëndron një parimi themelor që mandatet kushtetuese nuk ndërpriten. Nëse do të vepronim ndryshe, ne gjykojmë që do të ktheheshin në të njëjtën histori: thur sot e çthur nesër! Pra, atë që bëtë ju, kur sa erdhët shkarkuat anëtarët e KLD-së, atë gjë do të bëjmë edhe ne pastaj nesër kur të vijmë në pushtet dhe vijmë prapë në këtë çështje.

Prandaj lidhur me mandatet kushtetuese ne jemi që këto mandate të respektohen, të mos ndërpriten pa shkak. Në qoftë se ndonjë zyrtari i del procesi i *vetingut*, se ka dhe anëtarë të Gjykatës së Lartë që janë aty dhe që kanë mandat, edhe

atyre u ndërpritet mandati. Në qoftë se nuk kalojnë *vetingun* largohen. Nuk jemi shprehur për këtë gjë. Për, ata dhe ndonjë tjetër, kushdo, edhe një anëtar i KLD-së, i cili ka probleme, nuk kalon *vetingun* të ikë. Pra, çfarë kemi? Ne themi *veting* për të gjithë nga i pari deri tek i fundit sa më shpejt. Mund ta vendosim ta fillojmë me të gjithë, në fillim me anëtarët e KLD-së. Jo se nuk na lejohet. Propozimi im është ta fillojmë nga Edi Rama dhe me të gjithë. Ky është propozim. Është reformë politike kjo. Pra, ky është qëndrimi im.

Oerd Bylykbashi – Unë dua të përforcoj atë që tha kolegu Halimi, në lidhje me çështjen e mbarimit të mandateve. Mbarimi i mandateve duhet të jetë vetëm për shkaqe individuale kushtetuese, jo për shkaqe kolektive të shkruara në Kushtetutë. Zyrtarët e përfundojnë mandatin e tyre kushtetues dhe ky është parim. Këtë e ka thënë Komisioni i Venecias më herët, po për Shqipërinë, e referoi zoti Halimi. Unë nuk i mbaj mend emrat ndër vite të anëtarëve të Komisionit të Venecias. Nëse e ka thënë një herë për Shqipërinë, por kur e ka thënë dhe për vende të tjera vlen dhe sot. Kështu që ky është një parim që ne duhet ta marrim patjetër në konsideratë dhe nuk ka rrugëdalje nga kjo. Sigurisht që duhet të jemi po aq të kthjellët për të parashikuar tranzicionin në sistem, por ruajtja e mandateve është parim, përndryshe do të krijojmë vetëm destabilitet. Ne nuk jemi përpara revolucionit, por jemi përpara reformës dhe reformë do të thotë mençuri.

Po ju jap vetëm një shembull. Unë jam marrë me vite me reformën zgjedhore dhe një nga gjërat që kemi bërë, madje duke ndier shqetësim të gjithë, ka qenë ndërprerja e mandatit të anëtarëve të KQZ-së. Ju e dini shumë mirë që një KQZ që ishte totalisht e kapur, ajo e vitit 2000, ishte e pamundur të ndryshohej, të reformohej në vitin 2002, në vitin 2004. Pse? Sepse KQZ-ja ishte organ kushtetues. Nuk po vë emra anëtarësh dhe përpjekjet që bëheshin në KLD për ta kapur emërimin e anëtarit konsensual. Kjo u zgjidh në vitin 2008, kur u hoq nga Kushtetuta KQZ-ja si organ kushtetues. Arsyeja kryesore ishte se ndërkohë ishte i nevojshëm balancimi i KQZ-së, por nuk duhet të na krijonte pengesë dispozita kushtetuese. Pra, mandati kushtetues nuk ndërpritej dot dhe marrëveshja që e tillë. Nëse disa gjëra kanë qenë të vërteta atëherë, për të cilat kemi rënë dakord atëherë, nëse disa kanë qenë të vërteta më përpara dhe Komisioni i Venecias na i ka thënë këto të vërteta, janë dhe sot po aq të vërteta. Kështu që meqë historia nuk fillon

as sot, as me ju, as me ne, ne këtë parim duhet ta kemi parasysh, se është parim dhe është i ngulur fort në Kushtetutë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Majko.

Pandeli Majko – Të jem i sinqertë i dëgjova me shumë vëmendje kolegët e mi dhe jam i prirur të mos orientohem nga një lloj keqinterpretimi, keqdashës, sepse atmosfera këtu mbi të gjitha është atmosferë pune dhe pastaj për të diskutuar keqinterpretimet politike.

E vlerësoj shumë atë që thatë, se Partia Demokratike në qeverisjen e saj e ka pasur si parim thelbësor mosndërprerjen e mandateve dhe nuk dua t’ju citoj në vazhdim. Mirëpo tani ne jemi në një tavolinë pune që quhet Komisioni Parlamentar për Reformën e Drejtësisë.

Së bashku kemi rënë dakord për të ndërtuar një arkitekturë të re të sistemit të drejtësisë, sepse për këtë e kemi mandatin. Nëpërmjet kësaj reforme që kemi diskutuar në parim të paktën të biem dakord në këto fakte logjike, sipas mendimit tim.

Së pari, kemi ndryshim apo jo të profilit të institucioneve, të cilave natyrshëm do t’u ofrohemi për t’i diskutuar mandatin. Ne kemi rënë dakord se do të krijojmë Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, i cili do të bëjë vlerësimin e të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve, pavarësisht nivelit dhe juridiksionit. Kam përshtypjen se është në funksion të kësaj që po diskutojmë, ngritja e sistemit të rivlerësimit dhe në thelb rikonturimi apo ndryshimi i profilit të institucionit e sjell natyrshëm diskutimin e mandateve, sigurisht brenda një fleksibiliteti, sepse ne nuk duam kolaps institucional. Mendoj se në këtë drejtim duhet të ecim sipas edhe asaj që do ta quaja këshillë të Komisionit të Venecias.

Zoti Oerd, unë po i përgjigjesha shqetësimit që ngritët ju. Kur një institucioni i ndryshohet profili, ne do të diskutojmë edhe se çfarë do të bëjmë me strukturën e tij të vjetër, nëse do të ecim me logjikën thjesht empirike kush ka mandatin nuk preket, atëherë unë bëj një pyetje përsëri empirike, ndoshta edhe naive: KLD-në do ta mbajmë kështu siç e kemi? Sa do vazhdojë kjo KLD? Pastaj të paktën të lëmë ndonjë testament, ta lëmë reformën e drejtësisë si testament, të mos e lëmë kështu si ligj ose si ndryshim

kushtetues. Sot ne do të diskutojmë reformën e drejtësisë apo testamentin që do t'u lëmë kur t'u mbarojë mandati përfaqësuesve në institucione? Duke pasur parasysh që Shqipëria ka një përvojë në këtë drejtim, kur miratoi ndryshimet kushtetuese që riorganizoi të gjithë sistemin e saj në vitin 1998, duke qenë se përballë ndryshimeve që po bëjmë në sistemin e drejtësisë me mandatin që kemi marrë nga parlamenti për të bërë ndryshimet kushtetuese, kemi një ndryshim të një natyrë të tillë, besoj se në këtë pikë të dyja palët duhet të jemi fleksibël lidhur me logjikën empirike për mosprekjen e mandateve. Ne nuk po diskutojmë sot si problem bazë parimor çështjen e mandateve, por po diskutojmë një rikonfigurim esencial thelbësor të sistemit të drejtësisë. Ne këtë këndvështrim mendoj se duhet të ecim sipas këshillave të Komisionit të Venecias, duke qenë të hapur për të diskutuar atë që do ta konsideroj tranzicion apo dispozita transitore lidhur me marrëdhëniet që do të kemi me mandatet e vjetra qofshin këto në KLD, në Gjykatën e Lartë, Gjykatën Kushtetuese e kështu me radhë. Po i rikthehem përsëri, nëse do të themi se mandatet nuk preken, atëherë çfarë do të bëjë Komisioni i Rivlerësimit? Do t'i thërrasë për një debat teorik lidhur me jurisprudencën, apo do t'i thotë në një moment të caktuar: “Zotëri t'i nuk bën për atë vend. Megjithëse ke një mandat, ai mandat mbaron këtu”, pasi këtë të drejtë do t'ia japim ne me votën tonë në parlamentin e Shqipërisë, kur do të vijë problemi i diskutimit të elementëve të natyrave të tjera.

Nuk dua të bëj ironi, por me shumë mirëkuptim kërkoj nga kolegët e opozitës të ndajmë një gjë: nëse themi se sot kemi një korporatë, po ju citoj ju, nuk besoj se tani jeni duke na kërkuar që korporatës të mos i preket mandati? Nuk po e keqinterpretoj. Besoj se është thjesht një lapsus.

Faleminderit!

Oerd Bylykbashi - Zoti Majko, unë fola për shkaqe kushtetuese individuale dhe jokolektive për mbarimin e funksionit, sepse nuk jemi duke ristrukturuar administratën dhe nxjerrim të papunë, do të reformojmë sistemin dhe ata që nuk qëndrojnë dot në sistem do të ikin. Çështja e mandateve kushtetuese është parim, nuk është çështje e testamentit të vjetër ose të ri, se ndoshta i vjetri na solli këtu ku jemi.

Hajdeni të bëjmë të riun! Meqë rrugët e atij të madhit janë pafund, le t'ua lëmë ekspertëve, sepse do ta gjejnë rrugën dhe të mos ngatërrohem këtu.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Po, zoti Mediu.

Pastaj zonja Hysi.

Fatmir Mediu - Do të thosha, se shqetësimi ynë është në konformitet me Kushtetutën. Për sa kohë ka mandate të përcaktuara në Kushtetutë, ndërhyrja e njëanshme pavarësisht nga arsyetimet që përdorim këtu, nuk po bën gjë tjetër, vetëm se do të krijonte probleme në vazhdimësinë e funksionimit të këtyre institucioneve të rëndësishme kushtetuese. Për sa kohë i referohemi Komisionit të Venecias, le të marrim rastin konkret, të shprehjes së Komisionit të Venecias për prokurorin e Përgjithshëm: e ka konfirmuar edhe për herën e dytë se është i paarsyeshëm diskutimi i mandatit të prokurorit të Përgjithshëm.

Siç u shpreh dhe zoti Bylykbashi është e rëndësishme që për mandatin individual jokolektiv, ne duhet të ruajmë konformitetin kushtetues. Po të dalim dhe t'i analizojmë të gjitha mendoj se në vend që të krijojmë diçka pozitive, vetëm do të krijojmë probleme.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Po, zonja Hysi.

Më pas zoti Strazimiri.

Vasilika Hysi - Faleminderit, zoti kryetar!

Ju kërkoj ndjesë për zërin.

Flasim për dy probleme të ndryshme. Në radhë të parë është mandati i prokurorit të Përgjithshëm për të cilin komisioni ka një opinion të Komisionit të Venecias.

E dyta është Këshilli i Lartë Gjyqësor. Nëse do t'i referohemi projektit të ndryshimeve, konkretisht nga nenet 147, 147/"a", "b", "c" dhe "ç" rezulton se tashmë nuk flasim për të njëjtin këshill, siç është sot Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Ndryshimet janë aq esenciale sa që flasin për dy trupa që deri diku janë të ndryshme. Në radhë të parë lidhur me përbërjen që është e ndryshme.

E dyta, lidhur me kompetencat.

Çështja e tretë është me kryesimin që në rastin konkret po të shikoni kryetari zgjidhet nga trupa jogjyqtare.

E katërta lidhet me raportet me institucionet e tjera sidomos me tribunalin që sot nuk e kemi te Këshilli Lartë i Drejtësisë.

Do të doja pa përsëritur kolegun Majko të theksoja se e gjithë kjo reformë me të vërtetë nuk është një revolucion, por Këshilli i Lartë Gjyqësor është qeveria e gjyqësorit, do të jetë qeveria e gjyqësorit. Sa ka rëndësi ai proces i *vetingut*, po kaq ka edhe organizimi dhe funksionimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor. Unë nuk arrij dot të konceptoj po ju dëgjoja me vëmendje, ndërkohë sesi mund të kemi një reformë në drejtësi ku institucionet kanë ndryshuar, kur kemi vënë rregulla të pluralizmit në përbërjen e shumë trupave gjyqësore dhe KLD-në do ta lëmë ashtu siç është sot me presidentin, me ministrin, të pranishëm e të tjera, ndërkohë që ndryshimi kryesor dhe thelbi i qeverisë së gjyqësorit është Këshilli i Lartë Gjyqësor.

E fundit fare, ju thoni që ky është një problem kushtetues. Po, mandatet janë një problem kushtetues. Ne po diskutojmë për dispozita kushtetuese, për dispozita në Kushtetutë, nuk do të kërkojmë të bëjmë gjëra që nuk do të jenë të parashikuara në Kushtetutë, ato do të jenë në Kushtetutë, të parashikuara qartë në dispozitat kalimtare, por në këtë mënyrë do ta bëjmë të gjithë sistemin funksional. Përndryshe nëse do të lëmë një të paprekur, një tjetër të ndryshuar, krijojmë një strukturë të re, siç është për shembull tribunali, atëherë në këtë reformë e kemi sakatuar pa e nisur ende.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Zoti Strazimiri, po shikon lart për ndonjë përgjigje nga ai lart, por nuk ke gjë në vijë, më duket.

Gent Strazimiri - Ngrita kokën tek ai lart, pashë yllin.

Kam një pyetje për zonjën Hysi. Ne nuk mund të sakatojmë reformën në drejtësi, duke u futur pas labirinteve nga të cilat nuk dalim dot. Unë nuk e di, a do të ishte një reformë e mirë në drejtësi, nëse ne sakatojmë Kushtetutën dhe parimet e saj, qoftë edhe në dispozitat transitorë, për të dalë tek ajo që e quajmë një reformë në drejtësi dhe që do të jetë një krijesë e papërlyer, se këtë po tentojmë të bëjmë. Kemi parime kushtetuese, jo dispozita kushtetuese, mandati është çështje parimi, është themel kushtetues, është një nga themelet në të cilat ngrihet një kushtetutë demokratike. Kemi vendimet e Gjykatës Kushtetuese, që e përcaktojnë deri në detaje çfarë është, pse duhet të jetë aq dhe pse nuk mund të ndërpritet në vitin 2008. Në vitet 2009 dhe 2010

kemi bërë një debat të madh për punën e mandatit të prokurorit të Përgjithshëm. Po flasim këtu dhe shkruhen gjërat pavarësisht se ndryshojnë emrat, konceptin kushtetues siç e interpretuam në vitin 2009 dhe në vitin 2010, do ta interpretojmë edhe sot. Në emër të faktit dhe të domosdoshmërisë që duhet të bëjmë një reformë, të cilën nuk mund ta sakatojmë, pyetja ime është: A mund të sakatojmë parimet kushtetuese në emër të reformës? Sepse në këtë sallë kemi qenë, me këtë yll sipër kokës, kur keni thënë disa fjalë të tjera.

Vasilika Hysi – Unë e kuptova shumë mirë pyetjen tuaj. Pajtohem me ju që nuk mund të ketë ndërprerje të mandateve kushtetuese, është parim, por kur flasim për institucione, të cilat mbeten të pandryshuara, do të ishim në kushtet e ndërprerjes së paligjshme të mandatit, të shkeljes së parimeve kushtetuese, nëse Këshilli i Lartë Gjyqësor nuk do të kishte atë përbërje që propozohet sot me projektin, nuk do të kishte rregulla të reja të zgjedhjes së anëtarëve, nuk do të kishte rregulla ose raporte të tjera të këtij këshilli në raport me organet e tjera që krijohen të reja, nuk do të kishte një koncept komplet tjetër të përbërjes së tij që nga kryetari, nënkryetari, mandatet e çdo anëtari e të tjera. Në këtë kuadër do të thosha që po, është antikushtetuese t'i ndërpresësh mandatin një anëtari të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Unë e thashë që në fillim, por ndoshta zëri im nuk erdhi ashtu siç duhet. Flasim për një institucion, që do të jetë qeveria e gjyqësorit që është totalisht i rikonceptuar, jo vetëm nga përbërja, nga numri real i anëtarëve, por së dyti nga raporti midis gjyqtarëve dhe jogjyqtarëve, nga kryetari, se kush do të jetë kryetari, nga roli që ka Kuvendi në përzgjedhjen e tyre nga mënyra, nga kompetencat që kanë, nga raporti që kanë lidhur me masat disiplinore me shkarkimin e të tjera. Flasim për një institucion, i cili do të jetë ashtu siç e kemi kërkuar ne: qeveri reale e ekzekutivit.

Nga ana tjetër ju e thatë pak më parë që ne po shkojmë te ky institucion i rikonceptuar për faktin se e kemi pranuar që politika e ka dëmtuar. Ne po luftojmë të shmangim ndikimin e politikës. Atëherë nëse duam të shmangim ndikimin e politikës dhe duam të krijojmë një institucion pluralist, të cilin e ka vlerësuar Komisioni i Venecias, që ka një raport 6 me 5 dhe kryetari do të jetë nga trupa jogjyqësore për të shmangur konfliktin e interesit e të tjera, do të ketë proces transparent për zgjedhje, kritere të forta, pra nuk do të ketë më juristë të shquar apo njerëz siç shumë herë i

dëgjojmë këtu dhe ka rezultuar që shpesh për të sqaruar janë apo nuk janë efektivë i kemi çuar deri në Gjykatën Kushtetuese për të bërë interpretimin e këtyre togfjalëshave.

Mendoj se flasim për një organ komplet të ri. Ajo që ne kemi për detyrë dhe unë e gjykoj se është përgjegjësi e madhe është që Kuvendi të votojë veç për çdo grup kandidatësh për të përzgjedhur anëtarin që do të jetë në Këshillin e Lartë. Duhet të jemi të përgjegjshëm, të ndërgjegjshëm, profesionalë dhe pavarësisht se përfaqësojmë forcat të ndryshme politike, këtu duhet të zgjedhim njerëzit më të mirë. Këtu është thelbi: çfarë do të zgjedhim. Nëse do të kemi një proces transparent, jo vetëm ne, por edhe ata që do t'i propozojmë, pra procesi i propozimit do të jetë transparent, gjithëpërfshirës, atëherë ne do të shmangim të gjithë këtë frikë që kemi. Ne sot flasim për korporata ose për ndikim të politikës, se kemi parasysh atë situatë që është sot në gjyqësor, atë krahurë që ka bërë politika.

Unë theksoj dhe po e mbyll, se nuk dua ta diskutoj më gjatë këtë gjë, kryesorja: abc-ja është *vetingu* dhe në rast se nga shosha, nga selektimi do të dalin njerëzit më të mirë, nuk duhet të fillojmë t'i paragjykojmë. Ne politikanët nuk kemi të drejtë t'i paragjykojmë. Pastaj sesi do t'i ndjekim proceset, si do të bëhet përzgjedhja e tyre është diçka tjetër.

Gent Strazimiri – Zonja Hysi shqetësimi im ishte krejtësisht kushtetues. Nuk kishte të bënte me edukimin moralo-politik apo me përzgjedhjen në bazë të kritereve morale të atyre që do të dalin.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Xhafaj, më falni një sekondë!

Bëra një pyetje kushtetuese, por vetëm kushtetutë nuk pashë brenda në të.

Është i njëjti institucion, me të njëjtën detyrë, me të njëjtat funksione, me të njëjtin rol kushtetues, i ridimensionuar në raportin politikë- gjyqtarë- shoqëri civile e të tjera me radhë. Fakti që i ndërron emrin, nuk e bën të ndryshëm, ai do të kryejë të njëjtën detyrë.

Neni 1 në ligjin aktual të KLD-së është: "I vetmi organ i vetëqeverisjes së sistemit gjyqësor", do të vazhdojë të jetë kjo, do t'i vësh një emër tjetër, do të caktosh disa raporte të tjera, është ekzaktësisht e njëjta gjë. Është tjetër gjë detyra që ka, funksioni që do të kryejë. Roli kushtetues që do të kryejë është i njëjti, brenda për brenda

po bën një organizim tjetër. Nga pikëpamja kushtetuese, të masakrosh Kushtetutën për të njëjtën gjë, sepse kësaj i ke ndërruar emrin, a është mekanizmi i duhur? Përgjigjja nuk mund të jetë: të përpiqemi të zgjedhim njerëzit më të mirë, ta bëjmë transparent procesin dhe të jemi të kujdesshëm.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Unë shkurt do të thosha dy-tre gjëra.

E para, po flasim për një arkitekturë të re të sistemit. Nëse i përmbahemi kësaj logjike nuk kemi Këshill të Lartë të Drejtësisë, por Këshillin e Lartë Gjyqësor, i cili nuk ndryshon thjesht emrin, por ndryshon funksionin, kompetencat dhe mënyrën e formatimit. Kemi një strukturë të re. Është një zgjidhje që është pranuar të jetë si e tillë është mbështetur fort edhe në opinionet përkatëse të Komisionit të Venecias dhe në asnjë rast nuk ka pasur diskutim kjo çështje dhe nuk ka sesi të ketë diskutim. Bëhet fjalë për një strukturë tërësisht të re në funksion, në kompetenca dhe në përbërje. Rrjedhimisht, për sa kohë kemi një institucion të ri, nuk mund të qëndrojmë në fuqi institucioni i vjetër. Këtë të fundit kur të bëhet muzeu i gjyqësorit, do ta vendosim atje, si të gjitha institucionet e tjera.

Në vlerësimin tim, e njëjta gjë vlen edhe për prokurorin e Përgjithshëm, po të më pyesni mua personalisht edhe funksionet e prokurorit të Përgjithshëm janë paksa të ndryshme, një pjesë e kompetencave dhe e funksioneve të tij, por Komisioni i Venecias ka bërë një arsyetim dhe ne do ta respektojmë atë arsyetim, atë sugjerim të Komisionit të Venecias. Këtu nuk kemi më fjalë për të thënë, ka dhënë një zgjidhje, ne i qëndrojmë asaj zgjidhjeje, sepse kemi vendosur t'i qëndrojmë besnikë asaj për të cilën kemi rënë dakord të gjithë, që opinionin e Komisionit të Venecias është bazamenti dhe korniza ku do të mbështetet i gjithë arsyetimi që kemi ne për projektin.

Gjithsesi, mbetet që për këtë çështje të kemi më pak debat se për çdo gjë tjetër, por le të ecim me çështjet e tjera.

Eduard Halimi – Kam edhe unë një konsideratë lidhur me këtë çështje, para se të kalojmë te tjetra.

Tani, ne jemi dakord me komponentët që kanë të bëjnë me antikorrupsionin dhe kanë efekte të menjëhershme nesër për sistemin: byro, prokurori speciale, gjykatë

speciale, veting. Për këtë pjesë, po them, ne kemi dakordësi, pra biem dakord që ta miratojmë sa më shpejt, javën tjetër.

Për pjesën e institucioneve të tjera, pra ndërtimit të arkitekturës s institucioneve, të cilat do të jenë të përhershme, edhe prokuroria speciale të përhershme, por këto që kanë të bëjnë me atë që thotë me të drejtë Vasilika...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk është vetëm pjesa e KLGJ-së. Gjyqësori do të administrohet jo vetëm nga KLD-ja. Është menduar një arkitekturë e re, një model i ri, se si do të qeveriset i gjithë gjyqësori, që në momentin e emërimit, KED-ja, TD-ja, NNAPQ-ja e të gjitha me radhë, të gjitha ato, me të gjitha bashkëtingëlloret e mundshme, që përfshihen aty.

Për gjithë këtë, ne kemi mosdakordësi, që ka të bëjë jo me çështjen e kapjes, u zgjidh, po them pjesa, se e tha Venecia, por me problemin tjetër që kemi, me çështjen e llogaridhënies dhe me çështjen e checks and balances. Kemi një mosdakordësi, e cila duhet të zgjidhet në vijim, në pjesën në vijim, përveç këtyre për të cilat kemi rënë dakord. Edhe për pjesën e ILD-së, duhet të jetë komponenti, nëse do të ekzistojë apo nuk do të ekzistojë, e me radhë pjesa tjetër, në lidhje me pjesën e mandateve, kjo është një çështje tërësisht parimore.

Unë bie shumë dakord me Vasilikën, që vetingu e sqaron këtë gjë. Vetingu është themelor në këtë proces. Të gjithë anëtarët, që nesër, kur të miratojmë atë pjesën e akteve nënligjore për vetingun, mund të vendosin kë të vendosin anëtarët e këta që do të merren, anëtarët e KLD-së, anëtarët e Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese e kështu me radhë. Vetingu i sqaron të gjitha.

Standardi që ne duhet të mbajmë, mendoj unë, duhet të jetë i njëjtë për të gjithë zyrtarët e vendit. Kur them i njëjtë, duhet të jetë i njëjtë. O i ndërpresim të gjithë, ose s'ndërpresim asnjë. Ky është standard, mendoj unë. Ndoshta s'e zgjidhim dot sot, sepse kemi çështje të tjera. Kjo është e lidhur me pjesën e qeverisjes. Ndoshta do ta diskutojmë sërish radhës tjetër këtë çështje. Ama, gjykimi i Partisë Demokratike është: mandatet janë kushtetuese dhe, ose ndërpriten të gjitha ose asnjë. S'është puna për gjyqtarët. Ata, e thashë, e kalojnë vetingun menjëherë me të tjerët.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me funksionarët e tjerë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tre e anëtarët që keni zgjidhur juve, i zgjidhni ju, s'i zgjidhni, ua ndërprisni, s'ua ndërprisni, kjo është çështja juaj, por ama, çështjes e mandateve kushtetuese, përfshirë edhe mandatin e Presidentit të Republikës, si kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, mund t'u gjendet zgjidhja. Ne duhet të kemi një standard që ta vendosim, sepse janë institucione të përhershme, nuk janë pjesë e institucioneve të përkohshme, që kanë të bëjnë me procese të përkohshme, të shpejta, efikase. Ky nuk i jep efektet tani. Ndërtimi i KLGJ-së e këto, do t'i japë efektet pas një viti. Sikur ne ta miratojmë pas një muaji, është ndërtimi i saj, do të merret me çështje që kanë të bëjnë me pjesën e procedurave disiplinore, do t'ua lëmë inspektimin inspektorëve apo do ta bëjmë sipas modelit francez, t'ua shpërndajmë institucioneve të tjera.

Pra, mund të kemi një organ që me të drejtë u tha se mund të jetë një person, ndërsa kur do ta filloje inspektimin, kjo është një çështje tjetër.

Dhe do të jetojë shumë gjatë. Në këtë pjesë, ne duhet të jemi të kujdesshëm dhe të mbajmë një standard: o të gjithë o asnjë. Një mënyrë mund të ishte mënyra që është ndjekur për Prokurorin e Përgjithshëm, që Prokurori i Përgjithshëm, në fund të mandatit, në qoftë se kalon procesin e vetingut e me radhë, të vazhdojë, e njëjta gjë mund të jetë edhe për Presidentin e Republikës.

Nuk po e paraqes as si platformë e as si ide, por ama ka një çështje për të cilën Partia Demokratike është parimore në këtë proces. Mandatet kushtetuese nuk ndërpriten për askënd pa shkak ligjorë Ose ndërpriten të gjithë ose s'ndërpritet asnjë. **Vetëm** po të jetë shkak që ka të bëjë me mbarimin e mandatit. Ky është diskutimi i sotëm. Këtu kemi një mosdakordësi, por besoj se do të diskutohet edhe në ditët në vijim.

Oerd Bylykbashi – Pra, një shembull për t'u kthjelluar se çfarë kemi bërë ne në vitin 2008ë U bë një ndryshim i rëndësishëm në Kushtetutë. Me një fjalë shumë i rëndësishëm. U vendos diçka që i mungonte një prej funksioneve kryesore kushtetuese në sistemin e drejtësisë. Prokurori i Përgjithshëm, pa mandat kohor, u bë me mandat kohor pesëvjeçarë

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E the? Se ndoshta më shpëtoi.

Ndryshimi është thelbësor, është një nga elementët kryesorë, por debatin e kujtoni. Nuk ka dispozitë transitorë, nuk e aplikojmë dot. Ajo u aplikua, debatin nuk po e përsëris këtu, por shembullin e keni, qëndrojeni të vërtetë vetes.

Faleminderit!

Pandeli Majko – Unë mendoj se tani debati ka dy kategori këndvështrimesh: këndvështrimin politik dhe atë juridikë. Po përpiqem të them shkurtimisht, se si i kuptoj unë kolegët.

Mendoj të biem dakord të dyja palët, ky është propozim për procedurë, para se të flas, që në fund fare, ekspertiza ndërkombëtare të na japë një opinion lidhur me këtë debat për çështjen e ndërprerjes së mandateve.

Po e filloj politikisht, por të bashkëlidhur me gjuhën juridike. Po përsëris një shprehje që dëgjoja këtu, për çështjen e mandateve: “o të gjithë o asnjë!”

Mirëpo, tani unë kam përballë zotin Oerd Bylykbashi, i cili, së bashku me Taulant Ballën, na ka sjellë një ligj për dekriminalizimin. Tani, si ta kuptoj, zoti Oerd? Në një republikë parlamentare, ne biem dakord të ndryshojmë kushtetutën me konsensus, t’i ndërpresim mandatin deputetit, dhe madje të biem edhe politikisht dakord, me një lloj vetëdijeje kushtetuese, që ky ligj i dekriminalizimit të mos shkojë në Gjykatë Kushtetuese.

Pra, nëse do të ecim sipas logjikës “O të gjithë o asnjë”, nuk e kuptoj këtë inkandeshencë tuajën, këtë mënyrë të të ofruarit për sa i përket çështjes së mandateve. Besoj se, në këtë drejtim, nuk dëshiroj të dëgjoj vjersha të tipit: “Po barazon një kriminel të kriminalizuar, me një gjykatës dhe me një prokuror”.

Jo, po diskutoj çështjen e ndërprerjes së mandatit si parim. Në qoftë se ju, përfaqësues të Partisë Demokratike, të opozitës, e shtroni çështjen e mandateve si parim, atëherë, zotërinj, kemi pak javë që e diskutuam dhe kemi rënë dakord se ndërprerje mandatesh do të ketë. E para.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po flas edhe për pezullim mandatesh.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mor po krim e çfarë të duash ti.

Megjithatë, po i rikthehem faktit që, këtu kemi diskutuar dhe kemi bërë debat deri edhe për pezullim mandatesh, të përkohshëm.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tani, ligji e ka moralizmin në fund fare. Po diskutojmë çështjen në parim të asaj që do të shkruhet e zezë mbi të bardhë. Çështja e ndërprerjes së mandateve. Po e përsëris edhe një herë: në kushtet që, si precedent, nuk qëndron çështja parimore që nuk mund të kemi ndërprerje mandatesh “o të gjithë o asnjë”. Parimisht. Të paktën ne që jemi deputetë në këtë parlament. Sepse, po të ecim me konceptim moral dhe moralizues, i bie që ndryshimet e nesërme të Kodit Penal të shkojmë e t’i diskutojmë te burgu 3013.

Megjithatë, dëshiroj ta vazhdoj këtë. ne po ndryshojmë profilin e institucioneve. Dua ta përsëris atë çfarë thashë edhe më parë. Në kushtet kur, nga Gjykatë të Lartë, do të kemi edhe Gjykatë të Lartë, dhe Gjykatë të Lartë Administrative, kemi ndryshuar profilin e institucioneve, zotërinj.

Në kushtet kur sot kemi Prokuror të Përgjithshëm, nesër do të kemi prokuror të Përgjithshëm dhe Prokuror të Posaçëm, kemi ndërhyrë te profili i institucionit, zotërinj.

Ju pyes: pasi kemi rënë dakord që Komisioni i Verifikimit do të ketë të drejtën t’i thotë gjykatësit të korruptuar, prokurorit që nuk gjen asnjë arsye për të...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ah, do t’u ndërpritet?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po mirë, pra, atëherë shpjegojeni pak më qartë këtë problem.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo pjesë ka të bëjë vetëm me njërën anë të situatës. Tani vijmë te logjika tjetër: te ndryshimi i profilit të institucionit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

O zotëri, a ka mundësi?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A ka mundësi? Unë ju dëgjoj me shumë vëmendje kur flisni ju.

Ndryshimi i profilit të institucionit e sjell të natyrshme çështjen e mandateve. Ne nuk po themi t’i biem me sëpatë këtu, dhe as që bëhet fjalë për të krijuar kaos.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, a ka mundësi? Ore, ç'është kjo tani? Unë ju dëgjoj me shumë vëmendje. Mos flisni nga vendi. Ja ku e ke mikrofonin! Kërko fjalën dhe fol!

Pra, në këtë pikë, ne kemi kërkuar edhe një këshillë nga Komisioni i Venecias. Me të drejtë, ju thatë për prokurorin e Përgjithshëm se është shprehur Komisioni i Venecias. Dakord. E shikojmë. Jemi të hapur në këtë drejtim, po edhe për çështje të tjera, për të cilat është shprehur Komisioni i Venecias, e jo atëherë kur na shkon gondola në drejtimin e Komisionit të Komisionit të Venecias, të themi: sipas Komisionit të Venecias, ndërsa aty ku nuk na intereson, të themi maska e Komisionit të Venecias. Ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është e kotë ta diskutojmë këtë histori. Në qoftë se do të bëjmë triqe juridike, që t'i riformulojmë këto institucione dhe të mbajmë këta që kemi emëruar ne, e i quajmë korporatë, dhe hajde negociojmë për ata që mund të na rrëshqasin...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ku jemi? Çfarë po diskutojmë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Çfarë po diskutojmë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në qoftë se ecim me logjikën: kemi një sistem që na është sëmurë me korporatizëm, atëherë mos na dilni në mbrojtje të...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E përsëris, jam i detyruar ta përsëris. Tani, e fillojmë diskutimin sot, duke thënë: “kemi korporatë, kemi korporatë, jemi fajtorë, jemi fajtorë”, po ju citoj juve, pastaj papritur, në fund të diskutimit themi: Jo, prit, është parim i rëndësishëm, korporatës i duhet respektuar mandati kushtetues.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mirë. E atëherë vijmë te ironia. E lëmë si testament reformën për drejtësi, atëherë.

Oerd Bylykbashi – Unë e falënderoj zotin Majko, i cili, në fakt, ndoshta pa dashje, gjeti pikërisht konsensusin. Ajo që thamë ne. Mandati kushtetues përfundon për shkaqe individuale kushtetuese...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për gjyqtarin, për deputetin, ministrin, Presidentin e të gjithë me radhë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë, një sekondë!

Por, duke qenë se nuk është reformë strukturimi e institucionit të administratës publike, nuk aplikohet. Tani, duke qenë se ajo që ju përmendët për dekriminalizimin, është rast individual, duke qenë se ne nuk u nisëm nga parime morale – se përndryshe populli kërkon që ta fshijë komplet këtë parlament që e keni mbushur me kriminelë, të shkrihet dhe të bëhet një tjetër – por ne po flasim për një reformë kushtetuese, jo morale. Për rrjedhojë, të ndajmë të njomin nga i thati. Ekzakt. Zoti Majko, unë mendoj se ju nuk besoni që çdo prokuror apo gjyqtar është i korruptuar. Mund të ketë edhe ndonjë që ka shpëtuar, në këtë histori. Atëherë, në këto kushte, do t'i marrim një për një me veting, me dekriminalizim apo me ç'të doni ju, dhe do t'i heqim të gjithë këta. Kjo nuk ka të bëjë me ndryshimin e formatit, sepse ju dhamë shembullin, ju dhamë parimet, ju dhamë dokumentet ndërkombëtarë, të shkruara për Shqipërinë, vendimet e Gjykatës Kushtetuese për këtë punë, në se jua thamë një herë, mbeten aty të shkruara, nuk ndryshojnë. Kështu, le ta marrim me qetësi, të gjejmë zgjidhjet, të cilat do të vendosin parimet, institucionet, tranzicionin e mjaftueshëm për t'i bërë gjithë këto gjëra, dhe të gjithë të jemi të kënaqur me atë që kemi bërë sipas parimit të Komisionit të Venecias.

Kështu që, le të mos i ngatërrojmë gjërat.

Eduard Halimi – Për të njëzetën herë apo për të satën herë të doni, për të qenë të qartë të gjithë këtu, se s'i kemi as mediet, njëlloj siç u siç u miratua paketa e dekriminalizimit për ndërprerjen e mandatit të çdo zyrtari a deputeti, duke filluar që nga Presidenti i Republikës e deri në fund, për shkaqe që kanë të bëjnë me cilësitë e tij, çdo gjyqtari, gjyqtar i shkallës së parë apo i gjykatës së lartë, prokuror i shkallës së parë apo Prokuror i Përgjithshëm, gjyqtar anëtar i KLD-së apo gjyqtar anëtar i çdo forumi tjetër gjyqësor, me mandat kushtetues, t'i ndërpritet menjëherë, sapo vetingu t'i nxjerrë, në çdo moment.

Pra, këto mandate kushtetuese, të të gjithë atyre që i kanë, të gjithë, në momentin që do të bëhet vetingu, do të ndërpritën.

Problemi që shtrojmë ne është: ndërprerja e mandatit apriori, pa e lidhur fare me personin, apriori. S'ka të bëjë me anëtarët, e thashë, për anëtarët-gjyqtarë vetingun e

fillojmë që nesër. Pra, me ndërprerjet apriori. S'do të thotë se kemi dakordësi për këtë punë. S'do të thotë se duhet të ketë dakordësi. Ky është një qëndrim i yni, i cili nuk lind sot e as nuk është se po themi sot. Ky është një qëndrim parimor. Është për sot dhe për nesër. Ndërprerje apriori. Ne, si Parti Demokratike, mendojmë se ndërprerje apriori nuk duhet të ketë. Nuk duhet të ketë ndërprerje apriori.

Ajo që është më e rëndësishme në gjithë këtë proces, është procesi i komponentit antikorrupsion.

Fatmir Xhafaj – Tani, që ta mbyllim këtë gjë, pikëpamja është e qartë. E thënë me terma praktikë, ju thoni se nuk duhet t'i ndërpritet mandati prokurorit aktual në detyrë, deri në përfundimin e mandatit të tij kushtetues, si dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë, deri në mandatin e tij kushtetues me shumë pikëpyetje në fund.

Në rregull, kjo është pikëpamja juaj. Ajo që themi ne, dhe nuk e themi vetëm ne, por e thotë edhe projekti, e thotë edhe Komisioni i Venecias, është se këtu nuk bëhet fjalë për mandate individuale, por bëhet fjalë për institucione të reja, pra një institucion të ri në funksione, në kompetenca dhe në përbërje.

Nëse nuk do ta ngremë këtë institucion të ri, dhe ky është diskutimi juaj, ju e kundërshtoni këtë gjë, është një çështje tjetër. Ne kemi rënë dakord t'i përmbahemi opinionit të Komisionit të Venecias. E kemi thënë këtë gjë: opinionit të Komisionit të Venecias është baza e konsensusit. Komisioni i Venecias e ka ndarë, në këtë rast. Gjithsesi, le të mbetet një çështje...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për ne nuk ka diskutim kjo çështje. Është një çështje që nuk ka fare diskutim, por pastaj mbetet çështje e votimit, a nuk e di se si do të vejë. Këtë le t'ia lëmë ditëve në vijim.

Por, ndërkohë që i gjithë projekti flet për një këshill të lartë gjyqësor, të diskutosh se si të mbash në këmbë Këshillin e Lartë të Drejtësisë aktual, jemi në dy pikëpamje krejt të ndryshme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Krejt të ndryshme, të themi të drejtën, në lidhje me këtë gjë. Për ta saktësuar, po themi, pjesën.

Unë gjykoj që në mbledhjen e ardhshme, kur të jetë, për të orientuar edhe ekspertët të cilët duhet të diskutojnë edhe me ekspertët tanë, në Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe në Këshillin Gjyqësor ka edhe një element tjetër, i cili duhet parë, sepse është racional, sepse KLGJ-ja është me 11, KLD-ja është me 15, ka anëtarë gjyqtarë më shumë sesa janë, ka komponentë të cilët, po them, duhet të rishihen.

Në qoftë se pozicionimi duhet të jetë i tillë, po them që, shiko, duhet të jetë me 15...

Fatmir Xhafaj – Nuk martohen ato të dyja. KLGJ-ja me KLD-në nuk martohen dot, me thënë të drejtën.

Eduard Halimi – Po, dhe kjo ka të bëjë me...

Është një pjesë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, mor, jo!

O Pandi, lëre se nuk është ashtu, gjithsesi!

Pra, bëhet fjalë jo për anëtarë dhe gjyqtarë, por kjo është një çështje e ndërprerjes së mandateve kushtetuese apriori dhe e anëtarëve *ex officio*, një çështje e cila është parimore e Partisë Demokratike për ta parë këtë në funksion të ngritjes së të gjitha institucioneve.

Kemi të gjithë korpusin e institucioneve të reja, të cilat ne mendojmë t'i diskutojmë javën e ardhshme. Mund të gjenden dhe mund të sjellin edhe formula ekspertët tanë bashkë me ekspertët, pra mund të shihet.

Për sa i përket çështjes së ndërprerjeve të mandateve, dua të them vetëm këtë që ndërprerje apriori ose duhet të ketë për të gjithë, që është absurde, ose nuk duhet të ketë për asnjëri.

Nuk e kam fare unë as me ata, ata e kanë vetingun të gjithë. Kështu bëjnë standardin për prokurorin, kalojnë vetingun dhe vazhdojnë. Nuk lihet as me testament, se është e gabuar edhe pjesa për t'ia lënë me testament prokurorit të ri të Përgjithshëm në vitin 2018.

Gjithsesi, e thashë, kjo është një çështje që do të ridiskutohet në momentin kur ekspertët tuaj me ekspertët ndërkombëtarë dhe ekspertët tanë me ekspertët ndërkombëtarë ta shohin në tërësi gjithë pjesën e arkitekturës së sistemit.

Fatmir Xhafaj – Po e them paraprakisht, ekspertët nuk kanë asnjë detyrë dhe mandat të shikojnë përtej opinionit të Komisionit të Venecias. Kjo është...

As ekspertët ndërkombëtarë nuk e kanë këtë mandat dhe as mund ta marrin përsipër këtë mandat, as ua jep njeri këtë mandat, por ekspertët, gjithashtu, ata të partive jashtë Komisionit të Venecias nuk kanë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë e kuptoj shumë mirë Këshillin e Lartë të Drejtësisë, por më vjen keq, ngushëllime për Këshillin e Lartë të Drejtësisë!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po.

E mbyllëm këtë gjë.

Vazhdojmë tani me...

Ngushëllime për atë që iku dhe urime për atë që do të vijë!

Bëjmë pesë minuta pushim për të kaluar te çështja tjetër e rëndësishme.

Bëjmë pesë minuta pushim, sepse Silva është vetë i dytë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, jo, nuk e shtyjmë! Do ta bëjmë paraqitjen. Ju lutem!

Pesë minuta, me orë në dorë!

(Pas pushimit)

Fatmir Xhafaj – Pas këtij pushimi të shkurtër, rifillojmë mbledhjen.

Jemi te çështjet e tjera, por që kanë një emërues të përbashkët: zgjedhja e organeve, institucioneve të reja të sistemit. Zoti Bylykbashi është i autorizuar nga zoti Halimi për ta prezantuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Oerd Bylykbashi – Çështja, në mënyrë specifike, që do të prezantohet lidhet me emërimin e anëtarëve jogjyqtarë të të dyja organeve të reja që krijohen, Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Kjo çështje kërkon vërtet vëmendje për ta zgjidhur drejt, në mënyrë që të evitohet atë që thotë Komisioni i Venecias: të evitohet

kapja politike e sistemit, të evitohet çimentimi i kësaj kapjeje. Por, nga ana tjetër, për të luftuar korporativizmin e sistemit të drejtësisë, na duhet patjetër një komponent i rëndësishëm brenda për brenda këtyre dy organeve, për të siguruar përgjegjshmërinë e të dyja degëve, pra edhe e këtyre dy komponentëve: edhe të gjyqësorit, edhe të prokurorisë.

Ashtu siç e ka nënvizuar në të dyja raportet, Komisioni i Venecias e shtron fort problemin dhe sigurisht na e lë neve detyrën për ta zgjidhur së bashku, sepse sistemi i propozuar është problematik.

Unë do ta nisja që nga momenti i përbërjes numerike. Vërtet 15 e kemi sot, me një raport dy të tretat (gjyqtarët) dhe një e treta (jogjyqtarët) dhe kjo qartazi ka krijuar një koracë të fortë të korporatizmit, por e kemi ulur në raportin 6 me 5, ku kjo balancë është mjaft delikate.

Imagjini një pesëshe të kontrolluar nga maxhoranca politike, që e ka shumë të thjeshtë për ta kapërcyer gjashtën. Për rrjedhojë, kjo mund të na çojë në kapjen politike konsistente të KLGJ-së ose të KLP-së dhe, për rrjedhojë, merr rëndësi të madhe formula, mënyra sesi ne do t'i përzgjedhim këta pesë anëtarë, gjithmonë për të evituar kapjen politike të njërit krah, që do të thotë se do të nisim që nga kriteret që do të përcaktohen për këta anëtarë, kritere shumë të forta, nga mënyra e përzgjedhjes së tyre, kush do t'i përzgjedhë... Sigurisht, çështjet lidhen me njëra-tjetrën, jam dakord me zotin Majko, që t'i shohim të gjitha bashkë, dhe kemi bërë diskutime më parë për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, pra kush do t'i përzgjedhë, kush do t'i selektojë, çfarë do të bëjë me këto, si do të vijnë këto në procesin e asaj që kemi rënë dakord që do të jetë një votim në parlament dhe pastaj çështja e shumicës së përdorur për përzgjedhje dhe e formulës me të cilën do të votohet për të arritur tek ajo shumicë. Pra, është i tëri një koncept kompleks që ekspertët, jam i sigurt, edhe me kontributin tonë këtu, do të gjejnë një rrugë përfundimtare.

Për t'i dhënë një zgjidhje nga partnerët ndërkombëtarë është bërë propozimi dhe këto janë reflektuar. Madje edhe në Komisionin përfundimtar të Venecias janë propozuar deri në katër formula të ndryshme, ku një pjesë është me votim preferencial, një pjesë ka votim proporcional, si dhe ka një formulë tjetër që bën kombinime të këtyre, por, po themi, ndoshta shkon më fort drejt asaj që është garantimi i një elementi thelbësor që e

thotë Komisioni i Venecias: garantimin e pjesëmarrjes substanciale, rolit substancial të opozitës në procesin e përzgjedhjes së këtyre pesë anëtarëve në secilën nga këto dy trupa.

Pra, fjala kyçe “rol substancial” duhet të jetë i padiskutueshëm në gjetjen e zgjidhjes, si dhe çdo gjë tjetër më pas çon tek e kundërta: kapja dhe çimentimi i kapjes.

Sigurisht që ka zgjidhje dhe gjenden edhe brenda këtyre katër propozimeve, katër modeleve të bëra, por duhet thënë që, për shembull, votimet preferenciale në një trupë numerikisht të vogël, siç është parlamenti 140, me polarizim politik shumë të fortë, do të çonin në një votim në bllok, i cili nuk do të garantonte rolin substancial të opozitës. Risku do të ishte që të gjitha mandatet të merreshin nga maxhoranca, sidomos kur ajo zotëron një shumicë të cilësuar, siç është aktualisht.

Nga ana tjetër, duhet patjetër të gjejmë një zgjidhje të tillë që, përveçse garanton një shumicë, përveçse garanton rol substancial, eventualisht edhe konsensus apo kompromis për kandidaturat, të kemi edhe zhbllokim.

Sigurisht që është vënë në pikëpyetje edhe më herët, po themi, një mekanizëm i propozuar zhbllokimi, siç ishte ai i renditjes që bën KED-ja. Atëherë, a kemi zgjidhje të tjera? Sigurisht. Pra, nëse ne do të kemi një proces të hapur kandidaturash, me kritere shumë të forta kushtetuese për këto funksione, do të kemi kandidatura që vijnë nga grupe, po themi, të shoqërisë, të cilat nuk janë të pastra politikisht, por politika nuk i sheh të gjithë si të... Ka një rol të saj in aty brenda, pasi do të jetë ajo që do të votojë në fund fare. Nëse ne do të kemi një proces filtrimi të pakapur qoftë në mënyrën si ngrihet mekanizmi i filtrimit, si emërohen ata dhe ç'bën ai me këtë, pra ajo që diskutuam me atë renditje, ne mund të kemi një proces të suksesshëm në përzgjedhje.

Për të mos e zgjatur në lidhje me katër formulat, ne besojmë se formula e vetme që do të garantonte zgjedhjen e pesë anëtarëve, rolin substancial të opozitës në përzgjedhje, sigurisht kapacitetet profesionale nuk po i vë në diskutim, sepse ato do të bien dakord patjetër aty, është ajo që propozojnë partnerët ndërkombëtarë, ekspertiza e tyre, është ajo që quhet *reserved seats*, pra vendet e rezervuara, e cila do t'i garantonte maxhorancës dhe opozitës nga dy anëtarë, të përzgjedhur në mënyrë, po themi, të besueshme dhe të pranueshme, gjithashtu, përzgjedhjen e anëtarit të pestë nëpërmjet, po sipas kësaj formule, një votimi me shumicë të cilësuar, po themi, me tre të pestat, por me një mekanizëm votimi dhe zgjedhjeje përfundimtare, e cila do të garantonte zgjedhjen...

(Diskutime në sallë.)

Zoti Majko, më fal!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, them që të jemi të qartë nga të gjithë...

Pra, do të garantonte: a) zgjedhjen e anëtarit të pestë, do të garantonte një konsensus të gjerë parlamentar, sepse tre të pestat presupozohet se do të japin një gjë të tillë, por do të evitonte edhe kapjen, siç është situata sot. Pra, duke mos u bllokuar mekanizmi i votimit, do të na çonte në një kandidat, i cili do të gëzonte mbështetjen më të gjerë të mundshme të parlamentit shqiptar nga të dyja krahët, përfshirë edhe opozitën.

A ka zgjidhje? Sigurisht që ka, teknike, dhe unë nuk besoj që këtu do të kemi shumë debat. Kjo që ne parashtrijmë është një formulë e propozuar nga partnerët ndërkombëtarë, na është ofruar mundësia për të përzgjedhur mbi këtë dhe pse jo kjo. Sigurisht, e theksoj edhe një herë, me instrumente të forta kontrolli, që do të ulin maksimalisht politizimin e kandidaturave, por maksimalisht. Këtë e kemi në dorë së bashku. Kjo është e vetmja që do të na çojë neve që, si në rastin e KLGJ-së, ashtu edhe në rastin e KLP-së, të përzgjedhim këta pesë anëtarë jogjyqtarë, që garantojnë instrumentin antikorporatizëm, aksesin tonë në sistem dhe përgjegjshmërinë e gjyqësorit dhe të prokurorisë të ne që zgjidhemi dhe, po themi, tek i gjithë opinioni publik, por, nga ana tjetër, nuk lejon kapjen dhe çimentimin e kësaj kapjeje politikisht të KLGJ-së ose të KLP-së.

Unë po e mbyll këtu këtë prezantim. Pastaj, nëse ka propozime të tjera, sigurisht që kjo ka të bëjë, siç e thashë, edhe me elemente të tjera, që kanë të bëjnë edhe me efekte të cilat duhen zgjidhur për pasojë të diskutimit të mëparshëm, të nevojave për tranzicion në arritjen e zgjidhjeve për këto institucione.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë po e mbyll këtu prezantimin.

Fatmir Xhafaj – Jo, kam unë një pyetje te...

Oerd Bylykbashi – Ajo që thashë unë nuk ka lidhje me dy të tretat.

Fatmir Xhafaj – Me pak fjalë, me sa kuptoj unë, ju thoni që ka pesë anëtarë jogjyqtarë në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe pesë anëtarë jogjyqtarë në Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe ju thoni: dy t'i zgjedhë opozita dhe dy t'i zgjedhë maxhoranca.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

A mund të na e qartësoni formulën që të kuptojmë...?

Eduard Halimi – Në rregull.

Formulën nuk e propozon Partia Demokratike, pra nuk është një formulë që e propozon Partia Demokratike.

Fatmir Xhafaj – Jo, jo...!

Eduard Halimi – Formula që pranon Partia Demokratike dhe opozita, se nuk është zoti Mediu, është formula e propozuar...

Fatmir Xhafaj – Po si?

Eduard Halimi – ...nga ekspertët me *reserved seats*, atë që shpjegoi zoti Bylykbashi.

Fatmir Xhafaj – Që do të thotë?

Eduard Halimi – Pra, me vende të rezervuara, siç...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Na e sqaroni, na e bëni më të thjeshtë: janë pesë vetë, një do të zgjidhet me tre të pestat, tha zoti Bylykbashi; dy nga maxhoranca, dy nga opozita. Nga dhe si? Vetëm kaq, si ta kuptojnë kolegët, se jo të gjithë janë të familjarizuar me këtë dokument.

Eduard Halimi – Komisioni i Venecias në kapitullin “B”, që ka të bëjë me zgjedhjen e organeve të përhershme, që sigurojnë pavarësinë dhe llogaridhënien e gjyqësorit, e ka rekomanduar zgjedhjen e këtyre organeve jo me tre të pestat, as me dy të tretat, por nëpërmjet formulave që mund të gjenden, si në paragrafët 15, 16, 17 dhe në *footnote*-in të cilin e ka me numër 2, 3, 4 dhe 5.

Ky model është i pranuar prej nesh, nuk është propozuar nga ne. Po jua them edhe një herë, nuk ka model të propozuar nga Partia Demokratike për këtë çështje. Prandaj e thashë edhe në mëngjes kur kishte persona të tjerë në mbledhje, për të thënë që këto dy formula, njëri prej të cilave e ka zgjedhur Partia Demokratike, janë sjellë nga partnerët ndërkombëtarë, që ka të bëjë me *reserved seats*, me vende të rezervuara.

Mënyrën sesi do të implementohet formula e përzgjedhur, në qoftë se do të jeni edhe ju dakord me formulën *reserved seats*, le t’ua lëmë ekspertëve të Partisë Demokratike dhe interlokutorëve që, për fatin e mirë, të dy zotërinjtë e nderuar, edhe zoti

Rainer, sidomos zoti Smibert, na i kanë prezantuar modelet, të punojnë bashkë me ekspertët tanë për implementimin e formulës së propozuar prej tyre, që është formula e *reserved seats*.

Në mbledhjen e ardhshme, javën tjetër, të shohim për të diskutuar në qoftë se do të kemi këtë formulë apo një formulë tjetër, të cilën na e kanë përcjellë edhe ne, që është propozimi juaj, pra i Partisë Socialiste.

Fatmir Xhafaj – Po për këto të tjerat?

Eduard Halimi – Për çështjen e këtyre të tjerave, për çështjen e Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, po e përsëris, por e thashë dhe besoj që isha i qartë, problemi që kemi ne është çështja nëse do të jetë ky mekanizëm ose jo...

Domethënë, a do të kemi këtë mekanizëm, ILD-në, siç e kemi kështu, apo do të gjejmë një mekanizëm tjetër dhe të mos kthehemi? Pra, në këtë pikë ne nuk kemi ndoshta dakordësi, të paktën nga ana jonë, për këtë mekanizëm siç është.

Nuk kemi dakordësi sot, ndaj i ftova ekspertët e huaj, që bashkë me ekspertët tanë të shohin dhe të elaborojnë edhe ndonjë mekanizëm tjetër për ta bërë më eficient dhe për t'i shmangur komponentët që kanë të bëjnë me korporatizmin dhe pjesën e llogaridhënies.

Nëse nuk do të gjendet model tjetër, po them javën tjetër, do të na vijë një shkresë: nuk ka, ky bullgari është më eficienti nga të gjithë. Atëherë, do të shohim komponentët e tjerë që i thatë edhe ju: do të lëmë vetëm njërin...

Fatmir Xhafaj – Dakord, dakord, emërimi; bëhet fjalë për këtë rast.

Eduard Halimi – Atëherë, po them: në qoftë se kalojmë te kjo që nuk gjejmë model tjetër, do të jemi pikërisht te ky mekanizëm, javën e ardhshme ne do të shohim edhe...

Fatmir Xhafaj – Po prokurori i Përgjithshëm.

Eduard Halimi – Do të shohim, se ndoshta nuk duhet të ketë një, të mos ia varim me të drejtë vetëm njërit, mund ta kemi të tërën. Kur i jep tre, atëherë vijmë përsëri te formulat e tjera.

Për çështjen e prokurorit të Përgjithshëm të ri, të elaborohet formula e propozuar nga Komisioni i Venecias, atë që ka...

Fatmir Xhafaj – Pse ka disa, thatë ju?

Eduard Halimi – Për prokurorin e Përgjithshëm?

Fatmir Xhafaj – Jo, për disa, 1, 2, 3, 4, 5 renditët ju, pavarësisht sa unë nuk kaloj...

Eduard Halimi – E ka të përcaktuar Komisioni i Venecias.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Cili?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord.

Eduard Halimi – Do të flasësh...?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Të mbarojë...

Eduard Halimi – ... *(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Për pjesën e prokurorit të Përgjithshëm (në mos gaboj, se nuk po ftillohem), Komisioni i Venecias thotë që të parashikohet me dispozitë tranzitore dhe në rast se ka të bëjë me këtë shumicë, atëherë të shikohet, një shumicë tjetër dhe të ...

Fatmir Xhafaj - Cila pikë është?

Eduard Halimi - Do t'jua them pak më vonë, sa të konsultohem.

Silva Caka - Do të bëj një ndërhyrje shumë të shkurtër, në lidhje me një formulë, e cila mbase është propozuar tashmë nga anëtari i përhershëm i këtij komisioni, kështu që ju kërkoi ndjesë, në rast se jam duke e ripërsëritur.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull. LSI-ja ka një formulë të menduar deri diku dhe unë mendoj që ta shpreh. Ne kemi menduar që emërimi i anëtarëve jo gjyqtarë ose jo prokurorë të Këshillit të Lartë të Prokurorëve të ulet si numër, nga 11 në 9, pra së pari është çështja e uljes së numrit, në mënyrë që 4 anëtarët që do të vijnë jo nga sistemi i gjyqtarëve dhe prokurorëve, të mos përbëjnë problem për mënyrën si do të zgjidhen dhe më konkretisht, do të ndaheshin në 5 dhe në 4, pra 5 anëtarë të KLGJ-së dhe KLP-së të propozohet të vijnë nga vetë sistemi dhe 4 anëtarët propozohet të vijnë jo nga sistemi, por nga parlamenti.

Në këtë mënyrë ne përmbushim edhe kërkesën e Komisionit të Venecias për *reserve seats*, pra 2 anëtarë nga opozita dhe 2 anëtarë nga maxhoranca.

Sigurisht, nuk i kemi konsideruar këta 4 anëtarë si militantë partie apo si njerëz që janë thjesht edhe anëtarë partie, por si profesionistë, të cilët do t'u qëndrojnë shumë strikt parimeve të tyre. Kjo është propozuar nga ne, edhe për të arritur një konsensus nga kolegët e opozitës në këtë komision.

Sa i përket këshillit të emërimeve, mbetem vetëm me propozimin e kësaj formule, pra uljen e numrit të anëtarëve nga 11 anëtarë, në 9 anëtarë (5+4) dhe që katër anëtarët do të zgjidhen 2 nga opozita dhe 2 nga maxhoranca.

Kjo ishte ideja ime.

Faleminderit!

Pandeli Majko – Të them të drejtën, unë kam një problem me këtë që po diskutohet këtu. Të biem dakord që në fillim: nëse do të bëjmë ndryshime në Kushtetutë, të bëjmë ndryshime në Kushtetutë.

Nëse do të bëjmë një draft për marrëveshjen politike si do ta qeverisim të dyja palët (pozitë dhe opozitë), sistemin e drejtësisë, është një çështje tjetër. Me qëllim që të mos futemi në librat e jurisprudencës shqiptare dhe të na tregojnë me gisht. Për më shumë, edhe një herë dua t'ju them që kjo mënyrë diskutimi, me *reserve seats* do të hapë një çështje, e cila do të ketë të bëjë me rotacionin politik.

Çfarë kuptimi do të ketë *reserve seats*?

Cila do të quhet opozitë? Cilat do të jenë të drejtat e partive parlamentare opozitare në këtë drejtim? Si do të jetë ky përfaqësim? Çfarë do të quhet maxhorancë? Kush do ta ketë të drejtën nga maxhoranca? Kjo do të na hapë një varg diskutimesh, të cilat në thelb nuk janë kushtetuese, por janë politike.

Nëse do të marrim përsipër t'i zgjidhim këto kundërshti, këto mënyra të çuditshme të të parit të këtij problemi në mënyrë politike, ky nuk mund të jetë diskutim për ndryshime në Kushtetutë. Pra, nëse do të diskutojmë tani, se si do t'i ndajmë thelat e vendeve në Këshillin e Lartë Gjyqësor, mendoj se ne jemi pjesë e natyrshme e asaj që sot quhet korporatë në sistemin e drejtësisë.

Ana tjetër e problemit: shikoni sa në kontradiktë me sistemin është shkruar këtu, sa në kontradiktë jemi me këtë mënyrë diskutimi. Në pikën 5, nëse në një moment krize politike edhe këto *reserve seats*, nuk e plotësojnë një shumicë të caktuar, do të emërohet automatikisht ai që e ka radhën sipas grupit ku do të bëhet rankimi.

Ne në thelb jemi në kontradiktë me interesat politike nga njëra anë, dhe me rankimin e gjyqtarëve nga ana tjetër. Këtu mendoj se nuk dalim me diskutim në këtë sallë, por dalim te bregu i detit me rroba banje, sepse e tregojmë qartë, që interesat tona politike në këtë reformë, në çdo rast prevalojnë dhe diskutimi, natyrshëm nuk është më kushtetues, nuk është më për këtë draft.

Unë do të thosha, por kjo që do të them nuk ka të bëjë, më me draftin, në të dyja rastet si pozitës, si opozitës, u duhet të ulen në tryezën e bisedimeve politike, por jo me ekspertët ndërkombëtarë, për t'u kërkuar ndonjë formulë të çuditshme dhe për fazën e parë, kur do të konturohet i gjithë sistemi nga fillimi deri në fund, të dyja palët duhet të ulen dhe të jenë të qarta që do të ketë paritet për atë që do të votojnë, por kjo zgjidhet me marrëveshje politike dhe nuk zgjidhet me të shkruar në faqet e Kushtetutës së RSH-së, se do të jemi për turp pastaj.

Po i rikthehem edhe një herë: *reserve seats* do të hapë një histori të çuditshme. Këtu u tha me të drejtë se është më mirë ta ulim numrin nga 11 në 9, me qëllim që edhe numri 4 që do të diskutohet në parlament, t'i përshtatet deridiku formës gjeopolitike të parlamentit. Dakord, por ajo që unë kam vështirësi në mënyrën e të diskutuarit, është se ne tani duhet ta ndajmë historinë. A do të diskutojmë marrëveshje politike apo do të diskutojmë Kushtetutën?

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Atëherë, shumë e saktë. Për marrëveshje politike, i thoni kryetarit tuaj të ulet me kryetarin tim, që të merren vesh dhe mos më sillni mua këtu shpikje juridike për t'u gajatur nga të tjerët!

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Të lutem, unë po jap këtu opinionin tim dhe po e ripërsëris për ekspertët ndërkombëtarë, sepse ekspertët ndërkombëtarë ndodhen edhe përballë kërkesave tona të çuditshme: "Si do të shprehem unë? Ku do të zë vend unë? Sa të përfaqësuar do të jemi ne, e kështu me radhë. *Reserve seats*...

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Po dëgjojeni një herë dhe ta shikojmë dhe ta diskutojmë!

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Arsyetim politik.

Ju lutem, kolegë!

Arsyetimi politik, i shkruar në Kushtetutë nuk lejohet, sepse ai ka të bëjë me një moment të caktuar, në një kohë të caktuar, që ndryshon natyrshëm çdo 4 vjet apo çdo 8 vjet, si do të doni.

Për këtë arsye do të gjykoja që historia e *reserve seats* të shikohet me numrin e deputetëve, që kanë të drejtë ta propozojnë kandidatin dhe që natyrshëm pastaj do të sjellë natyrshëm balancimin e brendshëm të parlamentit midis maxhorancës dhe opozitës. Po e përsëris edhe një herë faktin, që ne duhet të ulemi edhe një herë, sidomos për fazën e parë të fillimit të veprimit të reformës dhe ky nuk është diskutim kushtetues, por është diskutim politik, prandaj të mos ta kontraktojmë bisedën me formula politike, që nuk kanë të bëjnë me të shkruarën e Kushtetutës.

Fatmir Xhafaj – Fjalën e ka zoti Strazimiri!

Gent Strazimiri - Faleminderit, zoti kryetar!

Ka një vit që themi se kjo është çështje dhe përgjegjësi e një marrëveshjeje politike, të biem dakord dhe të vendosim disa rregulla, ndërsa ju thoni se kjo është punë e ekspertëve dhe se politika nuk ka punë në këtë histori.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Një minutë!

Tani kemi 1 vit, që themi se do ta marrim ne përgjegjësinë, se politika votohet dhe del para sovranit dhe ajo e ka sovranitetin e deleguar prej tij, ndërsa ju thoni “Jo”, se kjo është punë e ekspertëve dhe do ta bëjnë ekspertët.

Ja ku u ulëm tani dhe Pandi po thotë: “Hajde të bëjmë marrëveshje!” Kushtetuta është marrëveshje. Atë e votojnë politikanët dhe sigurisht, ka një komponent shumë të rëndësishëm të marrëveshjes politike brenda në të, të konvertuar në koncepte juridike. Këtu nuk kemi paraqitur asnjë formulë.

Zoti Halimi jua lexoi dy herë. Ka ardhur me ferman nga Komisioni i Venecias.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Jo ferman, por jemi brenda kornizës së Venecias. Ky nuk është as produkt i Halimit, as i Strazimit, as i Vasilikës, as i Silvës, por është një opsion zgjidhjeje për të cilin mund të mos biem dakord, por nuk ka arsye të nxehe mi në debat. Kjo është një formulë, e cila mund të mos të na kënaqë, mund të gjejmë 4-5 të tjera, por nuk ka

ndodhur asgjë që nuk është brenda materialit të propozuar nga Komisioni i Venecias. Marrëveshjet politike, veçanërisht në situatën e 2-3 vjetëve të fundit, eksperiencia ka treguar, që krahu u pushtetit nuk i ka respektuar. Ajo është një gjë që griset, ama një marrëveshje që griset, që siç e tha zoti Halimi në fillim të fjalës së tij: për të projektuar një arkitekturë që do të zgjasë disa dhjetëra vjet, vendi i duhur për ta shkruar është në Kushtetutë dhe ne këtë po bëjmë.

Nuk ka nevojë të zgjatemi.

Zonja Caka bëri një propozim. Zoti Halimi avancoi një propozim tjetër nga Komisioni i Venecias. Le t'i diskutojnë të tjerët, sepse ata mund të na japin një mendje edhe më të mirë. Nuk ka arsye të shqetësojmë Kryeministrin në Uashington, se është herët atje. Kjo nuk shkon.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Je proamerikani më i madh në këtë tryezë.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Janë të njohura, të ekspozuara.

Fjalën e ka zonja Hysi!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë e kuptoj që për këtë pikë Komisioni i Venecias ka thënë që është më shumë një çështje politike, sesa një çështje ligjore.

Nga ana tjetër, unë ndihem e shqetësuar që kërkohet të politizohet pjesa e jo gjyqtarëve. Më lejoni të flas haptas, me sinqeritet, sikur të mos isha pjesë e politikës, por e jetës akademike nga ku kam ardhur.

Ne kemi futur disa masa apo kemi hedhur disa hapa për ta bërë ekzekutivin e gjyqësorit sa më pluralist dhe sa më profesional.

Hapi i parë është vetingu.

Hapi i dytë është pluralizmi, që vjen nga institucione të ndryshme.

Hapi i tretë është procesi i nominimit, që është shumë i rëndësishëm dhe këtu duhet të bëjmë kujdes që të jetë një proces i hapur, një proces transparent, por po aq rëndësi, ka edhe metoda e zgjedhjes. Kur vijmë te metoda e zgjedhjes, fakti që e kërkojmë, pavarësisht se Komisioni i Venecias ka sjellë katër opsione, por ne në Shqipëri kemi shumë qejf që pavarësisht se një person mund të vijë nga universiteti, nga

avokatia apo nga institucionet e tjera, sapo ta propozojë një nga forcat politike, ne menjëherë e politizojmë atë dhe e bëjmë menjëherë pis. Përvoja e ekspertëve të nivelit të lartë, që u ftuan për të bërë punën në reformën në drejtësi, e tregoi këtë gjë. Ashtu siç pak më parë ne përmendëm edhe Avokatin e Popullit, që megjithëse është përzgjedhur nëpërmjet një procesi transparent, qenka i majtë. Në këtë kuadër...

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Më falni! Kur folët ju, unë ju dëgjova.

Në këtë kuadër, përpjekjet për të vënë shenjë barazimi se cila forcë politike e propozon një kandidat, pavarësisht se ai nuk ka të bëjë fare me politikën, por për hir të rregullit që dikë ta propozojë maxhoranca dhe dikë ta propozojë opozita, më vjen shumë keq që shumë shpejt do të vijmë në parlament dhe do të diskutojmë që këta njerëz janë të politizuar, që këto institucione që ne krijuam, janë të politizuara etj. Ndaj kam një merak dhe po jua them këtë, sepse me gjithë këtë politizim dhe të bërit politikë me këdo në këtë shoqëri nga ky parlament, do të kemi vështirësi për të gjetur kandidatura që të jenë profesionale dhe vetëm për faktin se do t'i propozojë një maxhorancë apo një opozitë, do të hezitojnë të bëhen pjesë e këtij procesi. Për këtë arsye duhet të jemi pak më të kujdesshëm dhe të qëndrojmë sa më larg. Më besoni, për këtë, se po flas me sinqeritet! Kaq shumë pis sa i bëjmë njerëzit në këtë shoqëri, nuk do të dojë ndonjë njeri që ka vite karrierë, që ka një punë të mirë, pa kokëçarje, nuk do t'i hyj të gjithë këtyre proceseve, vetingut apo ku ta di unë, e të lërë atë punë dhe të bëhet pjesë e këtyre strukturave aq më shumë, kur ne kërkojmë që këto kandidatura t'i propozojnë forcat politike.

Unë nuk e di se si ekspertët, sidomos këtë kërkesë e kam për ekspertët e huaj, mund ta kapërcejnë këtë gjë, me qëllim që t'i ruajmë njerëzit profesionistë. Ata do të punojnë për një periudhë kohe në këto institucione, por pasi të mbarojë ajo periudhë, ata do të kthehen nëpër institucionet e tyre.

Nuk do të doja dhe e mendoj si për veten time, që nesër të më thonë se kjo është e djathtë apo ajo tjetra është e majtë. Jo, shkon një detyrë, i nënshtrohet një procesi të hapur dhe transparent për shkak të meritës dhe nëse e kalon procesin e pastërtisë dhe gjithçka tjetër, por jo pse e ka propozuar një forcë politike, apo një forcë tjetër. Në këtë mënyrë ne do të shkatërrojmë elitat në shoqërinë tonë dhe do t'i bëjmë të gjithë njerëzit

të politizuar. Unë e kam merak këtë. Po të flisni me shumë profesionistë jashtë politikës, e kanë këtë merak.

Fatmir Xhafaj – Ka ndonjë gjë tjetër?

Eduard Halimi – Proceduralisht, do të doja të dëgjoja propozimin tuaj për këtë zgjidhje dhe pastaj, të shprehemi edhe ne.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Kjo është realisht një çështje që kërkon një debat sa politik, aq edhe kushtetues. Politik, sepse kërkohet të ketë një vullnet politik për zgjedhjen e një formule sa më të përshtatshme.

Kushtetues, sepse po flasim për formatimin e institucioneve të reja, të përhershme kushtetuese. Unë jam shumë dakord dhe më duhet ta pranoj arsyetimin e bërë në opinionin e Komisionit të Venecias, i cili duke sqaruar qartë pozicionin e tij, lidhur me 2/3 dhe me 3/5, në finale është shprehur se të dyja këto shumica të cilësuar, janë ligjshme dhe metoda e zgjedhjes, që propozohet nga këto projekt-ndryshime, pra nga projekti (shumica prej 3/5), është në parim një zgjidhje e pranueshme.

Nga ana tjetër, ajo që është thelbësore për Komisionin e Venecias, që përbën vijën e kuqe, sipas mendimit tim, dhe që duhet ta respektojmë fort, është kërkesa që në lidhje me anëtarët jo gjyqtarë, procesi i nominimit, i kandidimit të tyre, është po aq i rëndësishëm, sa edhe metoda e zgjedhjes së tyre. Distanca e tyre nga politika, mund të sigurohet nëpërmjet një procesi të hapur dhe transparent nominimi, me nismën e organeve të pavarura, pra nga mënyra si janë propozuar të formatohen. Kjo do të përfundohet nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, thotë Komisioni i Venecias.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Kështu thotë Komisioni i Venecias. Më pas, ju mund të keni ndonjë opinion tjetër, por tani po flasim për këtë.

“Ky proces nominimi duhet të bëjë të mundur që parlamenti të detyrohet të bëjë një përzgjedhje mes kandidatëve më të kualifikuar dhe jo, të emëruarve politikë.”

Tani miqtë e mi, kur kemi hyrë në këtë reformë, një gjë ka qenë absolutisht shtysa më e fortë: kapja politike e sistemit. Pra, vendosja e sistemit nën shërbimin e politikës. Nëse ka një gjë ku duhet të tregohemi shumë të kujdesshëm është që të mos e nxjerrim politikën nga dritarja dhe ta futim nga dera. Propozimi “me vende të rezervuara”

që bëhet nuk është asgjë veçse kontrolli politik mbi sistemin, pra atë që bën politika në parlament të transferojmë në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe në Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Përfytyroni si është ndërtuar, domethënë si është projekti, do të vijë nga radhët e avokatisë apo nga radhët e pedagogjisë, nga profesorati etj? Përfytyroni një profesor të nderuar që vendos të kandidojë, i cili vjen me dëshirën të kontribuojë që gjyqësori dhe prokuroria të jenë të pavarura, eficiente dhe në shërbim të qytetarëve. Pra, ai vjen si profesionist dhe del i ngarkuar politikisht. Vjen me kostumin e profesionistit dhe del me kostumin e PS-së, të LSI-së, të PD-së. Pra, për ta thënë shkurt, me tre të pestat e kap Edi Rama, por me vende të rezervuara dy i ka Lulzim Basha dhe dy Edi Rama.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Edhe Meta, dakord, se dashuria juaj për zotin Meta është spektakolare. Mua më shqetëson fakti se ne po kërkojmë, e para të futim përfaqësuesit e partisë dhe profesionistët e pavarur t'i kthejmë në profesionistë të varur me kostum partiak dhe me shenjë dalluese; së dyti, po kërkojmë që betejën, shpeshherë për gjyqësorin, e cila do të jetë shumë me e fortë me ndryshimet e reja, sepse nuk do të jetë gjyqësori që kemi sot, i cili fle gjumë mbi dosjet e korrupsionit, por do të jetë gjyqësori që do t'i japë zgjidhje pandëshkueshmërisë në sistem dhe reagimi i politikës do të jetë shumë më i fortë, të transferohet në përbërje të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë; e treta, të mos harrojmë që nga radhët e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, nga radhët e atyre që nuk janë gjyqtarë, përzgjidhen kryetarët e këshillave. Përfytyroni që njëri prej tyre të mund të ketë stemën e PS-së dhe tjetri stemën e PD-së. Kryetari i këshillit do të jetë me stemë partiake. Edhe kjo është e papranueshme. Të gjitha këto e bëjnë sistemin shumë më të politizuar se është sot. Prandaj në çfarëdo versioni, unë jua kam thënë që në fillim, kur i kam parë këto modele, ne jemi kundër kapjes së sistemit nga simbolet partiake. Kjo është absolutisht e papranueshme. Le të gjejmë çdo formulë tjetër, por këta njerëz nuk duhet të kenë kostume partiake dhe duhet të përfaqësojnë realisht institucionet, grupet e interesit nga vijnë, por jo partitë politike. Kjo është një gjë shumë parimore. Nuk do ta pranonte asnjë qytetar i këtij vendi një reformë të tillë, sepse institucionet, që i takojnë atij, ne i vëmë në kontroll dhe në ndikim të partive politike.

Natyrisht, kjo është një çështje shumë e debatueshme edhe për arsye se modele të tilla, për shembull modeli ‘i vendit të rezervuar’, i gjen me gishtat e njerëz dorë dhe jo me dy. Madje, janë vetëm dy modele. Të tillë e kanë kroatët, por ata e kanë të pastër fare; një deputet nga maxhoranca dhe një nga opozita, që është ekstrem fare. Por, siç ka thënë edhe Komisioni Venecias, ky është një model i cili nuk është testuar në “Venecia”. Kur të testohet, mbase... Për kushtet tona, që e kemi problem këtë çështje dhe që është burimi i situatës negative që kemi sot në sistem, kjo është një gjë e papranueshme, të cilën besoj se nuk do ta pranonin qytetarët e këtij vendi. Atëherë, cila është zgjidhja?! Ne jemi dakord për çdo formulë që e përfshin parlamentin aktivisht, pra që përfshin edhe opozitën, edhe maxhorancën në procesin e përzgjedhjes, pra të gjitha grupet, jo në zgjedhje, në emërimin e përfaqësuesve, por në procesin e përzgjedhjes, me metoda votimi të cilat i mundësojnë realisht shumicës dhe opozitës që askush të mos dominojë procesin e përzgjedhjes, por të jetë pjesë e vullnetit të brendshëm të legjislatorit. Të 140 deputetët, përmes një votimi të fshehtë, të kenë të mundur lirinë e zgjedhjes së kandidaturave, natyrisht, pa vullnet të përcaktuar për X-in apo për Y-in. Jemi te hapur? A biem dakord? Po të jetë e nevojshme, po ju them një gjë që është ekstreme, të cilën nuk do ta sugjeroja, por, sa t’u veshim ne kostum partiak, më mirë ata nga avokatia dhe nga mësimdhënia të shkojnë direkt atje dhe të mos vijnë fare në parlament, se të vijnë në parlament dhe nga profesorë të bëhen anëtarë partie.

Eduard Halimi – Cili është propozimi juaj?

Fatmir Xhafaj – Po marr një shembull, por marr rastin që vijnë nga avokatia. Pra, propozimi ynë është: pra avokatia i propozon Kuvendit 5 anëtarë për dy vende (mund t’i bëjnë bashkë avokatia, noteria) dhe ia sjellin Kuvendit...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kandidaturat në çdo rast do të vijnë nga profesionistët. E zgjedhin ata dhe sjellin 5 kandidatura.

(Diskutime pa mikrofon.)

Nëse në çdo gjë ju shikoni një kapje, ky nuk është problemi ynë, por juaji. Deri tani kishim dëgjuar se do ta kapte Rama, kurse tani është versioni Rama-Basha.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem, a doni të dëgjoni?! Pra, hapi i parë është vetë avokatia. Po marrim shembullin e avokatisë, se është më konkrete, e cila i zgjedh kandidatët sipas një procesi përzgjedhës të brendshëm, që do të jetë në ligjin përkatës, duke pasur në konsideratë të gjitha ato që thotë “Venecia”, si transparencën, kriteret, thirrjen publike etj.

Hapi i dytë: Këshilli i Emërimeve në Drejtësi bën direkt plotësimin e kushteve, përputhshmërinë dhe verifikimin e kushteve, pra nëse i plotësojnë kushtet sipas ligjit dhe Kushtetutës apo jo.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pra, do të dorëzojnë pesë kandidatura për dy vende. Do të shikohet nëse ndonjëri prej tyre i plotëson kriteret kushtetuese dhe ligjore, pa i hyrë meritës, dhe do të thuhet: katër i plotësojnë, kurse një kthehet dhe i thuhet avokatisë të sjellë edhe një tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po flas për kushtet formale. Për shembull, nëse i plotëson 10 vjet apo nuk i plotëson, nëse është apo nuk është jurist me diplomë, nëse është doktor i shkencave apo nuk është, nëse ka master apo jo. Këtë lloj seleksionimi mund ta bëjë direkt Komisioni i Ligjeve.

Këtu kemi një propozim tjetër që, sipas njërit prej modeleve që është dhënë aty, Komisioni i Ligjeve mund të bëjë seleksionimin, nga pesë në tre kandidatura, në mënyrë që ta ngushtojë rrethin, duke u dhënë mundësinë të dyja krahëve të heqin nga një, por pa përcaktuar publikisht se kë hequr njëra apo tjetra. Këshillit të Emërimeve në Drejtësi mund t’i japim të drejtën, siç thotë edhe “Venecia”, të bëjë një rankim të atyre që mbeten, pra mbeten 1, 2, 3, të cilët do të kalojnë në votimin në parlament, ku mund të votohet ose me shumicë të cilësuar ose me një prej modeleve që kanë ofruar ndërkombëtarët, e cila nuk i krijon mundësinë as një trupe të vetme të llojëve të një zgjedhje. Për shembull, me një prej sistemeve vota e vetme e transferueshme, ose siç thuhet deputeti ka tri vota...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk ke si të lobosh, se nuk lobohen 140, kurse me metodën, që kërkoni ju, lobohen kryetarët e partive. Me këtë metodë i bie që ta lësh në vullnetin e 140 vetave. Votojnë me votë të fshehtë dhe i japin mundësi edhe opozitës, edhe maxhorancës të përfshihen dhe të ketë një kuorum.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zgjedhim një prej modeleve të dhëna. Janë disa formula aplikimi ku votohet dhe dalin pa përcaktuar se cili është i preferuari i njëres palë apo i tjetres. Ky lloj votimi mund të bëjë që për një kandidat të caktuar të ketë vota edhe majtas, edhe djathtas. Në përfundim të procesit ai nuk del as si i PS-së, as si i LSI-së dhe as i PD-së, por del si i dominuar nga parlamenti përmes një vote të fshehtë të tij. Çfarë siguron kjo?! E para kjo siguron që këto kandidatura të vijnë nga një proces nominimi profesional i profesionistëve dhe jo i praktikëve. Janë të gjithë profesionistë.

Së dyti, përfshin në këtë proces votimin në kushte të njëjta si për maxhorancën, edhe për opozitën, ose, thënë më shkurt, lejon të ketë aleanca të brendshme për shkak të pëlqimit për profesionistin.

Së treti, profesionistët që dalin nuk kanë ngjyrim të caktuar, por janë produkte të një votimi të brendshëm parlamentar. Kjo është një formulë që propozojmë ne dhe mund t'ju jap më konkretisht më shkrim.

Gjithsesi, kam tri çështje për zotërinjtë e ekspertizës që do të merren me këtë problem:

E para, Komisioni i Venecias në paragrafin 16 të opinionit të tij ka theksuar se procesi i nominimit është aq i rëndësishëm sa ai i zgjedhjes dhe i emërimit të tyre, a mendoni ju se është e mundur të gjenden formula zgjedhjeje që sigurojnë cilësitë profesionale të kandidatëve, qoftë edhe duke përjashtuar formulat me prag të lartë, sipas paragrafit 15 të opinionit?

Së dyti, sipas opinionit të Komisionit të Venecias, formulat profesionale të votimit nuk janë të aplikueshme për organet individuale, por vetëm për ato kolegjiale, a mendoni se parashikimi i formulave të ndryshme për zgjedhjen e organeve kushtetuese, kolektive dhe individuale, do të ishte në përputhje me frymën që ka dhe do të ketë Kushtetuta, e cila duhet marrë në konsideratë dhe duhet zbatuar, në vlerësimin tim, si një dokument unik dhe në koherencë me të gjitha parashikimet e saj? Pra, si do ta zgjidhim konfliktin që krijohet ndërmjet dy formulave për organe të së njëjtës natyrë që emëron Kushtetuta?

Së treti, sipas pikës 39 të opinionit final të Komisionit të Venecias, sugjerohet që tre anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, që zgjidhen me shumicë të cilësuar nga Kuvendi, ndërkohë që tre zgjidhen nga Presidenti, i cili vetë zgjidhet me shumicë të thjeshtë, a

mendoni se një formulë e tillë do të krijonte pabarazi midis anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, duke vendosur një prag shumë të lartë për tre prej tyre, në krahasim me tre anëtarë? Pra, do të kishim tre anëtarë, të cilët zgjidhen nga parlamenti me tre të pestat apo me dy të tretat dhe nga ana tjetër do të kishim tre anëtarë që zgjidhen nga Presidenti, i cili zgjidhet nga një forcë politike dhe me 71 vota. Ky është qëndrimi ynë për propozimin që u bë. Çështjet që ngremë do të trajtohen në vijim lidhur me debatin që është hapur.

Eduard Halimi – Në fakt, që në fillim të diskutimit të metodologjisë dhe të çështjeve politike (nuk po i hyj debatit që kjo tryezë duhej mbajtur më parë, se refuzonim të uleshim për të diskutuar) është kërkuar vazhdimisht që çështja e zgjedhjes së anëtarëve të KLGJ-së dhe KLP-së të ishte në fund; është insistuar në fakt. Unë e mirëkuptoj dhe e kam mirëkuptuar maxhorancën në këtë pikë, madje edhe për tonin shumë të ngritur gjatë këtyre katër orëve. E kam fjalën për tani, se pak më parë toni ishte shumë i qetë. Diskutuam shumë profesionalisht, diskutuam për të mirën e sistemit, pra si ta bëjmë atë më të mirë, si ta zgjidhim problemin e korrupsionit, të vetingut, si të zgjidhim problemin e byrosë, por, kur erdhëm te kjo pikë, prandaj edhe e kishit lënë në fund, tonet u ngritën shumë dhe u mbajt një qëndrim tepër politik, sepse deri tani nuk ishte mbajtur. Kjo është e kuptueshme, në rast se zbulon tërësisht pjesën e debatit që ekziston në publik, i cili duhet ta dijë pse e bëtë vetëm ju dhe nuk na pritet edhe ne që ta shkruanim bashkë draftin e amendamenteve kushtetuese, por ishte problemi që, në qoftë se do ta kishim diskutuar bashkë këtë gjë në shtator, vërtet mendonit ju që do t'ju thoshim: po, të pestë anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të KPK-së duhet t'i emëronte Edi Rama?! Kjo gjë nuk do të ndodhte. Ju e dinit këtë gjë. Ky është thelbi pse ju ecët vetëm me drafte që në fillim. Ne ju thamë të prisnit ta bënim draftin bashkë, por ju ecët vetëm. Madje, edhe kur do t'ia dërgonit Komisionit të Venecias, ju thamë të mos e dërgonit që ta shihnim edhe një herë bashkë se do të ktheheshim përsëri këtu dhe kthehemi përsëri këtu. Sigurisht që tonet nxehen, sepse e “Venecia” e ka prerë shkurt këtë gjë. Ne për “Venecian” kemi gjë. “Venecia” na e ka prerë shkurt: “Nuk mundësi që ju të emëroni me 3/5-at”. Pra maxhoranca të emërojë anëtarët e Këshillit Gjyqësor, Këshillit të Prokurorisë që janë institucione, të cilat do të jenë për një kohë të gjatë. E ka ndarë, harrojeni, ka thënë. Sigurisht që tonët fillojnë dhe nxehen kur diskutohet kjo pjesë.

Në fakt, sot në këtë diskutim ne jemi komodë, për fatin tonë është Komisioni i Venecias, sepse po të mos ishte Komisioni i Venecias. Prandaj edhe unë sa herë më thonë: prisni do ta diskutojmë në fund, në rregull, në fund; prisni do ta diskutojmë në fillim, mirë, në fillim. Edhe kur jam takuar pa pranin tuaj, por në praninë e ndërkombëtare kam qenë dakord që ta diskutojmë kështu. Pse ? Se u përmbahem parimeve. Sado që duam të dukemi shkencëtarë, njerëz shumë të mençur, super shkencëtarë dhe super parimorë, duam apo nuk duam ne, me gjithë modestin, Komisioni i Venecias, është më ekspert se ne. E kanë, nuk kemi çfarë t'i bëjmë.

Komisioni i Venecias ka thënë: jo, nuk ka 3/5-at, as 2/3-at dhe as pjesë tjetër. Këto janë institucione të përhershme. Pa dyshim se këto duhet të jenë pjesë e një marrëveshjeje politike, sepse Kushtetuta është marrëveshje politike, e tha dhe zoti Strazimiri, e kemi thënë në kaq kohë. Pra, është marrëveshje politike. Ka vetëm një skenar nuk ka plan: “b”, “c”, “d”, “dh”, e, “g”. Ndërtimi i institucioneve të përhershme, duhet të bëhet me një marrëveshje politike. Cila mund të jetë kjo marrëveshje politike për zgjedhjen e organeve të reja? T'i zgjedhë Rama, t'i zgjedhë Basha, t'i zgjedhë Meta. Jo, nuk jam fare për atë.

Tani, para se të dilte opinionimi i “Venecias”, opinionimi final, pati propozime për dy modele. Modeli ishte ai i *reserved seat*, ai model që u propozua. Ka dëshmitarë në këtë proces që nuk e ka propozuar Partia Demokratike, as Lulëzim Basha dhe as nga anëtarët e komisionit këtu. Modeli që ka të bëjë me vendet e rezervuara është thënë edhe në faqen 6 të raportit të Komisionit të Venecias.

Një tjetër model i zgjedhjes ka të bëjë me krijimin e dy listave alternative të kandidatëve nga koalicioni qeverisës dhe një tjetër nga opozita. Këshilli i Emërimeve do të rendisë kandidatët dhe do të dërgohen të dyja listat në parlament, i cili do të zgjedh tre kandidatët: dy nga lista e shumicës dhe një nga lista e opozitës. Po mirë, këta të “Venecias” duan që ta kapin ne tani? Kanë luajtur mendsh këta të Komisionit të Venecias që duan t'i ndajnë, duan ta shndërrojnë Shqipërinë në Pazar, ndërsa ne qenkemi më parimorë se Komisioni i Venecias? Se mos këta po na fusin në qorrsokak, po na vijnë me lista dhe po na marrkan më qafë. Dua ta kursej, sepse e kurseva gjatë gjithë këtyre 4 orëve edhe ironinë, edhe pse u përdor, dhe nuk dua ta vazhdoj me pjesën ironike, sepse e kemi të gjithë talent, nuk na mungon. Ky është propozim i tyre. Është zgjidhje që e ka

dhënë Komisioni i Venecias, siç ka dhënë dhe zgjidhje të tjera. Absolutisht. Edhe ky propozimi që thotë zoti Xhafaj ekziston, edhe propozimi që thonë për modelet e vendeve të rezervuara, është modeli kroat. Por ne kemi kaq kohë që themi për reformën se është modeli kroat. Unë jo pa qëllim e shënova atë që u tha: se modeli kroat është i papranueshëm. Pse qenka i papranueshëm?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Personalisht unë, me ndërgjegjen time, jam kundër atij modeli, jam kundër modelit ku duhet të ketë deputetë në këshill, po them siç e ka Kroacia. Por ju keni kaq kohë që thoni: modeli kroat. Gjithsesi, është një model, siç është dhe modeli i ILD-së, që modeli bullgar, siç është dhe modeli serb i testimit. Nuk ka asgjë të keqe, në të gjitha këto modele. Ata testojnë modelet europiane janë të konsoliduara në Gjermani, në Francë. Për fatin e mirë të tyre ata nuk kanë problemet që kemi ne. E vërtetë është. Neve na një duhet reformim më i thellë, se ç'mund t'ju duhet atyre; ne na duhen mekanizma më të thellë dhe më të fortë se ç'mund t'i duhen Gjermanisë apo Francës, neve na duhen, sepse ne e kemi sëmundjen e rëndë, na duhen këto mekanizma, por ama duhet t'u qëndrojmë edhe parimeve, jo parimeve tona, por parimeve të Komisionit të Venecias. Kur na pëlqen "Venecia", e tundim, kur nuk na pëlqen i themi prit se "Venecia" na ka sugjeruar kapjen. "Venecia" e ka çmontuar atje, kapjen në flagrancë, fati ynë, sigurisht sepse ne ecëm me parimin, ecim me vendimet e Komisionit të Venecias. Vijmë te propozimet për këtë zgjidhje, që jam i bindur se nuk do ta zgjidhim dot sot. Mund të rrimë edhe me orë të tëra, por nuk besoj se do ta zgjidhim dot sot këtë problem, edhe për faktin se ka modele të ndryshme. Është një model, që është prezantuar, për të cilin ne jemi dakordësuar dhe që është thënë te Komisioni i Venecias, sesi duhet të përpunohet, që të mos arrijmë në atë mënyrë siç u interpretua, se do të hyjnë me xhaketa dhe do të dalin pa xhakete. Interpretim vulgar. Sigurisht, interpretim vulgar, në kuptimin i thjeshtëzuar që ngjit për publikun dhe jashtë, por këtu jo. Mënyra sesi ne e mendojmë ngritjen e këtyre institucioneve të përhershme, është se këto institucione, që do të ngrihen, të kenë besimin politik të të gjithë spektrit politik, të mos jenë as të njërit as të tjetrit, por të kenë besimin politik. Pra, të mos ndodhë ajo që bëtë sapo erdhët ju në pushtet, që gjëja e parë që bëtë ishte shkarkimi i anëtarëve të KLD-së. A e dini se kur erdhëm edhe ne në pushtet në vitin 2005, halli i parë që kishim ishte Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Ju dolët në demonstratë, me

Skënder Gjinushin në Sheshin Skënderbe. Unë dhe gjithë kolegët tanë nuk e bëmë një gjë të tillë. Ama kjo është e vërtetë: në vitin 2005 kur erdhëm në pushtet për ne shqetësim ishte KLD-ja, kurse në vitin 2013, sa erdhët, gjëja e parë ishte KLD-ja. Pra, ky është problemi. Kur të miratojmë anëtarët e KLGJ-së në zgjedhjet e vitit 2017, kushdo që të fitojë, të mos thotë se do ta heq atë anëtarin e KLD-së, sepse nuk më pëlqen mua. Prandaj këto institucione që krijohen dhe modeli që krijohet, duhet të jetë i tillë që të garantojë besimin e plotë. Në qoftë se i bëjmë i bëjmë një të mirë vendit, në qoftë se do ta bëjmë kështu siç është, dhe nuk mund të ecet me arrogancë, atëherë kjo punë kështu do të vazhdojë në Shqipëri. Shqipëria kështu ka qenë, kështu do të vazhdojë çdo force politike do të bëjë të njëjtën gjë. Vini ju, i shkarkoni, vijmë ne i shkarkojmë.

Formula e *reserved seat*, sipas nesh, duhet të rishikohet. Bashkë me ekspertët të rishikohet pjesa e formulës së propozuar nga ekspertët, të gjenden të gjitha komponentët që të pamundësojmë atë shqetësim, që edhe ka, nuk është, për të qenë të sigurtë, nuk është kallp, por ta rishqyrtojmë atë formulën e *reserved seat* së bashku me rekomandimin e dhënë te paragrafi 16 dhe *foote note-et*.

Lidhur me propozimin që thatë ju: se deputetët, nuk po i hyj pjesës së përzgjedhjes dhe Këshillit të Emërimeve, nuk besoj se keni durim dhe nerva që unë t'ju flas përsëri për Këshillin Emërimeve, përsëri për hiqet sesi do të ndërtohej Këshilli i Emërimeve, sesi do t'ia besonim ne Këshillit të Emërimeve këtë, prandaj heqja e këtyre hileve, neve na çlironte dhe ishim mirë deri tani po diskutonim shumë pastër, prandaj të mos injektojmë në komponentë të tillë . Por për pjesën e votës për të cilën ishte një votë siç tha zoti Xhafaj, t'ia kalojmë parlamentit dhe më pas parlamenti duke pasur mirë çdo deputete të ketë dy–tri vota. Këta të fillojnë të zgjidhen me votim të fshehtë dhe të jetë votë e transferueshme, siç është në njërin nga modelet, që e citojë dhe zoti Xhafaj. Çfarë do të sjell kjo? Kjo do të sjellë që do të emërohen njerëz, të cilët i ka rënë bixha, pra i ra shorti vëlla. Pse dështoi Këshilli i Lartë Gjyqësor me këta anëtarë? Sepse këta anëtarë duhet të e kenë dhe kemi edhe inpixhmënt, siç është parashikuar me të drejtë në KLGJ, siç e kanë anëtarët e KLD-së, në rast se këta nuk performojnë siç duhet. Çfarë të bëjmë ne i ra bixha. Përveç kësaj, ky është qëndrim alla shqiptarësh, atë që thonë ekspertët për votën e transferueshme po e lexojë: “Secili prej këtyre sistemeve, për shkak të formulave të komplikuar, që aplikohen për përlllogaritjen e kandidatit fitues nuk siguron të paktën,

jo në çdo rast zgjedhjen e kandidatit që do të mund të fitonte për shkak të integritetit dhe cilësive të larta morale. Këto sisteme nuk i heqin mundësinë shumicës parlamentare, sepse këtu ne votojmë në bllok, të mos bëjmë sikur secili voton për integritetin, vetëm Ben Blushi, voton ashtu. Të gjithë të tjerët votojnë në bllok. Edhe ne votojmë në bllok, sipas parimeve politike, sipas qëndrimeve politike. Votojmë në bllok PS-ja, bllok LSI-ja, bllok PD-ja.

Fatmir Xhafaj – Kur ishte votim i hapur, sepse kur ishte votim i fshehtë...E morët vesh pse e hoqëm votimin e fshehtë. Nuk e mban mend ti, sepse nuk ke qenë aty.

Eduard Halimi – “Këto sisteme nuk i heqin mundësinë shumicës parlamentare që kur ka disa kandidatë në garë, siç do të kemi disa kandidatë në garë dhe sidomos kur ajo realizon votim politik në bllok, të ketë avantazhe shumë të mira për të mundësuar zgjidhjen e kandidatëve të preferuar prej saj”. Pra, maxhorancës, sepse ka vota, të kësaj maxhorancës ose të asaj që do të jetë nesër. “Aplikimi i formulave të paraqitura e lidh rezultatin që del kryesisht me vullnetin e shumicës në pushtet”, nuk janë fjalitë e mia. “Gjithashtu disa prej tyre, lejojnë mundësinë për lobime politike dhe ndoshta edhe korruptive”. Në disa nga këto formula është i favorizuar ndikimi i hapur politik në përzgjedhjen e kandidatëve dhe përfaqësimi politik i partive në formatimin dhe funksionimin e institucioneve të sistemit të drejtësisë. Gjithashtu, këto formula nuk favorizojnë në çdo rast përzgjedhjen e individëve më cilësor, por ata më të pëlqyerit politikisht apo ata që janë më të aftë të llobojnë në mjedisin politik.

Të paktën kur janë prezantuar na janë thënë të gjithëve avantazhet, disavantazhet, këto janë avantazhet e këtij sistemi dhe këto janë disavantazhet e këtij sistemi, dhe kë do të zgjedhim.

Unë nuk mendoj se mund ta vazhdojmë debatin për këtë, sepse në këtë moment nuk mendoj se zgjidhim, jemi larg modeleve. Kështu që do t’ju propozoja që modelin *reserved seat* për këto institucione të këshillohen edhe bashkë me ekspertët, t’i shikojmë, por në përfundim, mendoj se pjesa e institucioneve të përhershme, pra të gjithë institucioneve e përhershme që do të jenë për shumë vjet, duhet të jetë një komponent, të cilin duhet ta diskutojmë me qetësi në ditët e ardhshme, sepse jemi pak larg dakordësit për këto.

Ndërsa për pjesën e komponentit antikorrupsion për të cilët ne ramë dakord, me përjashtim të çështjes që u la për t'u diskutuar, propozimit që komisionarët të emërohen nga ata, ky ishte një propozim i sotëm dhe besoj se në ditët në vijim do ta diskutojmë dhe do të kemi një përgjigje, të ecim sa më shpejtë. Gjithë pjesa e këtij komponentit të këtyre do një diskutim më të qartë dhe më të qetë për të arritur në një marrëveshje politike, e cila duhet t'i rezistojë kohëve, pavarësisht se njëra anë është këtu, ne historinë e njohim të gjithë dhe nuk duam të lodhim njëri-tjetrin.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Kam një ndërhyje të shkurtër, më tepër për të qartësuar veten. E

kam lexuar dhe rilexuar shumë herë këtë pjesë dhe mua më duket se zgjidhjen e kemi të shkruar e zeza mbi të bardhë dhe nuk po i kuptoj këto formula që po diskutojmë këtu. Pse? Po t'i referohemi draftit kushtetues, në nenin 147 pikat 4 dhe 5, është dhënë zgjidhja. E doni si “Venecia”? Në pikën 16 thuhet: “Në lidhje me anëtarët jogjyqtarë procesi i nominimit të tyre është po aq i rëndësishëm sa metoda e zgjedhjes së tyre. Distanca e tyre nga politika, mund të sigurohet vetëm nëpërmjet një procesi të hapur dhe transparent nominimi me nismën e organeve të pavarura nominuese, universiteteve, OJQ, Dhomë Avokatie dhe të përfundohet te Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, që përbëhet nga anëtarët e gjyqësorit”. Ky proces nominimi, duhet të bëjë të mundur që parlamenti të detyrojë të bëjë një përzgjedhje mes kandidatëve më të kualifikuar dhe jo të emëruarve politik.

Te opinioni i Venecias në pikën 17 thuhet: Në lidhje me metodën e zgjedhjes e anëtarëve jogjyqtarë, janë të mundshme disa zgjidhje të tjera dhe parlamenti mund të konsideroj dhe alternativa të mëtejshme për të siguruar përfaqësimin proporcional *de facto* të forcave kryesore politike brenda KLGJ-së.

Të nderuar kolegë,

Në draft kemi thënë që 5, anëtarët jogjyqtarë do të vijnë : 1 nga radhët e avokatisë, 1 nga noterët, 1 nga pedagogët e Shkollës së Magjislaturës dhe 1 nga shoqëria civile. Referuar pikës 5 të nenit 147 “Draftit kushtetues” Kuvendit do t'i vijnë 15 kandidatura, të ndara në grup me nga 3. Formula sesi mund të shkohet te 5 personat më me integritet profesional, janë lënë në dorë që të kësaj kësaj kjo tavolinë.

Pyetja është shumë e thjeshtë: ju kërkoni t'i zgjedhin apriori, dy ju dhe dy ne, me letra në xhep. Dy anëtarë të ardhur nga prapavija e opozitës juristë, sepse juristë ka sa të duash tani, dhe dy të ardhur nga radhët e maxhorancës dhe ta bëjmë një qeveri të përbashkët, gjyqtarë dhe pjesën tjetër politike. Pra, një qeveri të përbashkët të gjyqësorit. Gjashtë do jenë ata dhe pesë do t'i kemi ne.

Kjo, në mënyrë absolute, më mirë le të rrijë kështu si është, megjithëse nuk është përsëri zgjedhja e duhur, por edhe kështu si propozohet dy ne, dy ju, është e papranueshme.

Unë nuk mund ta jap votën time si deputet dhe si jurist në këtë komision për këtë formulë, dy ju, dy ne.

Drafti dhe Venecia e kanë dhënë zgjidhjen. Për ta konkretizuar me një shembull: do mblidhet Dhoma Kombëtare e Noterëve në mbledhjen e përbashkët të të gjithë noterëve të Shqipërisë, dhe, bazuar në kriteret e përcaktuara në ligj, do të nominojë tre. Na duhet që, pa e cënuar të drejtën e nominimit që e kanë bërë vetë noterët, të zgjedhim një noter, që do të jetë anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor. Se çfarë formule do të ndiqet, ejani ta diskutojmë...

Formulat janë nga më të ndryshmet, por ne nuk duhet të prekim të drejtën që ky draft kushtetues u ka dhënë avokatëve, noterëve, pedagogëve të Shkollës së Magjistraturës dhe shoqërisë civile. Këtë të drejtë nuk duhet ta prekim. Formulën sesi duhet t'i zgjedhim, ejani ta diskutojmë. Këtë duhet të diskutojmë, dhe jo faktin a do të jenë noterë, avokatë, pedagogë të Shkollës së Magjistraturës apo do vijnë nga shoqëria civile. Në mënyrën sesi e thoni ju, kjo çënon. Mendoj që jemi shumë afër për ta gjetur zgjidhjen. Këtë na ka lënë edhe Venecia.

Faleminderit!

Jorida Tabaku - Mesa u kuptua nga diskutimet e kolegëve, po të jetë zgjedhja me tre të pestat, është i pavarur, që do të thotë "Nuk kapet nga politika", ndërkohë, nëse zgjidhen dy plus dy me propozimin e palëve, atëherë e ka PD-ja dhe përfundon i gjithë procesi. Të gjithë këtë diskutim bëjnë, që dy plus dy kapet, ndërsa tre të pestat është e pavarur.

Oerd Bylykbashi - zoti Manja tha që ky është modeli që nuk diskutohet dhe, përtej kësaj, mund të shohim që të gjejmë zgjidhje të tjera. Besoj se këto nuk janë një nga

dhjetë komandat që solli Moisiu, dhe për rrjedhojë do të gjejmë një kompromis për një. Ato të dhjeta i lemë ashtu si janë. Kjo është e diskutueshme. Ajo që na kërkon dhe Komisioni i Venecias është që përfshirja e opozitës të jetë substanciale, dhe ajo që mund të kërkojmë ne, është që, duke shkuar te një nga katër modelet e propozuar nga ndërkombëtarët, që është në raportin e komisionit të Venecias, të sigurojmë përfshirjen substanciale, në votim, në përzgjedhje, në të cilën sigurisht do të ketë një impakt dominant maxhoranca parlamentare.

Do të krijojmë një trup të cilën do ta çojmë në KLGJ apo KLP për të garantuar përgjegjshmërinë e KLGJ-së ose gjyqësorit karshi nesh që na zgjedhin, për të cilën ne japim llogari. Mënyra sesi e shfaqni ju në publik të paktën, në diskutimin që po bëjmë, është sikur anëtarët jogjyqtarë ose joprokurorë, duhet të jenë “aseptikë” “apolitikë”...

Përveç asaj që nëse e besojmë apo jo, që unë vet nuk e besoj, dhe duke i qëndruar pyetjes retorike të koleges Tabaku, sepse ajo histori tregon një të vërtetë, unë besoj që ne duhet të garantojmë përgjegjshmërinë e gjyqësorit dhe prokurorisë tek të tjerët.

Në rastin konkret, ia kemi lënë parlamentit, që do të thotë se duhet të ketë dozën e vetë të aksesit tonë, dhe që më pas ne të japim llogari për popullin. Duke vazhduar me atë që tha kolegu Manja, se na duhet nga avokatët, noterët, por të mos ngatërrohem i aty. Në fakt, ne nuk duhet të garantojmë, të nderuar kolegë, përgjegjshmërinë e KLGJ-së apo të KLP-së, te noterët apo avokatët. Jo! Ata janë thjesht burimi nga ku ne do të marrim kandidaturat më të mira, por përgjegjshmërinë jo atje, por ajo të jetë te ne, sepse ne sepse japim llogari.

Ne nuk mund të themi që këta jogjyqtarët do të jenë të përgjegjshëm tek opinioni publik. Ata do të jenë të përgjegjshëm te ne, sepse, nëse do të ishin te opinioni publik, do t'i zgjidhnim me zgjedhje të përgjithshme këta pesë anëtarë këtu dhe pesë anëtarë atje. Do ta zgjidhnim me votë. Pra, këta duhen të jenë njerëz të cilët të përfaqësojnë në njëfarë mase vullnetin politik të parlamentit në lidhje me mënyrën si funksionon, me shqetësimet apo dhe me dakortësinë tonë sesi po funksionon sistemi i drejtësisë. Ndryshe e heqim fare dhe pranojmë korporatizmin. Këtë se pranojmë, por çojmë njerëz që mendojmë se do të transmetojnë shqetësimin politik që ne e marrim me votë.

Siç e thashë, t'i lëmë mënjane këto ballo maskash, sepse ky është shqetësimi, por të gjejmë dozën e duhur dhe më pas do të shkohet me siguri te përfshirja substanciale e opozitës të cilën Komisioni i Venecias e jep në një formulë të garantuar.

Gent Strazimiri - Nuk është frymë konsensusi. *(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Jo, e kisha më shumë sqaruese.

Domethënë, unë dua të kuptoj dhe, në fakt, të them të drejtën, ndryshe nga të gjithë ju do të jem i sinqertë.

Unë kam frikë se pushtetin gjyqësor mund ta kapë Edi Rama. Edi Rama sot është pushteti, është qeveria dhe besoj se është një shqetësim i ligjshëm. Ju keni frikë se, nëse merr pjesë, me atë peshë specifike që ka sot opozita në të gjithë procesin, e kap opozita.

Pyetja që ju bëri zonja Tabaku besoj se është retorike, nuk është juriste, është logjikë e thjeshtë. Keni vakum logjik në të gjithë gjënë. Nëse e zgjedh parlamenti, tha zoti Xhafaj, e zhvirgjërojmë, bëhet partiak dhe vesh një kostum partiak, gjë që është edhe një shenjë dalluese, i gjithë parlamenti me konsensus, të 140 – t në bazë të disa rregullave që i gjejmë. Ndërkohë që, kur unë ju them me të njëjtin mekanizëm, me 140 vota, i dalë nga një proces përzgjedhje brenda Partisë Socialiste, kryetar i grupit përzgjedhës ka qenë Edi Rama.

Avokati i Popullit nuk është politik, mos e fjeni, thotë zonja Hysi. Tani, do t'i rrimë një standardi apo nuk do t'i rrimë një standardi? Asnjëri prej nesh këtu nuk mund të garantojë për paanshmërinë, apoliticitetin, simpatitë apo antipatitë politike të personave që do të kenë dëshirë të vijnë dhe të angazhohen. Nuk është kjo detyra jonë, nuk duhet të garantojmë këtë, por duhet të garantojmë besimin që secili prej nesh ka dhe do ta kryejë mirë detyrën e tij, në mënyrë krejtësisht të pavarur, sepse nuk e kemi atë garanci se për kë do të votojë ditën e diel, 1 herë në 4 vjet kur vjen puna për qeverinë.

Mund të të përvetohet ty që voton PS – në, përvetohet tek unë dhe në fund fare voton LSI – në siç ndodh zakonisht, fjala vjen.

Nuk është kjo detyra jonë, por të mendosh se, duke e zgjedhur nga parlamenti, i ke vënë vulën, shenjën dalluese, kostumin partiak e të tjera me radhë. Pse? Sepse në mënyrë thelbësore në proces po merr pjesë edhe opozita, brenda tezës specifike që ka në një moment të caktuar. Kjo gjë nuk qëndron dhe nuk është parim.

Kështu që, të gjitha artificet që gjeni, thjesht nuk qëndrojnë logjikisht, jo juridikisht. Fillojmë dhe bëjmë pis qëllimin për të cilin jemi ulur. Bëjmë 4 orë këtu dhe betohemi dhe përbetohemi, unë se votoj, unë e votoj.

Ulsi, kështu the edhe për ligjin e dekriminalizimit dhe e votove. Kështu që, të mos i japim kot deklaratat. Vijnë këtu dhe japim disa mendime aq sa kemi secili prej nesh dhe të mos kalojmë në deklaratat, sepse nuk i mban dot pastaj dhe është turp. Të gjitha variantet janë mbi tryezë dhe logjika që keni mbi gjënë dhe që keni frikë se jua kap opozita...

Unë sot po. Kam frikë se ma kap nesër.... sepse Ylli Manjanin e di që nuk e kap.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në mos Edi e kap Oerdi. Atëherë çfarë do të thoni, sepse po ia latë në dorë...

Kështu që mendoni edhe për nesër.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – U mbyll edhe kjo çështje e fundit. U ezauruan të gjitha problematikat që kishte Partia Demokratike lidhur me projektin. Natyrisht, është një gjë shumë pozitive që për një pjesë dërrmuese të tyre ne arritëm të gjejmë gjuhën e përbashkët dhe kjo është gjë e shëndetshme. Ka disa gjëra që teknikisht janë lënë në formën e pyetjeve, në formën e komenteve, të cilave dëshiroj që t'u shtoja edhe unë disa pyetje dhe komente për çfarë është diskutuar nga fillimi deri në fund, përjashtoj këto me shumicë të cilësuar, sepse i trajtova.

Konkretisht, kam disa pyetje për ekspertët gjatë rishqyrtimit të procesit.

Grupi i parë i pyetjeve është.

A mendoni ju se Komisioni i Venecias ka shprehur rezerva për skemën e strukturës institucionale, kushtetuese, si dhe raportet e balancës dhe kontrollit ndërmjet tyre, të paraqitura në draftin kushtetues? Pyetja më specifike është: A do të mbetej efikase dhe efiçente skema institucionale e parashikuar në projekt –amendamentet e përgatitura nga ekspertët, në luftën kundër korrupsionit dhe cilësisë në sistemin e drejtësisë, nëse do të ndërhyhej me qëllim heqjen e ndonjëres nga institucionet e parashikuara?

Së dyti, një nga tre arsyet e mëdha, krahas asaj që diskutuam për kapjen politike të sistemit dhe luftës kundër korrupsionit brenda radhëve të tij, është edhe

qëllimi për shmangien në minimum të frymës dhe praktikave korporatiste në funksionimin e sistemit. Unë bëj pjesë tek ata që mendojnë se krijimi i disa strukturave me funksione kontrolluese ndaj njëra - tjetrës dhe pa mbivendosje apo mbi kontroll pushtetesh është një zgjidhje efikase dhe në këtë kontekst, në këndvështrimin se si e shikoj unë këtë aspekt, më kënaq zgjidhja e dhënë.

Pyetja shtrohet që, duke ruajtur arkitekturën aktuale të propozuar, a ka nevojë për disa elemente shtesë në zgjidhjet e dhëna kushtetuese apo edhe në ligjet kuadër, për të forcuar më tej këtë komponent, duke parashikuar më mirë dy elemente të rëndësishme.?

Së pari, balancën dhe kontrollin ndërmjet pushteteve. Pra, ndërmjet ekzekutivit, pushtetit gjyqësor apo sistemit të drejtësisë, sepse ekzekutivi është një pushtet. Kemi nevojë për një balancë këtu që ai të marrë përgjegjësitë e veta për atë që ai takon të marrë në standarde dhe në frymën e Kushtetutës.

Roli i ministrit të Drejtësisë në këtë balancë dhe në mënyrë të veçantë balanca ndërmjet pushtetit legjislativ dhe pushtetit gjyqësor, por, duke mos ceduar në asnjë mënyrë ndaj kontrollit politik mbi sistem.

Kjo është njëra anë, kurse ana tjetër është forcimi i kontrollit mbi institucionet e brendshme të sistemit dhe llogaridhënia e këtyre për të mbajtur në kontroll çdo prirje, mbyllje për zgjidhje korporatiste dhe klienteliste.

Pra, duke pasur disa institucione, si do t'i bëjmë ato që të jenë më shumë llogaridhënëse në raport me njëra – tjetrën, pa u mbivendosur, në mënyrë që të shmangim zgjidhjet korporatiste dhe klienteliste?

Grupi i dytë i pyetjeve lidhet me çështjet e diskutuara për sa i përket Spaku - t dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit.

Në përgjigje të disa pyetjeve që m'u bënë në seancat e marsit nga kolegët e opozitës për këtë gjë, unë kam thënë se, së pari Spaku do të jetë strukturë e pavarur në sistemin e prokurorisë shqiptare. Së dyti, shefi ose prokurori drejtues i Spaku - t, emrin gjejeni vetë, nuk ka rëndësi për mua, duhet të zgjidhet dhe të shkarkohet nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë me 2/3 –at e saj.

Së treti, Byroja Kombëtare e Hetimit është strukturë policore, pjesë e Policisë Gjyqësore të shtetit dhe vendoset pranë Spaku - t dhe nën autoritetin e tij.

Së katërti, është pjesa që ka të bëjë me njësinë e posaçme hetimore, këtu e ndaj njësinë e posaçme hetimore, ose më saktë po përdor termin që ka Kushtetuta, Njësia e Posaçme Hetimore duhet që të miratohet në lidhje organike me Spaku - n.

Në funksion të qartësimit të pozitës kushtetuese, institucionale dhe funksionale të këtyre strukturave shtroj pyetjen: nëse strukturat antikorrupsion të hetimit dhe të ndjekjes penale, përveçse sa më sipër, a kanë nevojë për zgjidhje të reja shtesë në projektin e dhënë në funksion të efikasitetit, të hetimit dhe të procedimit penal në Republikën e Shqipërisë? Unë dua që ta shikoj të tërë, nuk mund ta shikoj në mënyrë parciale efikasitetin e hetimit dhe të ndjekjes penale.

Konkretisht, në funksion të këtij shqetësimi, si do të zgjidhet raporti institucional ndërmjet tyre dhe strukturave të të njëjtit nivel në funksion të efikasitetit dhe evitimit të përplasjeve institucionale; pra Spaku - ku, zyra e Prokurorit të Përgjithshëm, BK – ja dhe Policia e Shtetit?

Çfarë roli dhe kompetence do të kenë strukturat nga vijnë oficerët e Policisë Gjyqësore, në përbërje të njësisë së posaçme hetimore, lidhur me cilësinë e punës dhe disiplinimit të tyre? A do të kenë ndonjë ndikim, a do të kenë ndonjë lidhje?

E treta, si do të realizohet dhe parashikohet hetimi ndaj vetë prokurorëve të Spaku – t, si dhe çfarë lloj përgjegjësie, veç asaj penale, do të kenë prokurorët e Spaku – t?

Pyetja tjetër. Si do të jetë kontrolli parlamentar mbi këto institucione, duke mbajtur në konsideratë zgjidhjen dhe praktikën aktuale në marrëdhëniet me Prokurorin e Përgjithshëm?

Në Kushtetutë është parashikuar përgjegjësia politike dhe institucionale e ekzekutivit në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, pra është përgjegjësi kushtetuese. Si do të reflektohet kjo me strukturat e reja kushtetuese, duke ruajtur nga njëra anë të pa cenuar autonominë dhe pavarësinë funksionale të tyre? Absolutisht, kjo është shumë e rëndësishme, por, nga ana tjetër, duke minimizuar teorinë e ping - pongut që kemi sot, si dhe heqjen dorë të ekzekutivit nga përgjegjësia kushtetuese dhe politike, që nesër të mos dalë siç ndodh sot, që policia i thotë prokurorisë e ke ti dhe nesër të thotë, Prokuroria s' ma solli policia, si do ta zgjidhim këtë?

Nga ana tjetër, të mos dalë që ekzekutivi nesër, i cili merr një përgjegjësi politike një herë në 4 vjet, të thotë që ju vetë e bëtë Kushtetutën dhe çfarë pune kam unë me këtë çështje, kjo nuk është më çështja ime.

Tjetër gjë që kam, a mund të parashikojmë në dispozitat kushtetuese për Spaku – n edhe njësinë e posaçme hetimore, apo edhe në dispozitat transitorë një parashikim, i cili lidhet me përfshirjen në hetim për vepra penale me interes të veçantë publik edhe të hetuesve edhe prokurorëve të huaj kundrejt marrëveshjeve ndërkombëtare dhe me status të përkohshëm, i cili do të rregullohet me ligje të posaçme me 3\5 – at?

Ka pasur një diskutim shumë të madh, ka disa çështje shumë të nxehta, të cilat mund të jenë edhe nesër, ka pasur propozime për të pasur më shumë prani të hetimit ndërkombëtar në këto çështje, si edhe në shumë çështje të tjera.

Unë jam një nga njerëzit që nuk kam qenë kundër në thelb, por kam thënë që ta zgjidhim këtë dhe të na e mundësojë Kushtetuta. Nuk jam kundër, jam pro, por problemi është a kemi mundësi që për çështje të kësaj natyre të kemi një dispozitë transitorë apo një parashikim që ta njohin këtë, kundrejt marrëveshjeve ndërkombëtare, dhe ligje të posaçme që parlamenti duhet të ketë një shumicë të fortë vullneti, me 3\5 – at apo me 2\3 –at, që t'i miratojë këto dhe të lejojë hetime specifike duke mbajtur parasysht edhe veçoritë e vendit tonë?

Nëse ju mendoni që me Spaku – n, me Byronë dhe njësinë e posaçme hetimore, kjo është një gjë që e zgjidh dhe që e ezauron, kjo është një çështje që mund të diskutohet, dhe unë të mos insistoj në këtë çështje.

Pra, këto ishin disa pyetje që dëshiroja t'i ngrija, me qëllim për t'i pasur në vëmendje nga ana e ekspertëve gjatë trajtimit të debatit që u bë këtu në reflektim të opinionit të Komisionit të Venecias.

Gjithsesi, për ta ndihmuar procesin, unë këto do t'i paraqes edhe me shkrim, së bashku me propozimin për një variant alternativ që u dha, që të jetë me shkrim, në mënyrë që ta lehtësojë, sepse mund të ketë ndonjë përkthim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, jo nuk është ai, është pak më i moderuar, sepse, kur e kam dhënë atë, nuk kishte ardhur opinionin final i Komisionit të Venecias.

Ne jemi njerëz të përgjegjshëm dhe kemi reflektuar mbi opinionin final të Komisionit të Venecias dhe këtu po dal te dy çështjet e fundit që kam.

E para. Një gjë është e padiskutueshme. Ne do t'i përmbahemi fort asaj që kemi rënë të gjithë dakord; politika dhe faktori ndërkombëtar, që i gjithë ky proces do të mbështetet në mënyrë fundamentale tek opinionin e Komisionit të Venecias. Unë jam këtu për ta rikonfirmuar përsëri edhe në emër të forcës politike që përfaqësoj, por edhe në vullnetin tim personal si anëtar dhe kryetar i këtij komisioni që për çdo zgjidhje ka vetëm një referencë; opinionin final të Komisionit të Venecias. Kjo është e vetmja gjë që na bashkon dhe na ndan njëkohësisht kur janë të ndryshme nga opinionin.

Momenti i dytë që dua të theksoj në mbyllje të këtij procesi është fakti që, më vjen keq, por dua të shpreh paraprakisht respektin për dy zotërinjtë e nderuar, për zotën Smajber dhe zotën Deville, sepse kanë marrë një barrë të madhe përsipër, por unë kam shumë besim që ata, me eksperiencën personale që kanë, me eksperiencën e institucioneve shumë prestigjioze që përfaqësojnë dhe natyrisht edhe me përvojën e krijuar gjatë këtij 1 vit e gjysmë pune në këtë proces, do të mund t'ia dalin me sukses.

Personalisht, nuk kam dëshirë të jem në vendin e tyre, por atyre iu ka rënë kjo barrë, e kanë pranuar dhe ajo që do të duhet të bëjmë ne është që t'ua lehtësojmë, duke i njohur për arbitër, për rolin dhe përgjegjësinë dhe kontributin që kanë në këtë proces. Besoj se ata do t'i japin gjithë kohën e nevojshme, nëse ka diçka që nuk është qartësuar mirë gjatë përthimit, duke pasur respektin maksimal për të dy zonjat që kanë bërë për këtë proces, ne mund edhe t'u vëmë në dispozicion gjithë praktikën dhe procesverbalet për të marrë maksimumin e mundshëm të këtij debati. Kështu që do të presim, kur dy zotërinjtë e nderuar të jenë gati për të ardhur para komisionit, për të shfaqur qëndrimin që ata do të kenë për çështjet e diskutuara dhe të debatuar. Nëse ka diçka nga ana e tyre, do t'u lutesha në përfundim ta shprehnin.

Eduard Halimi –Atëherë, në përfundim unë shprehem që dy takimet kanë qenë shumë të mira, ky i sotmi dhe i parafundit, pra ai që ka qenë i fundit dhe i parafundit, për të diskutuar 10 çështjet, shqetësimet që ka ngritur opozita, pjesë të dialogut politik. Është e qartë që ne kemi dakordësi të plotë për komponentët antikorrupsion. Unë do të doja që pyetjet që kanë të bëjnë me komponentët antikorrupsion, ato që kemi ngritur ne, këto që ngriti zoti Xhafaj dhe çështjet që ngre edhe Komisioni i Venecias, sepse një pjesë e

këtyre, për të mos thënë pjesa më e madhe janë çështje që i ngre Komisioni i Venecias, që janë: Byroja, SPAKU dhe Vettingu të përpunohen sa më shpejt dhe për këto kemi dakordësi, s' duhet të humbasim kohë, të përpunohen së bashku edhe me një kërkesë që e kemi bërë ne në mbledhjen e parafundit. Shoh që edhe zoti Xhafaj është në të njëjtën linjë, sepse e ndjeva nga pyetjet që duhet të përgatisim në mënyrë vertikale edhe legjislacionet, sepse ndryshimet kushtetuese s' do të vendosin kriteret dhe mënyrën e funksionimit të Byrosë dhe të SPAKU-t. Unë kam kërkuar atëherë se sa ditë do të na duhet për të pasur një draft që ta diskutojmë. Ndërkohë që ka mosdakordësi për pjesën që ka të bëjë me institucionet e përhershme dhe strukturën e këtyre institucioneve që kapin komponentin tjetër të sistemit të drejtësisë, pra jo me korrupsionin, por komponentin tjetër, emërime, promovime, disiplinime, pra të gjitha këto institucione.

Çështjet që ne ngritëm janë ato çështje që, edhe i shtroi zoti Xhafaj, pra pjesën që luftohet koorporatizmi, jemi në *check and balance*, është mekanizmi efikas, nuk është mekanizmi efikas, çështje që ne i kemi ngritur dhe që u artikuloan. Për këto çështje ju e shikoni që nuk kemi dakordësi, pra ne jemi të ndarë, ndryshe nga komponenti tjetër. Për këto çështje unë do të doja që ju të bëni një kalendar në bashkëpunim me ekspertët tanë, ashtu siç ne jemi dakordësuar në fillim. Pra, çështjet që iu adresojmë juve, do t'i diskutoni me ekspertët e palëve. Unë besoj se nuk e keni filluar punën, të paktën me ne jo. Me ekspertët shoshitini gjërat, të cilat kanë të bëjnë me këtë gjë dhe që mendoni se mund të gjejnë zgjidhje, në mënyrë që kur të vijnë, edhe na ta kemi më të lehtë, t'i kursejmë kohë njëri-tjetrit të mos flasim për çështjet që mund të mos kenë ndonjë rëndësi, apo vendimmarrje politike. Zgjidhni ato gjatë këtyre ditëve, përcaktoni kalendarin, takohuni me ta, ju i keni kontaktet e tre ekspertëve që ne kemi, të cilët janë: zoti Alibeaj, zoti Bardhi dhe zoti Kaso, zgjidhni gjatë këtyre ditëve çfarë mund të zgjidhni. Çështjet e tjera pastaj, që nuk do të zgjidhen, do të diskutohen këtu. Kështu që ju lutem përcaktoni kalendarin, ekspertët tanë janë të gjithë në dispozicion 24 orë në 24, nga ky moment deri në momentin kur do të doni ju, në çdo kohë, siç e dini dhe kemi besoj një mirëkuptim të tillë. Kur të vijë drafti, mirë është t'i kemi përpara edhe diskutimet, në mënyrë që të ekonomizojmë pak mbledhjen e ardhshme të komisionit të reformës, që do të jetë në një kohë të afërt.

Fatmir Xhafaj - Po.

Jon Smibert – *(Ndërrhyrje në anglisht)*

Ne jemi të kënaqur për këtë takim dhe jemi të qartë që ky takim është për të gjetur zgjidhje më të mira, të shpejta për të bërë që Reforma në Drejtësi të jetë një realitet në Shqipëri. Gjëja e dyta që doja të thoja është që zgjidhjet që ne kemi bërë si komunitet ndërkombëtar janë bazuar në Opinionin e Komisionit të Venecias si dhe në realitetet që ne kemi parë dhe kuptuar këtu në Shqipëri si dhe do bashkëpunojmë me ekspertët e opozitës për t'iu përgjigjur pyetjeve sa më shpejt të jetë e mundur.

Fatmir Xhafaj - Dakord, faleminderit! Besoj se është e qartë edhe përgjigjja lakonike e zotit Smajbert, ju qartësoi të gjithëve për pozicionin dhe rolin e tyre në këtë proces, por edhe për hapat e mëtejshëm. Unë besoj shumë që grupi i ekspertëve të nivelit të lartë vendas dhe ndërkombëtar me përgjegjshmërinë që e ka karakterizuar, do të dijë ta përmbushin më së miri këtë proces.

Kam dhe dy gjëra. Së pari, do t'iu lutem kolegëve t'iu qëndrojmë marrëveshjes që kemi bërë. Asnjë deklaratë në media. Nuk do të ishte etike për sa kohë e kemi bërë këtë marrëveshje, sepse, nëse do të fillojmë të bëjmë deklarime dhe do të shprehim qëndrime politike në media, kjo besoj unë mund ta dëmtonte të gjithë këtë marrëdhënie shumë të mirë. Ka qenë një pjesë e marrëveshjes që ne kemi bërë dhe do të duhet t'iu qëndrojmë.

E dyta, unë i kam kërkuar grupit të ekspertëve që të bëjnë një memo dhe të na thonë cilat janë ligjet, cila është struktura e ligjeve, në mënyrë që paralelisht me reformën, me projektin kushtetues, ne të dimë kur do jenë ligjet kuadër dhe cila do të jetë strukturë e tyre, në mënyrë që ta debatojmë këtë në një mbledhje të komisionit dhe të kemi mundësi pastaj për të ecur përpara.

Eduard Halimi – Ne kemi rënë dakord, deklarata politike të mos bëjmë në kuptimin e zhvillimit të retorikës, besoj unë.

Fatmir Xhafaj – detajeve.

Eduard Halimi – Jo, pa u hedhur në detaje, po them për këtë. Por në përfundim të kësaj tryeze, pas diskutimit, unë mendoj që duhet informuar publiku. Të paktën me qëndrimin që unë kam ndër mend të them, janë vetëm 5 fjalitë që them tani, dua të kondicionoj, por një qëndrim, që ne diskutoam, ngelën këto çështje, pra një qëndrim pa retorikë politike besoj se i intereson edhe publikut, sepse jemi mbyllur këtu si në kullë,

duhet të dinë që u diskutua, sepse gjërat pastaj do të dalin e do të thonë, një herë diskutuam këtë, jo po diskutuam këtë. Unë këtë qëndrim kam. Pra, u diskutuan kaq çështje, kaq ngelën, do të diskutohen javën e ardhshme, sepse mediat janë aty dhe s'mundet që të injorojmë publikun, që u mblohdëm, pa i hyrë pastaj çështjes kishe të drejtë unë, apo kishe të drejtë ti. Këto janë çështje pastaj që...

Fatmir Xhafaj - Pa u hyrë detajeve, kjo është shumë e rëndësishme, që të mos kondicionojmë punën e zotërinjve.

Eduard Halimi - Unë e kam të detyrueshme për ta informuar publikun që u bënë këto, pa i hyrë retorikës.

Fatmir Xhafaj – Dakord. E mbyllim këtu sot. Faleminderit për mirëkuptimin, faleminderit për kontributin, faleminderit në mënyrë të veçantë zonjave dhe zotërinjve, përfaqësues të ekspertizës ndërkombëtare dhe pa dyshim një falënderim i veçantë për të gjithë kolegët, për zonjat e përkthimit, komplimente edhe për durimin! Kështu që e meritoni një duartrokitje. Faleminderit edhe çunave të teknikës, se ishin shumë të sjellshëm! Faleminderit të gjithëve. Një fundjavë të gëzuar për ata që kanë ndër mend të shkojnë me pushime.

MBLEDHJA MBYLLET

Shënim: Diskutimet e zhvilluara në gjuhën angleze, janë reflektuar të përkthyer në këtë procesverbal. Përkthimi është kryer nga stafi teknik i angazhuar pranë Komisionit të Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë